

KAPITALI BANKAR DHE NORMAT E INTERESIT – NJË ANALIZË PANELI PËR DISA VENDE TË BALLKANIT

Fidane Spahija Gjiko

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, profili Financë, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Arjan Kadareja

Numri i fjalëve: 51,670

Tiranë, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time morale, deklaroj se ky punim është orgjinal dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar nga unë dhe nuk është prezentuar asnjëherë pranë ndonjë institucioni tjetër për vlerësim apo publikim. Në punim janë cituar dhe referuar të gjitha burimet e literaturës së përdorur.

Fidane Spahija Gjiko

ABSTRAKTI

Studimi i normave të interesit ka qenë përherë çështje me interes për hulumtim. Kreditë janë burimi kryesor i fondeve të bizneseve dhe individëve, sidomos në vendet e Ballkanit. Problemi kryesor qëndron te marzhet e larta të normave të interesit si pasojë e shumë faktorëve si: ekonomia joformale, problemet me sistemin kadastral, mosfunksionimi i gjykatave, pamundësia e Bankave Qendrore për të injektuar likuiditet, dobësitë në cilësinë e raportimit financiar të bizneseve, kreditë joperformuese. Si duket gjitha këto probleme janë në favor të bankave, kështu duke maksimalizuar fitmin. Dihet se roli ndërmjetësues i bankave është të sigurojë mirëqenie sa më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Niveli i lartë i marzhit të normave të interesit është tregues i joefikasitetit, marrjes së tepërt të rrezikut dhe mungesës së konkurrencës.

Ky studim synon të matë efektet e strukturës bankare, të tregut dhe makroekonomike mbi marzhin neto të normës së interesit të vendeve të Ballkanit, si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia, për periudhën 2007-2013. Sipas vlerësime të bëra përmes analizës statistikore dhe regresionit, erdhem në përfundim se marzhi neto i normave të interesit ndikohet nga mbajtja e nivelit të lartë të kapitalit, kreditë jo performuese, shpenzimet operative, pronësia e kapitalit dhe madhësia e bankave. Të tjerë faktorë që e ndikojnë atë janë rreziku i likuiditetit dhe performanca e portfoliosë. Komponentët makroekonomikë si: Struktura e tregut dhe bruto produkti i brendshëm janë vlerësuar pa ndikim.

Studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë ndryshime në marzhet e normave të interesit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj. Një qasje e tillë mund të jetë e dobishme për masat specifike të politikës ekonomike, duke marrë parasysh perspektiven e integritimit në BE dhe studiuesëve të tjerë që dëshirojnë të zgjerojnë këtë studim.

Fjalët kyçe: Normat e interesit, kapitali, rreziqet, pronësia dhe konkurrenca.

ABSTRACT

Studying interest rates has always been in focus of researches. Loans are the main source of funds for businesses and individuals, especially in the Balkan countries. The main problem is that high interest rate margins can indicate many factors, such as: The informal economy, problems with the cadaster system, an ineffective job of courts, the inability of Central Banks to inject liquidity, weaknesses in the quality of financial reporting of businesses, non-performing loans. It looks like all these problems are in favor of banks, by maximizing their profit. It is well known that the intermediary role of bank is to provide the best prosperity for society, preferably at the lowest possible costs. The high level of interest rate spread is an indicator of inefficiency, excessive risk taking and lack of competition.

This study aims to measure the effects of the banking, market and macroeconomic structure on the net interest rate spread of the Balkan countries, such as Albania, Kosovo, Macedonia, Bosnia and Herzegovina, and Serbia, for the period 2007-2013. According with this, the evaluation is made from two tips of methods: statistical and regression analysis. In the end, I can conclude that the net interest margin is influenced by maintaining high levels of capital, non-performing loans, operating expenses and bank capital ownership. Other factors that affect it are bank size, liquidity risk and portfolios performance. Macroeconomic components such as: Market Structure and Gross Domestic Product are assessed without impact.

The study of factors that may cause changes in interest rate margins is an interesting and widely dealt with by foreign literature. Such an approach may be useful for specific measures of economic policy, taking into account the prospect of EU integration and other researcher that want to expand this study.

Key words: Interest rates, capital, risk, ownership and competition.

Dedikuar familjes time...

FALENDERIME

Titulli doktorë shkence nuk fitohet lehtë. Duhet përkushtim, kohë dhe ambicie. Për mua kjo periudhë ishte ndër periudhat më të bukura të jetës time për arsye se dy herë u kurorëzova me emrin nënë. Përkushtimi ndaj familjes e bëri që ky studim të eci me hapa më të ngadalshëm në krahasim me studimet baçelër dhe master. Por pa ndihmën e familjes, pedagogut tim udhëheqës, kolegëve dhe miqëve nuk do të arrija në përfundim të disertacionit tim. Prandaj është e pashmangshme të kalohet kjo pjesë pa u shkruar, sepse ndjej obligim moral të ju them një FALEMINDERIT gjithë juve që më ofruat ndihmë në çfarë do forme qoftë ajo.

Falemnderit pa fund udhëheqësit tim doktoral Prof. Dr. Arjan Kadareja, i cili nuk kurseu asgjë nga koha, profesionalizmi dhe eksperiencia e tij. I nderuar Profesor falemnderit që nuk hezitove asnjëherë të më japesh këshilla dhe sygjerime, madje edhe në prezencën e djalit tim të vogel, i cili ishte vetëm tre muaj. Është e vështirë të gjej fjalë që do shprehnin mirënjohjen ndaj jush.

Falenderime të përzemërta për prindërit e mij të cilët më rriten, edukuan dhe investuan tek unë, që të vazhdoj rrugën drejt dijes dhe suksesit.

Falenderime për bashkëshortin tim, i cili çdo herë më qëndroj pranë. Poashtu, falenderojë familjen e tij për kujdesin dhe mbështetjen e tyre morale.

Falenderime për koleget e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, të cilët me inkurajuan dhe me përkrahen çdo moment.

Mbi të gjitha falenderimi i takon Zotit të Gjithësisë që me solli pranë jush dhe më fali shendet te arrij deri këtu.

Fidane Spahija Gjikolli

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I: HYRJE.....1

1.1. Parathënie.....	1
1.2. Shtrimi i problemit.....	4
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza bazë.....	17
1.4. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit.....	19
1.5. Përmbledhje e shkurtër e literaturës kryesore.....	20
1.6. Mundësitë dhe kufizimet e studimit.....	21
1.7. Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit dhe gjetjet e tij.....	21
1.8. Përmbledhje e kapitullit.....	23

PJESA E PARË: RISHQYRTIMI I LITERATURËS DHE KUADRI TEORIK

KAPITULLI II: DEBATI, TEORITË KRYESORE TË NORMËS SË INTERESIT DHE DALLIMET E TYRE.....25

2.1. Debat i për normat e interesit sot.....	25
2.2. Teoritë kryesore të normave të interesit.....	26
2.3. Dallimet e teorive kryesore të normës së interesit.....	26
2.3.1. Esenca e shpjegimit.....	27
2.3.2. Fjalët e kyçe.....	28
2.3.3. Kuptimi dhe definimi i normës së interesit.....	29
2.3.4. Supozimet nistore.....	31
2.3.5. Variablat e pavarur.....	37
2.3.6. Marrëdhëniet dhe hipotezat.....	40
2.3.7. Mekanizmi veprues dhe modeli shkak-pasojë.....	48
2.3.8. Zgjidhjet dhe politikat.....	54
2.4. Përmbledhje e kapitullit.....	60

KAPITULLI III: PËRCAKTUESITË E MARZHIT NETO TË NORMAVE TË INTERESAVE SIPAS REZULTATEVE KONTABËL, TEORIKE DHE EMPIRIKE.....62

3.1. Analiza kontabël e marzhit neto të normave të interesave.....	67
3.2. Analiza teorike e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të normave të interesave.....	68
3.3. Analiza empirike rreth përcaktuesve të marzhit neto të normave të interesave.....	70
3.4. Përmbledhje e kapitullit.....	80

PJESA E DYTË: ANALIZA DHE STUDIMI EMPIRIK

KAPITULLI IV: SEKTORI BANKAR NË KOSOVË DHE NORMAT E INTERESIT.....82

4.1. Sektori bankar në Kosovë.....	82
4.1.1. Banka Qendrore e Kosovës dhe mbikëqyrja bankare.....	84
4.1.2. Bankat komerciale dhe veprimtaria e tyre.....	88
4.1.2.1. Pronësia e kapitalit dhe shkalla e koncentrimit bankar.....	92
4.1.2.2. Struktura e aseteve dhe kreditë.....	96
4.1.2.3. Struktura e detyrimeve dhe depozitat.....	103
4.1.2.4. Performanca dhe rreziqet e sektorit bankar.....	106
4.1.3. Normat e interesit dhe marzhi neto i tyre.....	112
4.1.3.1. Normat e interesit të kredive dhe depozitave.....	114
4.1.3.2. Variancat dhe tendecat e normave të interesit.....	118
4.1.3.3. Marzhi neto i interesit.....	120
4.2. Përmbledhje e kapitullit.....	123

KAPITULLI V: METODOLOGJIA.....124

5.1. Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik.....	124
5.2. Burimet e informacionit.....	125
5.3. Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit.....	129
5.4. Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.....	130
5.5. Përmbledhje e kapitullit.....	131

KAPITULLI VI: ANALIZA EMPIRIKE.....132

6.1. Specifikimi i modelit.....	132
6.2. Rezultatet empirike.....	142
6.2.1. Rezultatet sipas analizës statistikore deskriptive.....	143
6.2.2. Rezultatet nga analiza e regresionit.....	167
6.3. Testimi i hipotezave dhe analiza e gjetjeve.....	170
6.4. Përmbledhje e kapitullit.....	174

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....175

BIBLIOGRAFIA.....192

LISTA E TABELAVE

Tabela nr.1. Numri i lëndëve të proceduara në gjykata, 2001-2009.....	13
Tabela nr.2. Skenario historike dhe hipotetike e sistemit bankar në Kosovë.....	16
Tabela nr.3. Fjalët kyçe të teorive kryesore të normës së interesit.....	28
Tabela nr.4. Variablat e pavarur të teorive kryesore të normës së interesit.....	37
Tabela nr.5. Veprimtaria e bankave komerciale dhe numri i te punësuarëve.....	89
Tabela nr.6. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave.....	92
Tabela nr.7. Bankat komerciale në Kosovë dhe vend origjina e kapitalit të tyre.....	93
Tabela. nr. 8. Struktura e aseteve te sektorit bankar.....	98
Tabela. nr. 9. Struktura e detyrimeve e sektorit bankar.....	103
Tabela nr.10. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar.....	109
Tabela nr. 11. Norma efektive e interesit të depozitave, në përqindje.....	116
Tabela nr. 12. Norma efektive e interesit të kredive, në përqindje.....	117
Tabela nr.13. Marzhi neto i interesit të sektorit bankar në Kosovë (2001-2016).....	121
Tabela nr.14. Analizat statistikore deskritive e variablave, sipas shteteve.....	144
Tabela nr.15. Analizat statistikore deskritive e variablave, sipas pronësisë.....	150
Tabela nr. 16. T-testi, sipas pronësisë.....	154
Tabela nr.17. Mesatararja aritmetike e variablave sipas viteve dhe trendi 2007-2013.....	155
Tabela nr.18. Mesatararja aritmetike e variablave sipas shteteve dhe viteve.....	162
Tabela nr.19. Rezultatet ekonometrike, sipas modelit statik.....	168
Tabela nr.20. Rezultatet ekonometrike, modeli dinamik sipas shteteve.....	169

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku nr.1. Norma mesatare e interesit në kredi në vendet e Ballkanit.....	6
Grafiku nr.2. Margjina e interesit ne vendet e Ballkanit.....	6
Grafiku nr.3. Pronësia e kapitalit të bankave komerciale në Kosovë.....	10
Grafiku nr.4. Modeli shkak pasoje qe e ofron teoria austriake.....	48
Grafiku nr.5. Modeli shkak pasoje qe e ofron teoria neoklasike.....	49
Grafiku nr.6. Modeli shkak pasoje qe e ofron teoria e likuiditetit.....	51
Grafiku nr.7. Modeli shkak pasoje qe e ofron teoria e huasë.....	53
Grafiku nr.8. Struktura e aseteve të sektorit bankar, sipas pronësisë.....	94
Grafiku nr. 9. Shkalla e koncentrimit të sektorit bankar në Kosovë.....	95
Grafiku nr.10. Stuktura e aseteve te sektorit bankar.....	96
Grafiku nr.11. Raporti i kredive joperformuese në Kosovë dhe vendet e rajonit.....	109
Grafiku nr.12. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në Kosovë dhe vendet e rajoni.....	111
Grafiku nr.13. Normat e interesit ne Kosove dhe vendet e rajonit.....	113
Grafiku nr.14 : Variancat e normave të interesit për sektorin bankar në Kosovë.....	118
Grafiku nr.15: Tendencat e normave të interesit (2004-2016).....	119
Grafiku nr. 16. Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi për sektorin bankar në Kosovë.....	122
Grafiku nr. 17. NIM- i në Kosovë(2001-2016).....	123
Grafiku nr. 18. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter bankar.....	148
Grafiku nr. 19. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter makroekonomik.....	149
Grafiku nr.20. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter bankar, sipas pronësisë....	152
Grafiku nr.21. Mesatarja e variablave me karakter makroekonomik, sipas pronësisë.....	153
Grafiku nr.22. Mesatarja aritmetike e variablave bankar, sipas trendit 2007-2013.....	157

Grafiku nr.23. Mesatarja e variablave të tregut dhe makroekonomik, sipas trendit.....	157
Grafiku nr.24. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2007, sipas shteteve.....	163
Grafiku nr.25. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2008, sipas shteteve.....	163
Grafiku nr.26. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2009, sipas shteteve.....	164
Grafiku nr.27. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2010, sipas shteteve.....	164
Grafiku nr.28. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2011, sipas shteteve.....	165
Grafiku nr.29. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2012, sipas shteteve.....	165
Grafiku nr.30. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2013, sipas shteteve.....	166
Grafiku nr.31. Mesatarja e PBB-së, sipas shteteve dhe viteve.....	166
Grafiku nr.32. Mesatarja e HHI-së, sipas shteteve dhe viteve.....	167

LISTA E FIGURAVE

Figura nr.1. Numri i terminaleve ATM.....	90
Figura nr.2. Numri i terminaleve POS.....	90
Figura nr.3. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave.....	91
Figura nr.4. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje.....	97
Figura nr.5. Kreditë sipas sektorëve, ndryshimi vjetor.....	99
Figura nr. 6. Kreditë sipas sektoreve ekonomik, në përqindje.....	100
Figura nr.7. Kreditë sipas veprimtarive ekonomike, ndryshimi vjetor.....	101
Figura nr. 8. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje.....	102
Figura nr.9. Vlera e depozitave në sektorin bankar në Kosovë, ndryshimi vjetor.....	104
Figura nr.10. Stuktura e depozitave, ne perqindje.....	105
Figura nr.11. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit.....	106
Figura nr.12. Depozitat e afatizuara.....	106
Figura nr.13. Performanca financiare e sektorit bankar, ne milion euro.....	107
Figura nr.14. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar.....	108
Figura nr. 15. Skema konceptuale e studimit.....	133

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ABPK - Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës
AI – Të ardhurat nga interesi
AJI – Të ardhurat jointeresspruresë
AN – të ardhurat neto
ANI – Të ardhurat neto nga interesat
BA – Barra administrative
BB – Banka Botërore
BE – Banka Europiane
BE – Bashkimi European
BQ – Bankat Qendrore
BQK – Banka Qendrore e Kosovës
CR - Rreziku kreditor
ESH - Strukturës Efiçiente
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
GAP – Instituti për hulumtime dhe zhvillime
GIZ- Institucioni Gjerman për Bashkëpunim
Ndërkombëtar
HHI - Indeksi i përqendrimit Herfindahl-Hirschman
KJP – Kreditë joperformuese
LQ - Rreziku i likuiditetit
NIM – Marzhi neto i interesit
O - Pronësia
OE - Shpenzimet operative
OEA – Oda Ekonomike Amerikane
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto
PD - Çmimet e depozitave
PL - Çmimet e kredive
PP - Performanca e portfoliosë
QR - Qëndrimi ndaj rrezikut
RHK – Rezerva për humbje nga kreditë
ROA - Kthimet e fitimit mbi asetet
ROE - Kthimet e fitimit në kapitalin aksionar
S - Madhësia e bankave
SHBK – Shoqata e bankave të Kosovës
SHI - Shpenzimet për interesa
SHJI – Shpenzimet jointeresspaguese
SPH - Strukturë-Performancë
T – tatimi mbi fitimin e biznesit

KAPITULLI I: HYRJE

Borxhi është detyrimi i njërit, pasuria e tjetrit (Paul Krugman)

1.1. Parathënie

Krijimi i një sektori bankar të qëndrueshëm dhe të shëndosh është një ndër aspektet themelore të tranzicionit të vendeve të Ballkanit në një ekonomi tregu. Sistemi bankar është elementi më i rëndësishëm i sistemit financiar të këtyre vendeve, aktivet e të cilave zënë rreth 90 për qind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. Normat e interesit vazhdojnë të mbesin pjesë e debatit botëror. Që nga vitet '90 vendet e Ballkanit u përballen me vështirësi të shumëta gjatë transformimit të sistemeve të tyre të dobëta, të pazhvilluara dhe të cekëta financiarisht. Ndryshimet e shumta dhe të rëndësishme politiko-ekonomike, kanë ndikuar në zhvillimin dhe reformimin e sistemit bankar. Në shumicën e vendeve të Ballkanit e sidomos në Kosovë dhe Shqipëri sistemi bankar ka përjetuar kalimin nga një sistem monobankar drejt atij me dy nivele, procesin e privatizimit të bankave shtetërore, liberalizimin e normave të interesit dhe kredithënies, prezantimin e instrumenteve indirekte të politikës monetare, forcimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës, hapjen ndaj hyrjes së institucioneve financiare të huaja dhe së fundmi, edhe shkrirjet e bashkimit e bankave.

Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë, në eficiencën e funksionimit të bankave, në nivelin e konkurrencës me të cilën ato ndeshen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përditshme dhe në kostot e ndërmjetësimit ndër vite. Ndryshimet e shumëta gjatë kësaj periudhe e deri me sot, i bëjnë sektorët bankarë të këtyre vendeve një fushë e veçantë studimi. Sektori bankar në vendet e Ballkanit është shtylla kryesore e burimit të financimit. Bankat funksionojnë si aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhënësit të huamarrësit, prandaj është e rëndësishme që roli ndërmjetësues

i tyre të sigurojë një mirëqenie më të lartë për shoqërinë, mundësisht me kosto sa më të ulëta. Në këtë kontekst mori fillësën ky studim, duke synuar të identifikojë faktorët që ndikojnë marzhin neto të interesave (NIM) për sistemin bankar të disa vendeve të Ballkanit. Rritja e industrisë bankare në këto vende ka ndikuar në zgjerimin e ndërmjetësimit të kredisë dhe rritjes së përgjithëshme ekonomike, kështu duke ndikuar si burim kryesor të të ardhurave të bankës, përkatësisht të ardhurat neto nga interesi. Duke e pasqyruar se në zhvillimin e sektorëve bankar, varianca e të ardhurave neto nga interesi është një faktor i ndryshueshëm në luhatëshmërinë e fitimit, atëherë në këtë punim hulumtohet mbi përcaktuesit e marzhit neto të interesave, si faktor signifikant i hartimit të politikave efektive bankare. Marzhi neto i interesave shërben si matës i eficiencës së bankës dhe mund të llogaritet si raport i të ardhurave neto nga interesat me totalin e aktiveve apo me aktivet që sjellin të ardhura. Megjithatë, duhet marrë parasysh se një reduktim i këtij treguesi jo në të gjitha rastet sinjalizon përmirësim efieience. (Kalluci, 2010) Një reduktim i marzhit neto të interesave mund të shkaktohet nga një rënie në normën e tatimit apo rritje në normën e moskthimit të kredive nëse do merret parasysh zbërthimi kontabël i këtij treguesi. Në rastin e parë, reduktimi i marzhit neto të interesave mund të reflektojë përmirësim të funksionimit të sistemit bankar, kurse në rastin e dytë duhet pohuar e kundërta (Demirguç-Kunt, 1999).

Nga ana tjetër, nëse do të merret parasysh vetë formula e llogaritjes së marzhit neto të interesave, ndryshimi i tij mund të shkaktohet si nga luhatjet në numërues (të ardhura neto nga interesat) ashtu edhe në emërues (për shembull, aktivet që sjellin të ardhura). Perderisa niveli i lartë i NIM-it është tregues i joefikasitetit, marrjes së tepërt të rrezikut, mungesës së konkurrencës brenda sektorit bankar, marzhet e larta mund të nxisin sigurinë dhe

stabilitetin e sistemit financiar (duke u izoluar nga goditjet makroekonomike dhe goditjet e tjera), një çështje veçanërisht e rëndësishme në rastin e vendeve në zhvillim. (Winton, 1998). Në këto kushte, studimi i faktorëve që mund të shkaktojnë këto ndryshime në kostot e ndërmjetësimit, përbën një fushë interesante dhe gjerësisht të trajtuar nga literatura e huaj. Ky studim synon të matë efektet e strukturës bankare, të tregut dhe makroekonomike mbi marzhin neto të interesave të vendeve të Ballkanit, si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia për periudhën 2007-2013. Me fjalë të tjera, objektivi i këtij studimi është të përcaktojë se cili nga faktorët ka efekt më të lartë në normat e interesit në vendet e Ballkanit. Një qasje e tillë mund të jetë e dobishme për masat specifike të politikës ekonomike, duke marrë parasysh perspektivën e integritimit në BE, ndërkohë që fusha e margjinave neto të interesit është çdo herë në kërkim e sipër.

Duke u bazuar më lartë, ky studim paraqet dy risi të ndërlidhura. Së pari, literatura relevante kryesisht i konsideron sistemet bankare të zhvilluara me karakteristika relativisht të njëjta në operimin e mjedisit tyre (p.sh., Saunders dhe Schumacher, 2000, Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004). Dhe së dyti, në kontrast me shtetet në zhvillim, ky punim i shqyrton përcaktuesitë e NIM-it të sektorëve bankar në vendet në tranzicion, të tilla si vendet e Ballkanit.

Megjithatë, meqë industria bankare e këtyre vendeve vazhdimisht evoluon, ndryshimet në mjedisin institucional mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në marzhet neto të interesit. Prandaj, ky studim tenton të bëjë një analizë të drejtpërdrejtë të efektit të kapitalit, riskut të kredise, riskut të likuiditetit, shpenzimeve, pronësisë dhe madhësisë së bankave që kanë karakter bankar dhe variabla makroekonomike të tregut në NIM përmes shqyrtimit të të dhënave gjatë periudhës së tranzicionit. Grupe të ndryshme interesi, por sidomos

politikëbërësit janë të interesuar në ngritjen dhe funksionimin e sistemeve bankare që gëzojnë stabilitet dhe efikasitet. Stabiliteti kërkon kthime të mjaftueshme, ndërsa efikasiteti ekonomik kërkon marzhe jo shumë të larta të aplikuara nga bankat. Rezultatet e marra nga analiza e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave, mund të jenë të dobishme për hartimin e masave specifike të politikave ekonomike. Nëse për shembull, një pjesë e mirë e ecurisë së marzhit neto të interesave shpjegohet nga luhatshmëria e normave të interesit, politikat duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mund të krijojnë një mjedis makroekonomik stabil dhe me norma më pak të luhatshme. Nëse nga ana tjetër, marzhi neto ndikohet më shumë nga pozicioni i bankave në treg, kjo do të thotë se politikat duhet të orientohen drejt inkurajimit të rritjes së konkurrencës midis bankave. Në varësi të kontributit që çdo variabël (qëndrueshmëria ndaj rrezikut, rreziku i kredisë, shpenzimet operative, performanca e portfolios, etj.) jep në shpjegimin e marzhit të interesave, mund të orientohen edhe politikat e ndjekura ndaj aspekteve të veçanta të aktivitetit bankar.

1.2. Shtrimi i problemit

Rëndësia që ka industria bankare për zhvillimin dhe stabilitetin e çdo ekonomie u konfirmua edhe një herë nga kriza e fundit globale. Ishin pikërisht zhvillimet në sektorin bankar të cilat me shpejtësi u përhapën në pjesët tjera të sistemit financiar duke shkaktuar krizë financiare, e cila pastaj u shëndrrua në krizë të përgjithshme ekonomike.

Prandaj hulumtimi për normat e interesit ka tërhequr vëmendje të veçantë të shumë studiuesëve. Normat e interesit dhe përcaktuesitë e tyre janë debat botëror. Ato përfaqësojnë një fenomen që ia vlen të studiohet për shumë arsye. Arsyeja kryesore është se me


identifikimin e faktorëve që e ndikojnë margjinat e normave të interesit ne mund të kuptojm se pse qëndron ky problem i normave të larta të interesit. Me gjetjen se kush e influencon normën e lartë të interesit, mund të adresohen shume çështje tjera që i hapin rrugë dhe i hedhin dritë këtij studimi.

Për nga natyra i takoj një personi të sinqertë, të ndjeshëm dhe social. Përderisa punoja në një nga bankat komerciale në Kosovë, shpesh jam ndeshur me nevoja të ndryshme të individëve dhe bizneseve për kredi. Dhe shqetësimi im kryesor ishte se normat e interesit të kredive ishin shumë të larta dhe e ngarkonin shumë biznesin dhe individin, aq shume sa që shumë nga klientët kalonin në borxhlinjë dhe shumë biznese merrnin rrugën e falimentimit, në këtë mënyrë ekonomia çdo ditë e më shumë është duke u nënkredituar dhe po vazhdojmë të kemi një zhvillim jo të qëndrueshëm ekonomik. Shqetësimet për normat e larta shpesh i ndëgjojmë dhe i lexojmë në media të ndryshme. Që nga periudha e pasluftës e deri më sot, normat e larta të interesit në kredi mbetën një ndër çështjet më të diskutuara. Duke u nisur nga kjo problematikë e mori fillësën ky studim.

Pyetja që gjithnjë tentoja të jap përgjigje është se pse normat e interesit të kredive janë të larta!?


Sipas Bankës Botërore (2011), norma mesatare e interesit në kredi më e larta në rajon është në Serbi me 17.2%, duke pasuar me Kosovën me 13.8%, Shqipërinë me 12.4%, Malin e Zi me 9.7%, Maqedoninë me 9.9% dhe Bosnje e Hercegovinën me 7.4%. Po qe se e marrim parasysh normën reale të interesit duke përshtatur inflacionin, Kosova prapë prinë me normën më të lartë të interesit, kësaj radhe duke kaluar nga vendi i dytë në vendin e parë.

Grafiku nr.1. Norma mesatare e interesit në kredi në vendet e Ballkanit



Sipas institutit për zhvillime dhe hulumtime GAP, margjinat e interesit rajonal për vitin 2013 janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr.2. Margjina e interesit ne vendet e Ballkanit



Sa i përket zhvillimeve në sistemin bankar për vitet 2009–2013, të gjeturat e Bankometrit ndër vite kanë treguar se normat e interesit në kredi mbeten të larta si pasojë e shumë faktorëve si, ekonomia joformale, problemet me sistemin kadastral, mosfunksionimi i gjykatave, pamundësia e BQK-së për të injektuar likuiditet etj. (GAP, 2013)

Normat e interesit në kredi sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) në vitin 2016 për vendet, siç janë: Bosnja dhe Hercegovina (5.7%), Kosova (7.7%), Mali i Zi (8.5%), Maqedonia (6.8%) dhe Shqipëria (8.4%), kanë norma të larta të interesit të kredive krahasuar me vendet e Bashkimit Europian (BE-së) me ekonomi të zhvilluar të tregut, të cilat sipas Bankës Qendrore Europiane, norma maksimale e interesit për kredi ka qenë 3% në vitin 2011 dhe minimalja 0.8% në vitin 2016. Nga ky krahasim shohim se normat e interesit të kredive në këto vende të Ballkanit mbeten akoma të larta dhe problem për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Qëndrueshmëria ndaj rrezikut apo kapitali në raport me mjetet e bankës është një nga faktorët që mund të ndikojë marzhet neto të interesit. Ky faktor shërben si një tregues për rrezikun e falimentimit dhe vlerën e tregut të aktiveve (Maudos dhe Fernández deGuevara, 2004). Kapitali vepron si rrjet i sigurisë në rast të zhvillimeve të pafavorshme. Në të vërtetë, rreziku nga falimentimi ndikon në të ardhurat e firmës nëpërmjet primeve të rrezikut që banka duhet të paguajë për të marrë fonde hua. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme në vendet në tranzicion për shkak të përqindjes së lartë të kredive joperformuese në portofolin e huave. Nga ana tjetër, pasi ekuiteti është një burim relativisht i shtrenjtë i financimit, një rritje e kapitalit në baza vullnetare ose si rezultat i rregullimit mund të rrisë koston mesatare të tij. (Angbazo, 1997) (Schumacher, 2000) (Drakos, 2002) (Martinez Peria M. M., 2004). Dhe si rezultat, mund të kërkohet NIM më i lartë. (Saunders dhe Schumacher, 2000). Megjithatë, bankat me mjaftueshmëri të konsiderueshme të kapitalit po përballen me rrezik më të ulët të falimentimit duke ulur kështu kostot e tyre të financimit dhe janë në gjendje të kenë marzhe më të larta duke u ngarkuar me më shumë

kredi apo të paguajnë më pak për depozitat (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sologoub, 2006). Për më shume, mbajtja e kapitalit të tepruar është një mjet për bankat që të sinjalizojnë aftësinë paguese dhe aftësinë kreditore dhe të frymëzojnë besimin e depozituesëve, veçanërisht në vendet në zhvillim apo në periudhat e krizës financiare (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007). Kjo veçori do të nxisë depozituesit, sidomos pjesëmarrësit profesional të tregut, të veprojnë me maturi dhe të shmangin depozitimin e parave në bankat me kapital të keq. Kur depozituesit ushtrojnë "disiplinën e tregut të depozituesve", kjo mund t'i lejojë bankës të ulë depozitën e saj, shpenzimet e financimit dhe rrjedhimisht, të rrisë diferencën e saj të interesit. Problemi i njëjtë qëndron edhe tek ne se mbajtja e lartë e kapitalit në bankat komerciale po bën që bankat të janë të sigurta dhe kanë likuiditet të mjaftueshëm, kredihënien e japin me normë të lartë dhe vetëm për klientet e sigurtë, ndërsa normat e depozitave janë me një interes fare të vogël, sa që edhe të mos depozitohet fare, më nuk është aspak e rëndësishme. Kështu duke arritur fitime apo marzhe të larta kjo u shkon në interesin e tyre, pa menduar fare për individin, biznesin dhe ekonominë në tërësi. Kthimi i kapitalit nga bankat në Kosovë është më i larti në rajon. Sipas Bankes Botërore (2010), Kosova prin me 15.9%, Shqipëria 12.2%, Maqedonia 8.4% e kështu me radhë. Sipas FMN dhe bankave qendrore të vende përkatëse në hulumtim (2016), treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në Serbi është 20.9%, Kosova 19%, Shqipëria 15.7, Maqedonia 15.5% dhe Bosnja e Hercegovina 15%. Ndërsa përqindja e rezervës së detyrueshme të mbajtjes së kapitalit sipas rregullit të Bankave Qendrore të vendeve përkatëse në hulumtim gjatë vitit 2016 është 12% në Kosovë, Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë dhe Serbi ndërsa 8% është në Maqedoni. Pra, bankat qendrore janë ato që

përcaktojnë nivelin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit, ndërsa faktet tregojnë se bankat komerciale në Kosovë dhe vendet tjera të rajonit mbajnë më shumë kapital se niveli minimal. Që do të thotë se në rastet e vendeve të hulumtuara si Kosova dhe disa nga vendet e Ballkanit, bankat komerciale qenkan përcaktuesitë e mbajtjes së kapitalit.

Kreditw jperformuese, janë ndër shkaktarët e normave të larta të interesit. Bankat që kanë të bëjnë me kredi të rrezikshme janë të detyruara të mbajnë një sasi më të lartë të provigjoneve. Nga ana tjetër, kjo mund t'i detyrojë ata për të ngarkuar margjina më të larta të interesit në mënyrë që të kompensojë rrezikun më të lartë të parazgjedhur, duke çuar natyrshëm në një pozitive. (Drakos, 2002) (Guevara, 2004)

Kreditë jo - performuese (KJP) në Kosovë janë më të ulëta në rajon me 5.9%, duke pasuar me Maqedoninë me 9.1%, Bosnje dhe Hercegovinën me 11.7%, Shqipërinë me 14.4%, Malin e Zi me 15.5%, dhe Serbinë me 18.6%. (BQK, Raporti vjetor, 2015)

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (2012), kreditë jperformuese i ka konsideruar si të humbura rreth 60%, tre fish më shumë se sa në Shqipëri, ku vetëm 19.9% të KJP-ve konsiderohen si të humbura.

Sipas FMN dhe bankave qendrore të vendeve përkatëse në vitin 2015, përqindja e kredive jo performuese është si vijon: Kosova 6.2%, Maqedonia 10.3%, Bosnja dhe Hercegovina 13.7%, Shqipëria 18.2% dhe Serbia 21.6%. Ky nivel i përqindjes konsiderohet i lartë kur krahasohet me vendet e UE-së të cilat kanë pasur normë minimale të përqindjes së kredive jperformuese 2% në vitin 2011, 8 % në vitin 2013 dhe prap ka vazhduar me një trend rënës në 5% në vitin 2016. (BQE, 2016)

Sipas publikimit të GAP-it, thuhet se mesatarja më e lartë e normave të interesit për kreditë për biznes ka qenë në vitin 2009 me 13.8 për qind, ndërsa më e ulëta në vitin 2010

me 12.7 për qind. Kjo zbritje në mesatare ka ardhur kryesisht nga ulja e normave të interesit nga bankat me pjesëmarrje më të ulët me asete në sistemin bankar komercial siç janë BPB dhe NLB apo më mirë të themi nga bankat me pronësi vendore.

Një nga faktorët që mund të konsiderohen se normat e interesit janë të larta është edhe *pronësia e kapitalit të bankave* e cila mund të jetë vendore apo e huaj. Sipas Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999) e gjejnë atë se bankat e huaja kanë tendencë të kenë edhe margjina edhe fitime më të larta. Në të kundërt, Martinez Peria dhe Mody (2004) të cilat kanë studiuar bankat e Amerikës Latine dhe sugjerojnë që bankat e huaja janë në gjendje të ngarkojnë spread-a më të ulëta në krahasim me bankat vendase. Demirgüç-Kunt et al. (2004), përfundojnë se shkalla e pronësisë shtetërore të industria e bankave lidhet pozitivisht me margjinat e interesave. Sapienza (2002) gjen prova se bankat me pronësi shtetërore ngarkohen me norma të ulëta të interesit, veçanërisht për firmat e vendosura në rajone dhe me ndikim të fortë politik. Në tregun bankar të Kosovës, operojnë gjithsej dhjetë banka, dy prej tyre operojnë me pronësi vendore, e ato janë: Banka Ekonomike dhe Banka për Biznes, kurse tetë të tjerat operojnë me kapital në pronësi të huaj.

Grafiku nr. 3. Pronësia e kapitalit të bankave komerciale në Kosovë



Gati në të gjitha vendet e Ballkanit, mbizotëron gjendje e njëjtë për sa i përket pronësisë së kapitalit të bankave komerciale.

Sipas një sondazhi nga Shoqata e Bankave të Kosovës (2014), që është bërë tek bankat komerciale në Kosovë rreth pyetjes se cilat janë sfidat kryesore të bankave dhe se a janë normat e larta të interesit? Rezulton se *menaxhimi e rrezikut apo risku kreditor*, si gjithmonë është sfida më e madhe për industrinë bankare si dhe efikasiteti i sistemit ligjor. Rreziku mund të vijë në shumë forma dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me rrezikun e kredisë. Ka edhe rreziqe operacionale, rreziqe likuiditeti, dhe rreziqe tregu. Mendohet se rreziqet e likuiditetit janë minimale në këtë moment, por ka ende sfida të menaxhimit të likuiditetit të tepërt që është aktualisht në banka. Megjithatë, sfida më e madhe e rrezikut është padyshim rreziku i kredisë pasi që ka shumë ndikime, disa brenda kontrollit dhe disa jashtë kontrollit, nga jashtë, të tilla si ndryshimet makro-ekonomike në vendet mëmë të bankave të huaja ose efekti i krizave. Përveç menaxhimit të rrezikut, industria bankare në Kosovë po ashtu përballlet me sfida në fusha të tilla si efikasiteti dhe besueshmëria e sistemit ligjor. Sa i përket normave të larta të interesit sondazhi rezulton se janë të larta sidomos ato të kredive në raport me vendet e rajonit por kjo varet shumë edhe nga të ardhurat e konsumatorëve, qoftë biznes apo individ.

Sipas kryetarit të bordit të SHBK, njëkohësisht edhe drejtor ekzekutiv i Raiffeisen Bank në Kosovë, Robert Wright, gjatë një pyetësi, thekson se normat e interesit përcaktohen kryesisht nga risku që bankat janë duke marrë. Nëse një klient biznesi ka një plan të mirë biznesi me avantazhe të qarta konkurruese dhe të qëndrueshme të mbështetura nga pasqyra të audituara financiare dhe kolateral të mirë atëherë normat e interesit mund të

jenë rreth 8 apo 9%. Nëse asnjë nga këta faktorë nuk janë në vend atëherë norma e interesit mund të jetë 14 ose 15%.

Çështja më bëri shumë kureshtare dhe menjëherë pas propozimit doktoral që kishim, fillova të realizoj disa intervista të drejtëpërdrejta me disa drejtuesë të degëve të bankave komerciale në Kosovë lidhur me normat e larta të interesit në kredi dhe normat e ulëta të interesit në depozita. Kryesisht përgjigjet e tyre u adresonin zhvillim të dobët ekonomik, riskut të lartë dhe pasigurisë. Ky risk i lartë thuhet se është si rezultat i dobësive të mëdha në organet legjislative siç janë gjykatat dhe tërheqja e kolateralit të lënë peng është tejet e vështirë sidomos në Kosovë ku kemi akoma probleme me pronat serbe dhe uzurpimet. Këtë gjë e konfirmojn edhe studimet tjera të bëra, të paraqitura në vjim të punimit. Ndërsa sa i përket normave të ulëta të interesit në depozita, kjo vënie si pasojë e likuiditetit të tepruar që kanë bankat dhe nuk kanë fare interes për deponim të mjeteve tjera.

Për institucionet bankare është jetike *zbatimi i ligjit*. Fatëkeqësisht, Kosova ende listohet në vendin 136 nga gjithsej 189 vende sa i përket zbatimit të kontratave (raporti i të bërit biznes të Bankës Botërore, 2015). Kjo i mohon industrisë bankare instrumentin kryesorë mbi të cilin funksionon sistemi financiar, respektivisht zbatimin e kontratës së nënshkruar me klientin. Sipas drejtorit ekzekutiv të Shoqatës së bankave në Kosovë, sistemi gjyqësor vazhdon të ketë mbi 10,000 lëndë të sistemit financiar të pa përfunduara e që paraqet rreth gjysëm miliard euro që nuk janë në funksion të ekonomisë vendore. (Balija, 2014) Raporti kolateral-kredi, respektivisht raporti i mbulimit të kredive me kolateral në Kosovë në vitin 2010 ishte 236.1% e që është ndër më të lartat në regjion (mesatarja në rajon ishte 126.6%). Për më tepër, në Kosovë vetëm 55% e vlerës së kredisë

të dështuar mund të kthehet përmes kolateralit të lënë peng. Këtu gjykatat nuk kryejnë rolin e tyre si duhet dhe bankat e kanë të vështirë që të përfitojnë nga kolaterali. (GAP, 2011)

Vendimet e gjykatave që kërkojnë transferimin e mjeteve nga llogaria e debitorit (borxhliut) në llogarinë e kreditorit (borxh-dhënësit) ekzekutohen rrallë, apo fare, me gjithë faktin që këto vendime të gjykatave janë vendime definitive. Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur numrin e lëndëve të proceduara nga gjykatat ndërmjet viteve 2001-2009 dhe reagimet/përgjigjet e bankave.

Tabela nr.1. Numri i lëndëve të proceduara në gjykata, 2001-2009

Vitet	Lëndët	Nuk ka përgjigje nga banka	%	Përgjigjet e bankave "klienti nuk ka xhirollogari në bankë"	%
2001	2	1	50	1	50
2002	6	5	83.33	1	16.67
2003	16	11	68.75	5	31.25
2004	30	20	66.67	10	33.33
2005	25	16	64	9	36
2006	49	31	63.27	18	36.73
2007	33	16	48.49	17	51.51
2008	61	21	34.26	40	65.74
2009	33	10	30.30	23	69.70
Gjithsejt	255	131	51.37	124	48.63

Burimi: Gjykata ekonomike e Republikës së Kosovës

Kreditimi i qëndrueshëm i ekonomisë pa dyshim se kërkon edhe kushte më të favorshme për kredimarrësit, përmes së cilave stimulohet kërkesa për kredi dhe nxitet aktiviteti i përgjithshëm ekonomik. Kreditimi nga bankat konsiderohet si burimi kryesor i financimit të jashtëm të ndërmarrjeve, për vendet në tranzicion. (Albulescu., 2009) Raporti i Stabilitetit Financiar 2012 të Bankës Qendrore konfirmon se pas vitit 2008 ka pësuar

ngadalësim të rritjes së kreditimit për ndërmarrjet, e cila padyshim që vë për shkak të mospërbushjes së kushteve për dhënien e kredisë, përveç tjerash, edhe për shkak të gjendjes ekonomike në Kosovë dhe vendet tjera të rajonit. *Nënkreditimi* i ekonomisë së vendeve të Ballkanit, mbetet një ndër problemet kyçe që kanë lidhshmëri me normat e larta të interesit. Sa më e zhvilluar dhe e qëndrueshme ekonomia, tentohet të ipet më shumë kredi dhe normat do të ulëshin, dhe anasjelltas. Gjendja ekonomike përdoret si argument dhe kritikë ndaj bankave për uljen e normave të interesit. Sidoqoftë, këtu tejkalohet një fakt shumë i rëndësishëm, se midis gjendjes së rëndë ekonomike dhe bankave duhet të jetë dhe shteti funksional.

Andaj, përkundër rënies së deritanishme të normave të interesit, mbetet sfida zvogëlimi i mëtutjeshëm i tyre. Duke ditur se pjesa më e madhe e shpenzimeve të bankave përbëhet nga shpenzimet operationale, atëherë zvogëlimi i normave të interesit kërkon rritje të efikasitetit operacional të bankave. Rritja e efikasitetit të bankave tani më mund të vlerësohet se është një proces më i lehtë, duke pasur parasysh se bankat kanë arritur një nivel të kënaqshëm të konsolidimit të infrastrukturës dhe të profesionalizmit të personelit të tyre. Sidoqoftë, rritja e efikasitetit operacional të bankave është proces kompleks dhe, përveç faktorëve nën kontrollin e bankave, ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm. Për shembull, joefikasiteti i mjaftueshëm i sistemit gjyqësor në Kosovë pasqyrohet drejtpërsëdrejti edhe në efikasitetin e sektorit bankar.

Një nivel më i lartë përqendrimi do të thotë më tepër fuqi nga ana e bankave, çka mund të sjellë në marzhe më të larta interesi. *Struktura e tregut* në shumë studime është matur me Indeksin e përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI), i cili mund të jetë i matshëm në

terma të aseteve, kredive dhe depozitave. Fuqia e tregut, nënkupton atë që bankat mund të zbatojnë margjina më të larta të interesit, ose duke vendosur norma më të ulëta të depozitave ose norma më të larta kredie ose duke ushtruar të dyja se bashku. Një literaturë e gjerë studion ndikimin e përqendrimit në përfitueshmërinë e bankës (Berger, 1995b). Një sistem bankar më i përqendruar do të sillet në mënyrë oligopolistike dhe një përqendrim më i lartë do të sjellë vendosjen e marzheve më të larta. (Carbo dhe Rodriguez, 2007) dhe e kundërta që pohon se përqendrimi prodhon rritje efieçience (në terma të reduktimit të kostove) duke shkaktuar rënie të marzheve. (Demsetz, 1973) . Sipas Demirgüç-Kunt et al. (2004), nëse përqendrimi i bankave pasqyron vetëm kufizimet rregullatore mbi konkurrencën, atëherë çdo marrëdhënie pozitive midis margjinave të bankave dhe përqendrimit duhet të zhduken kur kontrollojnë kufizimet rregullatore.

Sipas një skenario historike dhe hipotetike e sistemit bankar (vlerat në miliona Euro) e bërë nga Edon Xhara, analist i riskut në korporata të Raiffesisen bank në Kosovë, thotë se mundësitë për uljen e normës së interesit janë të pakëta, përshkak problemeve të shumëta që kryesisht ia drejton shtetit. Sipas llogaritjes nga të dhënat e BQ, analiza mesatare për 6 vite, nga një model më i thjeshtë , ku:

$$\text{Normat e Interesit në kredi apo të hyrat nga interesi} = \text{Shpenzimet e Interesit (Depozitat dhe Huazimet)} + \text{Rreziku (Provizionet apo humbjet nga kreditë e këqija)} + \text{Shpenzimet Operative (Pagat dhe shpenzimet tjera)} + \text{Net Profiti}$$

Pra, në qoftë se bankat heqin dorë nga profiti, ato prap duhet t'i paguajnë depozitarët e vet, duhet t'i llogarisin humbjet nga kreditë e këqija (provizionet), dhe duhet ti paguajnë punëtorët dhe shpenzimet e tjera të saj.

Sipas llogaritjes nga kjo analizë kur bankat janë me fitim zero apo gjinden në pikën kritike të rentabilitetit, norma më e vogël e mundshme është 11.5%. Pra, bankat nuk kanë levërdi të punojnë nën 11.5% normë mesatare të interesit, përndryshe ato do operonin me humbje, që është në kundërshtim me disa deklaratat se bankat duhet të punojnë me 6%, 8% apo 10%. Për më detalisht lidhur me analizën nëpër vite është paraqitur tabela e mëposhtme.

Tabela nr.2. Skenario historike dhe hipotetike e sistemit bankar në Kosovë

Viti	2008		2009		2010		2011		2012		Mesatarja për 6 vite		Mesatarja	Mesatarja	Mesatarja
Skenario	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Historik	Pa fitim	Humbje	Humbje	Humbje
Norma efektive mesatare e interesit	14.70%	11.10%	14.30%	11.60%	14.60%	11.50%	14.10%	11.05%	13.40%	11.80%	14.20%	11.48%	10.00%	8%	6%
Total të hyrat e sistemit bankar	195		203.3		217.2		240		247.2		221	186			
Të hyrat nga interesi	155.7	117.7	164.6	133.2	175.8	138	195.0	152.8	199.8	176.4	178.2	143.6	125.3	100.2	75.2
Shpenzimet e interesit	-43.1	-43.1	-52.1	-52.1	-55.3	-55.3	-58.4	-58.4	-63.1	-63.1	-54.4	-54.4	-54.4	-54.4	-54.4
Shpenzimet e provizionit	-22.8	-22.8	-33.4	-33.4	-28.3	-28.3	-34.2	-34.2	-50.2	-50.2	-34	-33.8	-33.8	-33.8	-33.8
Shpenzimet operative	-91.1	-91.1	-86.4	-86.4	-95.8	-95.8	-105	-105.2	-111	-110.5	-97.8	-97.8	-97.8	-97.8	-97.8
Profiti para të hyrave tjera	-1.3	-39.3	-7.3	-38.7	-3.6	-41.4	-2.8	-45	-24	-47.4	-8	-42.4	-60.7	-85.8	-110.8
Të hyrat tjera	39.3	39.3	38.7	38.7	41.4	41.4	45	45	47.4	47.4	42.4	42.4	42.4	42.4	42.4
Total profiti i sistemit bankar	38	0	31.4	0	37.8	0	42.2	0	23.4	0	34.4	0	-18.3	-43.4	-68.4

Burimi: Shoqata e bankave të Kosovës (SHBK)

Sipas Guvernatorit të BQK-së, faktorë të tjerë të rëndësishëm që ndikojnë në nivelin e normës së interesit në kredi janë edhe faktorët e lidhur me bizneset, siç janë dobësitë në cilësinë e raportimit financiar dhe kapacitetet e bizneseve për të bërë planifikim adekuat të afarizmit të tyre. Të gjitha këto paraqesin *shpenzime shtesë të bankave* për të bërë vlerësimin adekuat të aplikacioneve për kredi. Për më tepër, duke ditur se afarizimi bankar është biznes mjaft i ndjeshëm dhe bankat duhet të kenë në konsideratë të gjithë faktorët që

mund të ndikojnë në stabilitetin e tyre, atëherë kuptohet se problemet e lartëcekura ndikojnë në rritjen e nivelit të perceptuar të rrezikut nga bankat, gjë e cila pastaj reflektohet edhe në lartësinë e normës së interesit. (Hamza, 2014) Të njëjtin problem që e ka ngritur guvernatori është cekur edhe nga disa hulumtues lidhur me raportimin financiar të bizneseve që po ndikojnë në normat e larta të interesit. Dihet se në Kosovë kualiteti i raportimit financiar është i dobët dhe se shumica e kompanive nuk i auditojnë pasqyrat e tyre financiare. Sipas Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe kompanisë konsulente “Baker Tilly Kosovo” (2012), nga mijëra ndërmarrje të regjistruara në vend, vetëm 150 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat e audituara financiare. E dyta, një pjesë e konsiderueshme e bizneseve në Kosovë raportojnë humbje apo fitime minimale për shkak të evazionit të lartë fiskal në vend, që sipas Institutit Riinvest, është rreth 40%. Këtë e konfirmon edhe raporti “Çasja në Financa 2012” nga Bashkimi Evropian, duke pohuar transparencën e ulët të bizneseve dhe mbajtjen e dy palë pasqyrave financiare. E treta, i njëjti burim pohon se në shumicën e rasteve, strukturat menaxhuese të kompanive në Kosovë përbëhen prej pronarëve apo familjarëve të tyre, dhe jo nga menaxher kompetent dhe profesional. Shpesh pronarët apo familjarët janë drejtor, menaxher dhe kontabilist. Një gjendje e tillë i klasifikon bizneset me profil më të lartë rreziku, që rrjedhimisht rrit nivelin e interesit në kredi. Duke i identifikuar dhe analizuar faktet, argumentuar ato, mund të them se këto e bëjnë punimin karakteristikë dhe të veçantë duke i ngritur në hipoteza dhe duke i vërtetuar empirikisht në kapitujt e mëposhtëm.

1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza bazë

Ky punim ka një interes të veçantë për rolin dhe influencën mbi marzhin neto të normave interesit, dhe do të tentojë tu jap përgjigje disa pyetjeve. Ky studim mbështetet në 4 pyetje kërkimore dhe 4 hipoteza:

Pyetja qendrore e punimit është: Pse, biznese dhe individë në vende si Kosova i perceptojnë si tejet të larta normat e interesit të kredive bankare, në të njëjtën kohë kur normat e interesit të depozitave perceptohen si mjaft të ulta?

Pyetjet sekondare të punimit janë:

- Cilat janë efektet tek marzhet neto të normave të interesit e faktorëve të tillë të rrezikut si raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuar me rrezikun, shpenzimet operative, raporti kredi/mjetet totale, raporti kredi jo performuese/kredi bruto, si edhe raporti mjete likuide/mjetet totale?
- Pasi kontrollojmë për faktorët e tjerë, kush ndikon me shumë në rritjen e marzhit neto të normave të interesit: bankat me pronësi të huaj apo bankat me pronësi vendore?
- A është shkalla relativisht mesatare e konkurrencës në sistemin bankar një nga faktorët e rritjes së marzhit të normave të interesit?

Hipoteza bazë e këtij punimi është: Në vende si Kosova, një nivel mjaft më i lartë i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit bankar, relativisht nivelit minimal të kërkuar nga banka qendrore, siguron qëndrueshmërinë e bankave në rast humbjesh të mëdha e të papritura, nga njwra anë, por është edhe faktori kryesor në rritjen e marzhit neto të interesit, nga ana tjetër.

Hipoteza 2: Efektet e performancës së portfoliosë, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit i bashkëngjiten efektit të kapitalit në rritjen e marzheve neto të normave të interesit.

Hipoteza 3: Bankat e mëdha me pronësi të huaj kanë marzhe më të larta në kahasim me bankat e vogla me pronësi vendore.

Hipoteza 4: Rritja e konkurrencës bankare ndikon në uljen e marzhit neto të normës së interesit.

1.4. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe metodave të hulumtimit

Investigimi i këtij studimi është bërë për bankat e nivelit të dytë përkatësisht për bankat komerciale të vendeve të Ballkanit, si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina, dhe Serbia. Të dhënat i përkasin periudhës 2007-2013. Të dhënat janë marrë nga Banskope dhe raportet vjetore të bankave qendrore të këtyre vendeve. Gjithashtu, ky studim përdor hulumtime të rëndësishme të Bankës botërore, FMN-së, Bankës Evropiane, dhe hulumtuesëve tjerë të kësaj lëmie e që janë paraqitur në punim. Të gjitha këto të dhëna janë mbledhur dhe janë përpunuar nga autori në programin excel duke i bartur pastaj në programin STATA për vlerësim dhe nxerrje rezultatesh. Metodat që janë përdorur është ajo e analizës përshkruese, krahasuese dhe e regresionit, përmes të cilave arrita të bëjë testimin e hipotezave e deri te rezultatet përfundimtare. Modeli bazë i përdorur në literaturë për identifikimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të normave të interesave, është ai i ndërmjetësimit¹, i përdorur për herë të parë nga Ho dhe Saunders (1981), sipas të cilit

¹ Dealer Model (Ho & Saunders, 1981)

bankat shihen si ndërmjetës financiare kundërshtarë të rrezikut. Më pas, autorë të tjerë kanë punuar mbi këtë model, duke paraqitur në studimet e tyre edhe përmirësime e përshtatje me gjendjen specifike të ekonomive ku është aplikuar. Debati empirik që pasoi sugjeroi dy qasje empirike për analizën e NIM-it, një qasje e vetme dhe dyfazore. Në punim është përdorur metoda e regresionit linear, panel data me qasjen dy fazësh. Në gjitha variablat e përdorura në punim përmbajnë karakteristika. Poashtu në këtë punim, shqyrtohen karakteristikat e sipërmendura kështu duke i vlerësuar me modelet statike, dinamike dhe empirike.

1.5. Përmbledhje e shkurtër e literaturës kryesore

Një kuadër tejet teorik mbi përcaktuesit e NIM u paraqit nga Ho dhe Saunders (1981). Ky kuadër teorik është zgjeruar nga shumë studime të tjera, të tilla si Maudos dhe Fernández de Guevara (2004), Claves dhe Vander Venet (2007). Lidhur për normat e interesit ka literaturë të mjaftueshme si në aspektin e viteve ashtu edhe në aspektin përmbajtësor. Interesi lidhur me studimin e normave të interesit është në rritje e sipër, kjo përshkak ndikimit të madh të tyre në ekonomi dhe si burim i vetëm i financimit për biznese dhe individ. Keqtrajtimi i normave të interesit dhe mos menaxhimi efikas i tyre në shumë vende i ka sjellur në kriza të ndryshme financiare. Kriza të cilat linden nga bankat dhe u bënë kriza globale duke i përfshi tregjet dhe botën në tërësi. Mos të shkojmë më larg se kriza e vitit 2008 e cila lindi pikërisht nga bankat si pasojë e kredive hipotekare. Literatura e shtjelluar për hartimin e këtij punimi kryesisht është e huaj, dallojnë vendet, variablat të cilat u janë përshtatur ekonomive të ndryshme. Poashtu ka dallim periudha e studimit. Në

funksion të përmbushjes së objektivave të këtij studimi, kryesisht është shfrytëzuar literatura që trajton përkufizimet e normave të interesit, përcaktuesit e tyre dhe modelin bazë të ndërmjetësimit me qasje dyfazore. Rëndësi të veçantë në literaturën e marrë në shqyrtim zë analiza dhe rezultatet e karakteristikave bankare dhe makroekonomike që përcaktojnë marzhin neto të interesit të vendeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore. Literatura për normat e interesit dhe përcaktuesitë e tyre çdo ditë e më shumë po pasurohet, duke ngërthyer në vete shumë aspekte teorike, raste studimore dhe empirike. Shumica e të dhënave empirike për të gjitha vendet ka qenë e aksesueshme dhe për këtë arsye kjo ndikon pozitivisht për hartimin e këtij punimi. Studimi për marzhet neto të interesave është bërë nga shumë autorë të ndryshëm, për një vend të vetëm dhe për disa vende së bashku. Karakteristikë e këtij punimi që e bën më pozitiv është se punimi studion disa vende së bashku siç janë këto të Ballkanit e jo veç e veç sikurse disa nga studimet tjera. Prandaj, nga ky studim nxjerren krahasime mes viteve dhe shteteve për një periudhë të ndryshme të studimit në krahasim me literaturën egzistuese.

1.6. Mundësitë dhe kufizimet e studimit

Ky studim jep analiza, udhëzime, njohuri bazë mbi përcaktuesitë e marzhit neto të interesit në disa vende të Ballkanit. Supozohet se ky studim ka rëndësi të madhe për arsye se ju vjen në ndihmë bizneseve dhe individëve, njëkohësisht drejtuesëve dhe politikëbërësve për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sikurse çdo punim që i ka avantazhet dhe disavantazhet e veta, njëjtë vlen edhe për këtë punim. Periudha 2007-2013 është një periudhë tranzicioni, me ç'rast është bërë hulumtimi. Kjo mund të konsiderohet njëfar mënyre si kufizim dhe mundësi e hulumtimit në të ardhmen për periudhen pas 2007 e në

vijim. Pastaj, kufizim mund të konsiderohet numri i vende të Ballkanit të përfshira në punim me gjithsej 460 banka komerciale. Ku në të ardhmen është shumë mundësi e mirë të investigohet edhe një analizë paneli për bankat dhe vendet e tjera. Gjetja, qasja dhe identifikimi i të dhënave në fillim ishte e vështirë, përshkak të mungesës së një bazë të saktë të të dhënave dhe mungesës së disa karakteristikave të bankave për vitet e hulumtuara mirëpo me ndihmën e mentorit dhe kolegëve të punës u realizua kjo pjesë e hulumtimit. Pra, kufizimet kryesisht kanë të bëjnë me vitet e përfshira në hulumtim, numrin e bankave dhe variablat e përdorur. Variablat e tjerë të karakterit makroekonomik dhe rregullativë janë mundësi e mirë e hulumtimit dhe vazhdimit të këtij studimi në të ardhmen.

1.7. Shpjegim i shkurtër i strukturës së punimit dhe gjetjet e tij

Studimi është i strukturuar në dy pjesë kryesore, me gjithsej shtatë kapituj. Pjesa e parë përmban aspektin teorik ndërsa pjesa e dytë përmban aspektin empirik. Aspekti teorik ngërthen në vete debatet, shkollat, teoritë, hipotezat mbi fushën e normave të interesit, vazhdon me investigimin mbi përcaktuesitë e marzhit neto kontabël, teorik dhe empirik. Ndërsa pjesa empirike fillon me paraqitjen dhe analizimin e sistemit bankar në Kosovë dhe vazhdon me rastin empirik të vendeve të Ballkanit. Me konkretisht, në seksionin e dytë do të trajtohet kuadri teorik mbi normat e interesit, debatet, teoritë dhe dallimet e tyre. Në seksionin e tretë paraqitet identifikimi i përcaktuesve të marzhit neto të interesave sipas modelit kontabël, modelit teorik si edhe rezultatet empirike të marra nga studime të ndryshme. Në seksionin e katërt kalohet në një pamje të përgjithshme të sistemit bankar në Kosovë dhe të ecurisë së normave të interesave. Në seksionin e pestë paraqitet metodologjia, metodat dhe instrumentet e studimit. Në seksionin e gjashtë analizohen nga

pikëpamja empirike faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave të bankave që operojnë në vendet e Ballkanit, kështu duke i paraqitur rezultatet dhe analizen e gjetjeve. Në bazë të rezultateve ekonometrike dhe testimit të hipotezave, ky punim vë në pah këto gjetje: 1) Faktori më influencues që i jep përgjigje hipotezës bazë është kapitali bankar. Me këtë nënkuptojmë se mbajtja e nivelit të lartë të kapitalit ndikon në lartësinë e marzhit neto të normave të interesit. 2) Bankat e mëdha dhe me pronësi të huaj kanë ndikim më të madh në marzhin neto të normave të interesit sesa bankat e vogla me pronësi vendore. 3) Efektet e performancës së portfoliosë, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit janë pozitive kundrejt marzheve neto të normave të interesit. Dhe me rritjen e këtyre variablave rritet edhe marzhi neto i normës së interesit. 4) Shkalla e konkurrencës, rezulton me shkallë jo relativisht të lartë. Me këtë nënkuptojmë se shkalla jo e lartë e konkurrencës ndikon në rritjen e marzheve të normave të interesit. Dhe krejtësisht në fund paraqitet seksioni i shtatë që paraqet përfundimet dhe rekomandimet e studimit.

1.8. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua për objektivat, qëllimet dhe rëndësinë e këtij punimi. Studimi ka rëndësi të veçantë për shumë arye. Arsyeja kryesore është se përmes këtij punimi po identifikohen përcaktuesit kryesor dhe më me influencë në marzhin neto të norma të interesit, si një ndër problemet kryesore të vendeve në zhvillim, posaçërisht vendeve të Ballkanit. Problemi është se ato janë të larta dhe bankat nuk janë duke ofruar një burim të mirëfillt të financimit, e as duke krijuar një mirëqenie me kosto më të ulët ndaj individëve dhe bizneseve. Në këtë kapitull u diskutua detalisht debati aktual rreth kësaj problematike,

si dhe arsyet se pse ky studim është i rëndësishëm për biznesin, individin dhe ekonominë në përgjithësi. U paraqiten hipotezat bazë dhe pyetjet kërkimore të studimit. Një ndër arsyt kryesore që normat e interesit janë të larta konsiderohet niveli i lartë i mbajtjes së kapitalit më konkretisht hipoteza bazë e këtij studimit. Pastaj madhësia, pronësia e bankës si e ndikojn marzhin neto të interesit. Cilat banka janë të prirura të rrisin marzhet ? Bankat e huaja apo vendore? Bankat e mëdha apo të vogla? Rreziku i likuiditetit, rreziku i kredisë, kreditë joperformuese, shpenzimet operative, konkurrenca, ekonomia A janë faktorë që e ndikojn marzhin neto të interesit? Duke tentuar të ju jap përgjigje këtyre pyetjeve, në këtë kapitull përshkruhet shkurtimisht metodologjia, metodat dhe instrumentet e studimit. Poashtu, shpjegohet shkurtimisht përmbledhja e literaturës kryesore, e cila kryesisht ishte e huaj. Dhe sikurse çdo punim, edhe në këtë pjesë u cekë në disa pika, mundësitë dhe kufizimet e këtij punimi. Kapitulli përfundon duke e shpjeguar ecurinë e punimit nëpër kapituj.

PJESA E PARË

RISHQYRTIMI I LITERATURËS DHE KUADRI TEORIK

KAPITULLI II: DEBATI , TEORITË KRYESORE TË NORMËS SË INTERESIT DHE DALLIMET E TYRE

2.1. Debat i për normat e interesit sot

Normat e interesit vazhdojnë të mbesin pjesë e debatit botëror. Thelbi i debatit karakterizohet nga fokusi në këto tre çështje: norma e interesit si fenomen, norma e interesit si produkt faktorësh (variabël i varur) dhe norma e interesit si instrument politikash (variabël i pavarur). (Fisher, 1907) Që të tre çështjet kanë rëndësi. Çështja e parë, norma e interesit si fenomen ka rëndësi sepse ajo shihet në këndvështrime të ndryshme. Çështja e dytë, norma e interesit si produkt faktorësh (variabël i varur) ka rëndësi pasi që mbi faktorët përcaktues nuk ka konsensus. (Ansgar Belke, 2009) (Rothbard, 2001) dhe se vetë norma e interesit shfaqet në forma të ndryshme, si formë: huaje, kursimesh, bondesh, fitimi dhe autoritet shpallës. Në formë huaje mund të jetë: konsumtatore, korporatës, blerje shtëpie. Në formë kursimesh mund të jetë: meafat dhe pa afat. Në formë bondesh mund të jetë: qeveritare ose korporatave. Në formë fitimi mund të jetë: afat shkurtër ose afat gjatë. Në formë autoritet shpallës mund të jetë nga: qeveria, banka qendrore, kërkesë/oferta e tregut. (Humphrey, 1997) Çështja e tretë, kur norma e interesit shërben si instrument politikash (variabël i pavarur) mund të na jap përgjigje në shumë pyetje, si: A mund të përdoret apo jo norma e interesit si instrument për të mbajtur nën kontrollë fenomene të padëshiruara? Nëse po, në çfarë formash? Në çfarë kushtesh? Rëndësinë e kësaj çështjeje e përbëjnë teoritë kryesore të normave të interesit që do të shtjellohen në vijim.

2.2. Teoritë kryesore të normave të interesit

Teoritë kryesore të normave të interesit janë: Teoria e Shkollës Austriake; Teoria Neoklasike; Teoria e likuiditetit, dhe Teoria e Huasë.

Përfaqësuesit kryesor të teorisë së Shkollës Austriake janë: Eugen Bohm von Baërk (1814-1914) dhe Ludwig von Mises (1881-1973). Kontributi i tyre lidhur me normat e interesit paraqitetet në një numër librash dhe artikujsh. Autori Eugen Bohm von Bawerk, kontributin e tij lidhur me normat e interesit, kryesisht e kishte dhënë në librat: “Historia dhe kritika e teorisë të normave të interesit” në vitin 1884 dhe “Kapitali dhe Interesi” në vitin 1890. Te teoria neoklasike përfaqësues kryesorë ishin: Filozofi britanik Jeremy Bentham (1748-1832), ekonomisti austriak Carl Menger (1840-1921), ekonomisti francez Leon Wlras (1834-1919) dhe Herman Heinrich Gossen (1810-1858). Kontributin kryesor të teorisë së Likuiditetit e kishte dhënë autori i njohur John Maynard Keynes (1883-1946) ndërsa tek Teoria e Huasë, autori Knut Wicksell (1851-1926).

2.3. Dallimet e teorisë kryesore të normës së interesit

Dallimet e teorisë kryesore të normës së interesit mund të grupohen në këto elemente: Esenca e shpjegimit; Fjalët/Konceptet kyçe; Kuptimi dhe definimi i normës së interesit; Supozimet baze; Variablat e pavarur (faktorët influencues të normës së interesit); Marrëdhëniet që trajtojnë & hipotezat që ngrenë; Mekanizmi veprues në themel të procesit & modeli shkak-pasojë që sugjerojnë dhe Zgjidhjet që ofrohen & politikat që sugjerohen të zbatohen.

2.3.1. Esenca e shpjegimit

Norma e interesit sipas kater teorive kryesore shpjegohet:

- *Teoria e Shkolles Austriake* - e shpjegon normen e interesit me ligjin e dobisë marginale të mallrave. (Friedrich von Wieser, 1851–1926), që ka të bëjë me:
 - a) “Kohë-preferencën“, e njerzve për kapital, para, mallra të këmbyera apo të prodhuara (Bawerk, 1890);
 - b) Me praktikat e këmbimit apo zgjedhjes së mallrave (të sotme vs. të ardhme) dhe
 - c) transaksioneve që kryejne (mall, para, hua).
- *Teoria Neo-klasike* - e shpjegon normën e interesit me ligjet e zvogëlimit të dobisë marginale. (Gossen, 1854.) përmes dy ligjeve:
 - Ligji 1:* Rritja e konsumit të një malli gjeneron një dobi pozitive, por kënaqesia e konsumimit shtesë mund të mos jetë edhe aq e madhe sa ajo e gjeneruar nga konsumi i mëparshëm;
 - Ligji 2:* Në një gjendje optimale, raporti i këmbimit të mallrave/çmimeve është i barabartë me raportin e dobisë marginale të mallrave në qarkullim;
- *Teoria e likuiditetit* - e shpjegon normen e interesit me rolin e parasë (kërkesë-oferta). (Keynes, 1973)
- *Teoria e huasë* - e shpjegon normen e interesit me dallimin/devijancat në mes të normës neutrale (e ekonomisë) në krahasim me normën e lirë (e tregjeve). (Knut, 1969) (Keynes J. M., 1973)

2.3.2. Fjalët kyçe

Fjalët kyçe të teorive kryesore të normës së interesit karakterizohen me termat e paraqitur në tabelën nr.3, si ne vijim:

Tabela nr.3. Fjalët kyçe të teorive kryesore të normës së interesit

<u>Teoria e Shkollës Austriake</u> • kohë-preferencë • huamarrje/huadhënie • kursime/investime/konsum	<u>Teoria e Likuiditetit</u> • kërkesë/ofertë për para • raport bonde/para • bonde (kërkesë, çmim, fitim) • frikë kreditimi/risk investimi/besueshmëri • transaksione/kujdes ndaj të ardhmes/qëllime spekulimi • agjente publik (qeveri) dhe private (individë, banka, biznese)
<u>Teoria Neo-Klasike</u> • kursim/investim/konsum • normë fitimi investimi/risk investimi • të ardhura • produktivitet/eficencë kapitali	<u>Teoria e Huasë</u> • normë interesi (natyrale/tregu) • kohë-preferencë (konsum/kursim/investim) • produktivitet/kapital • të ardhura (të sotme, të ardhshme) • popullsi/fuqi puntore • agjente (publike/private)/politika fiskale • huamarrje/huadhënie • risk/kompensim/këmbim/inflacion • strukturë e tregjeve/efiçencë tregu • shpërndarje (risku, likuiditeti, kursimesh)

2.3.3. Kuptimi dhe definimi i normës së interesit

Norma e interesit kuptohet si fenomen, si variabël i varur (produkt influencash) si dhe variabël i pavarur (faktor influencues).

- Sipas, **teorisë së shkollës austriake**, norma e interesit:
 - *Si fenomen*: kuptohet si element i tregut të lirë dhe zhvlerësimit (Mises, 1912), poashtu definohet si zgjedhje racionale e individit apo agjentit.
 - *Si variabël i varur*: shihet e përcaktuar nga kohë – preferenca apo vendim-marrja e njerzve apo agjentëve.
 - *Si variabël i pavarur*: shihet si influencues përmes interes parasë, interes bondesh dhe interes fitim, të cilat influencojn mbi raportet e mallrave të së tashmes në krahasim me mallrat e të së ardhmes si dhe ekuilibrin mbi kursimin apo investimet.
- Sipas, **teorisë neo-klasike**, norma e interesit:
 - *Si fenomen*: kuptohet si element me natyrë ekonomike dhe definohet si zgjedhje racionale e individit apo agjentit.
 - *Si variabël i varur*: shihet e përcaktuar nga kohë – preferenca dhe produktiviteti i kapitalit.
 - *Si variabël i pavarur*: shihet si influencues përmes interes parasë, interes bondesh dhe interes fitim, të cilat influencojn mbi raportet e mallrave të së tashmes në krahasim me mallrat e të së ardhmes si dhe ekuilibrin mbi kursimin apo investimet.

- Sipas, **teorisë së likuiditetit**, norma e interesit:
 - *Si fenomen*: kuptohet si një force me vete, pa lidhje me zhvillimin ekonomik real dhe definohet si element pastërtisht monetare.
 - *Si variabël i varur*: shihet e përcaktuar nga dinamikat e kërkesë-ofertës së parasë dhe likuiditetit.
 - *Si variabël i pavarur*: shihet si influencues përmes dy formave: 1) Normës nominale të interesit që lidhet me bondet qeveritare, indeksin e çmimit të mallërave të konsumit dhe pritshmërinë e agjenteve të tregut për inflacionin. 2) Normës reale të interesit që lidhet me letrat me vlerë, indeksin e çmimit mallërave dhe pritshmërinë e agjentëve të tregut për inflacionin. Poashtu, norma e interesit si variabël i pavarur influencon mbi investimet, prodhimin dhe punësimin.
- Sipas, **teorisë së huasë**, norma e interesit:
 - *Si fenomen*: kuptohet si një fenomen real (Bomfin, 2001) (Woodford, 2000) (Nelson, 2003) (Woodford, Interest and prices. , 2003), si dhe definohet si praktika huamarrjeje.
 - *Si variabël i varur*: shihet e përcaktuar nga kërkesë/oferta e parasë, dinamikat e huamarrjes/huadhënies dhe dinamikat e normës natyrale/normës së tregut. Norma natyrale e interesit përfaqëson normën e ekonomisë në ekuilibër ku rendimenti aktual është brenda potencialit kurse çmimi i parasë mbetet i pandryshueshëm. Kurse norma reale e tregut

përfaqëson normën e tregut të huave e cila përcaktohet nga kërkesë-oferta e parasë.
(Wicksell K. , 1969)

- *Si variabël i pavarur*: shihet si influencues përmes tre formave: 1) devijantë e lartë, kur norma e interesit të tregut është mbi vlerën natyrale; 2) neutrale, kur norma e interesit është baraz me vlerën natyrale, dhe 3) devijantë e ulët, kur norma e intreresit të tregut është nën vlerën natyrale. Si variabël i pavarur influencon mbi rendimentin/prodhimin e ekonomisë, punësimin, çmimin e mallërave dhe rritjen ekonomike me inflacion të ulët.
(Sack B. E., 2004) (Wicksell, 1898,1965)

2.3.4. Supozimet nistore

Supozimet nistore apo të vërtetat që pranohen si të tilla te teoria e shkollës austriake janë pesë, te teoria neoklasike janë gjashtë, te teoria e likuiditetit janë tetë dhe te teoria e huasë janë nëntë.

- ***Teoria e shkollës Austriake*** – ngrihet mbi këto pesë supozime nistore:
 - 1) *Format e Kohë – Preferencës*, ka të bëjë me individët që kanë kohë preferencë të ndryshme, e ato mund të jenë: kur disa kanë nivel të lartë të kohë preferencës kurse disa kanë nivel të ulët të kohë preferencës.
 - 2) *Tiparet e Kohë – Preferencës së Lartë*, ka të bëjë me individët me nivel të lartë kohë – preference të cilët karakterizohen nga: të menduarit/preferencën e tashme, prirja të konsumojnë në të tashmen, tendenca për të kursyer më pak, gatishmëria për huamarrje.

- 3) *Tiparet e Kohë – Preferencës së Ulët*, ka të bëjë me individët me nivel të ulët kohë – preference të cilët karakterizohen nga: të menduarit/preferencën për të ardhmen, prirja për të preferuar konsumin në të ardhmen, tendenca për të kursyer shumë, gatishmëria për të dhënë hua
 - 4) *Huadhënia dhe Huamarrja*, ndodh për dy arsye:
 - a) Sepse ekonomia popullohet nga dy grupe individësh: ata me nivel ulët kohë-preference dhe durimi dhe ata me nivel të lartë kohë-preference dhe padurimi.
 - b) Sepse individët me kohë preference të ulët i japin hua atyre me kohë preference të lartë.
 - 5) *Ekulibri i normës së interesit* (Rothbard, 2001) ,përcaktohet nga kohë – preferenca e individëve në shoqëri dhe jo nga ndonjë faktor tjetër dhe reflekton përpjekjet maksimalizuese si të huadhënësve, ashtu edhe të huamarrësve.
- **Teoria Neo – Klasike**, ngrihet mbi këto gjashtë supozime nistore:
 - 1) *Norma e Interesit*, e cila pasqyron raportin mes kursimit/konsumit (investimet) dhe e cila është e barabarte me produktin marginal të punës në një treg optimal.
 - 2) *Dobia Margjinale*, e cila reflekton qëndrimin ndaj riskut, ku dihet se fitimi pa risk gjithmonë preferohet më shumë se fitimi që bart risk;
 - 3) *Investimi*, i cili reflekton raportin lëndë fillestare/produkt përfundimtar që karakterizon procesin e prodhimit, i cili financohet vetëm përmes borxhit dhe i cili është i barabartë me produktin “investim real” shumëzuar me “çmimin“
 - 4) *Kursimet*, niveli i kursimit reflekton preferencën e njerzve për konsum më shumë në të tanishmen sesa në të ardhmen.

- 5) *Konsumi*, përcaktohet nga shkalla e të ardhurave që do të thotë se njerzit konsumojnë mallra të së ardhmes vetëm nëse mendojnë që të ardhurat do të rriten;
 - 6) *Të Ardhurat*, përfaqesojnë pagën reale që do të thotë se në një treg optimal të ardhurat (paga reale) janë të barabartë me produktin marginal të punës;
- ***Teoria e Likuiditetit*** - ngrihet mbi këto tetë supozime nistore:
 - 1) *Bonde dhe Paratë* – asetet gjenden në dy forma kryesore para dhe bonde. Vlera e bondeve që ofrohen është e njëjtë me vlerën e parasë në qarkullim: Bondet shkëmbehen me para dhe paratë shkëmbehen me bonde.
 - 2) *Preferencat e Agjentëve* - agjentët e tregut e mbajnë pasurinë e tyre ose në para, ose në bonde por jo njëkohësisht edhe në para, edhe në bonde. Preferojnë bonde kur norma e interesit është e lartë (meqë kosto e mbajtjes së parasë në dorë është e lartë. Ndërsa preferojnë paranë në dorë kur norma e interesit është e ulët (meqë kosto e mbajtjes së parasë në dorë është e ulët);
 - 3) *Kërkesen për Para* – e cila buron nga tre arsye: nevoja për transaksione (reflekton nga të ardhurat), nevoja për kujdes (reflekton të ardhurat), nevoja për spekulim (reflekton normën e interesit).
 - 4) *Marrëdhëniet Huadhënës-Huamarrës* - janë marrëdhënie besueshmërie: kur besimi i investuesit ndaj huamarrësit për menaxhimin e kredisë është i lartë, frika për rrezikun e investimit është e vogël, ndërsa kur besimi i investuesit ndaj huamarrësit për menaxhimin e kredisë është i ulët, frika për rrezikun e investimit është e lartë;

- 5) *Çmimin e Bondeve* - çmimi i bondeve ndryshon dhe reflekton influencat e një numri faktorësh, si: rrezikut të inflacionit, roli negativ i inflacionit mbi bondet, kërkesa e investitorëve për kompensim, qëndrimi anti – risk i investitorëve. (Sack, 2002)
 - 6) *Çmimin e Parasë (Likuiditetit)* - çmimi i likuiditetit ndryshon dhe reflekton influencat e një numri faktorësh, si: lidhjes normë interesi - bonde të indeksuara, vlera më të ulët e bondeve të indeksuara ndaj bondeve nominale, përdorimi i bondeve të indeksuara si një formë likuiditeti;
 - 7) *Bondet qeveritare dhe Bondet e korporatave* - marrëdhënia bonde qeveritare - bonde korporatash është marrëdhënie varësie. Bondet e korporatave ndjek normën e fitimit të bondeve qeveritare. Varësia është e fortë veçanërisht kur frika e investitorëve/tregjeve është në rritje. (Dupont, 1999)
 - 8) *Friken, Riskun, dhe Kompensimin* - niveli i frikës, çmimit të riskut, dhe çmimit të kompensimit është i lartë kur: risku i investimit është i lartë, perceptimi i riskut është i lartë dhe pasiguria e investimit është e lartë. Kur frika, risku, kompensimi është i lartë, investitorët marrin qëndrim anti-risk dhe preferojnë investim në bonde qeveritare jo në bonde korporatash.
- **Teoria e huasë**, ngrihet mbi këto nëntë supozime nistore:
 - 1) *Normen Natyrore të Interesit & Normen e Interesit të Tregjeve* - norma natyrore e interesit reflekton kohë-preferencën e njerzve ndërsa norma e interesit e tregjeve reflekton dinamikën e huadhënies/huamarrjes. (Cuaresman, 2003)
 - 1) *Raporti Normë Natyrore – Normë Tregu* - marrëdhënia normë natyrore-normë tregut shfaqet në tre lloj raportesh; (Laubach, 2001)

- norma natyrore dhe norma e tregjeve jane të njëjta, të barabarta kur: tregu është në ekuilibër, niveli i parasë nuk ndryshon, huadhënia është në formen e mallrave kapitale;
 - raporti devijant normë e tregut është më e lartë se norma natyrore kur: bankat rrisin stokun e parasë, rrisin depozitat disponibël, rrisin huadhënien, niveli i kursimeve nuk ndryshon, investimet rritet, rendimenti rritet;
 - raporti devijant norma e tregut është më e ulët se norma natyrore: kur bankat ulin stokun e parasë, ulin depozitat disponibël , ulin huamarrjen, niveli i kursimeve nuk ndryshon, investimet ulen, rendimenti ulet. (Laubach T. W., 2003)
- 2) *Ekuilibrin Monetar* - ekuilibri monetar rivendoset kur norma e interesit konvergon me normen natyrore, dmth: kursimet barazohen me investimet, kërkesa ekseseive zhduket, rritja e depozitave ndalet, çmimet stabilizohen në një nivel të ri më të lartë. (Friedman, 1994)
 - 3) *Eksesivitetin e Kërkeses* - e cila përfaqëson dominimin e kërkesës aktuale mbi rendimentin potencial. Krijohet nga dy elemente: krijimi prej bankave të depozitave të reja për t'i dhënë hua jo-bankave dhe përdorimi i depozitave të reja për plotësimin e kërkesave për mallra dhe shërbime.
 - 4) *Eksesivitetin e Investimit* - përfaqëson dominimin e investimeve mbi kursimet, reflekton financimin e investimeve përmes huave dhe shfaqet kur norma natyrore dhe norma e tregjeve janë të ndryshme.
 - 5) *Agjentët Privatë, Bankat, Depozitat Bankare, Huadhënien nga Bankat* - bankat rrisin huadhënien për të mbrojtur depozitate të tyre nga kërkesat për para në dorë

që gjeneron inflacioni. Poashtu, bankat rrisin normën e fitimit në kundërpërgjigje të ndryshimeve në nivelin e çmimeve. Ndryshimet në ofertën e depozitave bankare shoqërohen me dy ndryshime: në nivelin e çmimeve (çmimet rriten) dhe në normën e interesit (rritet hendeku normë natyrale/normë e tregjeve). Oferta për hua e bankave është e njëjte me nivelin e kurimeve të depozituara plus depozitat e reja të krijuara.

- 6) *Agjentet Publike dhe Politikat Fiskale* - qeveritë janë huamarrës kronikë dhe të mëdhenj dhe ushtrojnë influencë të rëndësishme mbi normën reale të interesit; Huamarrja e sektorit publik rrit nevojën për nivele më të larta kursimi të njerzve.
- 7) *Produktivitetin, Popullsinë, Kërkesë për Investime, Tregjet Financiare* - rritja e produktivitetit rrit dy elemente që kanë të bëjnë me investimin: normën e fitimit të investimit dhe kërkesën për investime. Kurse rritja e popullsisë shoqërohet me tre dinamika: rritja e fuqisë puntore, nevojën për kapital, rritje të investimeve. Rritja e kërkesës për investime kërkon nivel më të lartë kursimesh dhe normë më të lartë interesi (që njerzit të joshen të depozitojnë paratë e tyre). Eficenca e tregjeve financiare kontribuon në një shpërndarjeje optimale të kursimeve nga dy anë. E ato janë: koha dhe investimet;
- 8) *Normën e Këmbimit* - norma e këmbimit është e lartë në vendet që karakterizohen nga nivele të larta dhe luhatje inflacioni dhe kur kanë kredibilitet të ulët të politikave monetare.

2.3.5. Variablat e pavarur

Secila teori ka theksuar variablat e veta të pavaruara. Në tabelën nr.4, paraqiten në mënyrë të përmbledhur të gjitha variablat e theksuara në kuadër të teorive ndërsa më poshtë shpjegohet influenca dhe ndërlidhjet e tyre.

Tabela nr.4. Variablat e pavarur të teorive kryesore të normës së interesit

<u>Teoria e Shkolles Austriake</u> • Kohë-preferencën (VP1); • Sasinë e mallrave që ofrohen/këmbehen (VP2).	<u>Teoria e Likuiditetit</u> • Kërkesë/oferta për para (VP1-VP2-VP3); • Qëndrimi/frika e agjentit (VP4-VP5-VP6); • Kujdesi/vëmendja e agjentit (VP7-VP8 –VP9).
<u>Teoria Neo-Klasike</u> • Kohë-preferencën (VP1); • Produktiviteti/efiçienca e kapitalit (VP2).	<u>Teoria e Huasë</u> • Kohë-preferencën (VP1); • Produktiviteti (VP2); • Popullësia (VP3); • Politika fiskale (VP4); • Çmim risku (VP5); • Struktura institucionale e tregjeve financiare (VP6).

Teoria e Shkollës Austriake – thekson dy variabla të pavarur. Ato janë: kohë-preferenca dhe sasia e mallërave që ofrohen/këmbehen. Kohë-preferenca përfaqëson vlerën që një individ iu jep mallrave të tashmes apo të ardhmes. Ky variabël ushtron influence në format kohë preference e lartë apo e ulët dhe ka lidhje me kohën, objektivin dhe këmbimin e mallrave apo shërbimeve me vlerë më të madhe apo me vlerë të vogël. Sasia e mallërave që

ofrohen apo këmbehen përfaqëson raportin e mallërave të tanishme me mallra të ardhshme. (Ludwig von Mises, 1881-1973) Ky variabël ushtron influencën e format e mallrave të tanishme apo të së ardhmes dhe ka lidhje me dy elemente: kursimet si mall i së tashmes dhe investimet (mall i së tashmes dhe investimet si mall i së ardhmes. (Mises L. , 1996)

Teoria Neo-Klasike – poashtu thekson dy variabla të pavarur. Ato janë: kohë-preferenca dhe produktiviteti/efiçienca e kapitalit. Kohë preferenca përfaqëson vlerën që një individ iu jep mallrave të tashmes apo të ardhmes. Ky variabël ushtron influence në format kohë preference e lartë apo e ulët dhe ka lidhje me kohën, objektivin dhe këmbimin e mallrave apo shërbimeve me vlerë më të madhe apo me vlerë të vogël. Produktiviteti apo efiçienca e kapitalit përfaqëson dobinë marginale që një investues i atashon një malli (Neumann, 1944) nga pikëpamja e vlerës së pritshme dhe renditjes së portofoleve të investimeve që i ofrohen sipas dobisë: individi i zgjedh portofolet me synim maksimizimin e fitimit. Ky variabël ushtron influence në formën e efiçienes së lartë apo e ulët dhe ka lidhje me tre elemente: Investimet, kursimet dhe riskun. Investimet ndërlidhen me ndryshimin e stok kapitalit nga fillimi e deri në fund të periudhës së investimit. Kursimet kanë të bëjnë me sasinë e parave të painvestuara. Ndërsa risku ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së fitimit.

Teoria e likuiditetit - thekson tre grupe variablash të pavarur. Ato janë: kërkesë/oferta për para, qëndrimi/frika e agjentit dhe kujdesi/vëmendja e agjentit. Kërkesë/oferta për para është grupi i parë i variablave, i cili përfaqëson një ekuilibër monetar dhe ushtron influencë në tre forma. Forma e parë ka të bëjë kur kërkesa me ofertën janë të barabarta. Forma e dytë ka të bëjë kur kërkesa është më e madhe se oferta dhe paraqitet dukuria e ashtuquajtur inflacion. Dhe forma e tretë e grup variablit të parë ka të bëjë kur kërkesa është më e vogël

se oferta dhe paraqitet dukuria tjetër e ashtuquajtur deflacion. Ky grup variablash ka lidhje me bondet (kerkesë, çmim, normë fitimi), me friken e agjentëve, me riskun e investimit, me besueshmërinë e kredimarrësit, transaksionet, qëndrimin e kujdesshëm dhe spekulimet për fitim. Qëndrimi/frika e agjentit, paraqesin grupin e dytë të variablash që përfaqësojnë friken e agjentit ndaj inflacionit, kredibilitetit të huamarrësitë, dhe riskut të investimit/bondeve. Ky grup variablash ushtron influencë në dy forma: nivel i lartë dhe i ulët. Ka lidhje me situatën kur kërkesa për para është më e madhe se oferta për para; kur ka marrëdhënie bonde qeveritare-bonde korporata dhe ka lidhje me nivelet e taksimit. Grupi i tretë i variablash të pavarur përfshin kujdesin/vëmendjen e agjentit, i cili përfaqëson qëndrimin e agjentit ndaj transaksioneve që reflektojnë të ardhurat; ndaj të ardhmes që ka të bëjë me të ardhurat dhe ndaj spekulimit për fitim që reflekton diferencën në normat e fitimit. Ky variabël ushtron influencë njëjtë sikurse shumica e variablash të tjerë, në dy formate: nivel i lartë dhe nivel i ulët. Ka lidhje me situatën kur kërkesa për para është më e vogël se oferta për para.

Teoria e huasë - thekson gjashtë variabla të pavarur. Ato janë: kohë-preferenca, produktiviteti, popullësia, politikat fiskale, çmimi i riskut, struktura institucionale e tregjeve financiare. Kohë-preferenca, si variabël e parë e kësaj teorie përfaqëson veprimin/arsyetimin racional. Ushtron influencë në format të ulët apo të lartë dhe ka lidhje me raportin e mallrave të së tashmes me mallra të së ardhmes; Me kursimet dhe investimet. Produktiviteti, si variabël e dytë e pavarur, përfaqëson dobinë marginale të investimit dhe ushtron influencë në format dobi/produktiviteti i lartë apo i ulët. Kryesisht ka lidhje me: Investimet të cilat ndërlidhen me ndryshimin e stokut kapitalit nga fillimi e deri në fund të

periudhës së investimit; Kursimet që kanë të bëjnë me sasinë e parave të painvestuara; Riskun që ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së fitimit; Perceptimin/pritshmërinë e njerzve mbi raportin e të ardhurave aktuale/të ardhshme; Dhe nivelet e huamarrjes apo huadhënies.

Variabli i tretë i teorisë së huasë është popullësia që përfaqëson një fenomen real. Ky variabël ushtron influencë përmes formave rritje e lartë apo rritje e ulët dhe ka lidhje me kapitalin, kursimet dhe investimet. Variabli i katërt i pavarur i teorisë së huasë është politika fiskale, që përfaqëson fenomen real dhe ushtron influencë përmes formave stimuluese apo jo stimuluese. Ky variabël tregon lidhje me praktikën dhe politikën huamarrëse të qeverisë, raportin kërkesë-ofertë të kursimeve dhe normën reale të interesit.

Çmim-risku, si variabël i pestë i pavarur, poashtu përfaqëson fenomen real dhe ushtron influencë përmes formave çmim risku i lartë apo i ulët. Ky variabël ka lidhje me normën e këmbimit, normën e inflacionit dhe normën natyrale të interesit real. (Giammarioli, 2003)

Variabli i gjashtë dhe i fundit i kësaj teorie është struktura institucionale e tregjeve financiare, që përfaqëson fenomen real dhe ushtron influencë përmes formave eficiente apo jo eficiente. Ky variabël tregon lidhje me rolin e tregjeve në shpërndarjen e kursimeve, raportin kursime-investime-kohë, dhe normën natyrale të interesit.

2.3.6. Marrëdhëniet dhe hipotezat

Secila teori artikulon marrëdhëniet dhe bën hipotezat e veta. Dallimet, krahasimet dhe analiza e tyre paraqitet sipas teorisë me rradhë.

- **Teoria e shkollës austriake artikulon dhe bën këto:**

- **Marrëdhënie:**

Të zhdrejta: ka të bëjë me variablat kohë-preference & kursime, dhe kohë - preference & investime, ku vlera e variablave shkon në kah të kundërt me njëra tjetrën.

Të drejta: ka të bëjë me variablat kohë-preferencë & raport mallrash, dhe kohë-preferencë & konsum, ku vlera e variablave shkon në kah të njëjtë, pozitiv, ose negativ me njëra tjetrën.

- **Hipoteza:**

1) *Për marrëdhënien kohë-preferencë & raport mallrash:*

- Sa më e lartë të jetë sasia e mallrave të ofruara tani në raport me ato të ofruara në të ardhmen, aq më e lartë do të jetë edhe niveli i kohë-preferencës ; dhe
- Sa më e vogël të jetë sasia e mallrave të ofruara tani në raport me ato të ofruara në të ardhmen aq më e ulët do të jetë edhe niveli i kohë-preferencës;

2) *Për marrëdhënien Kohë-Preferencë & Konsum:*

- Sa më e ulët/lartë është kohë-preferenca e njerzve aq më i ulët/lartë është niveli i konsumit;

3) *Për marrëdhënien Kohë-Preferencë & Kursime:*

- Sa më e ulët/lartë është kohë-preferenca e njerzve aq më i lartë/ulët është niveli i kursimeve;

4) *Për marrëdhënien Kohë-Preference & Investime:*

- 5) Sa më e ulët/lartë është kohë-preferenca e njerzve aq më i lartë/ulët është niveli i investimeve

6) *Për marrëdhënien Mallra & Kohë-Preference & Kursim & Investim & Konsum & Normë:*

- Kur kohë-preferenca kundrejt mallrave pëson ulje, atëhere konsumi bie, kursimet rriten, investime rriten, norma e interesit ulët;
- Kur kohë-preferenca kundrejt mallrave pëson rritje, atëhere konsumi rritet, kursimet pakësohen, investimet pakësohen, norma e interesit rritet.

• **Teoria neoklasike artikulon dhe bën këto:**

- **Marrëdhënie:**

Të zhdrejta: ka të bëjë me variablat normë interesi & kërkesë për investim, niveli i investimit & norma e fitimit të investimit, normë e fitimit të investimit & rendimentit të investimit, kërkesë investimit & risk investimit & përceptim i riskut, ku vlera e variablave shkon në kah të kundërt me njëra tjetrën.

Të drejta: ka të bëjë me variablat normë interesi dhe kursim, kursim dhe raport konsum i tashëm apo i ardhshëm, ku vlera e variablave shkon në kah të njëjtë, pozitiv, ose negativ me njëra tjetrën.

- **Hipoteza:**

1) *Për marrëdhënien normë interesi & kursim:*

- Sa më i lartë/i ulët është niveli i kursimeve aq më i lartë/më i ulët është norma e interesit

2) *Për marrëdhënien normë interesi & kërkesë për investime:*

- Sa më e ulët/lartë është kërkesa për investime aq më i lartë/ulët është norma e interesit;

3) *Për marrëdhënien niveli i investimit & normë e fitimit të investimit:*

- Sa më i lartë/i ulët është niveli i investimit, aq më e ulët/i lartë është norma e fitimit nga investimit;

4) *Për marrëdhënien normë fitimit të investimit & rendimenti i investimit:*

- Sa më e ulët/lartë është rendimenti aq më i lartë/i ulët është norma e fitimit të kthyer të investimit

5) *Për marrëdhënien kursim & raporti konsum i tashëm/i ardhshëm:*

- Sa më i lartë/i ulët është niveli i kursimit nga të ardhurat, aq më i lartë/i e ulët është edhe norma e zëvendësimit të konsumit aktual me konsumin e ardhshëm;

6) *Për marrëdhënien kërkesë për investim kapitali & risk i investimit & perceptim i riskut*

- Sa i lartë/ulët është risku i investimit dhe perceptimi i riskut, aq më i ulët/lartë është kërkesa për investim nga investuesit;

• **Teoria e likuiditetit artikulon dhe bën këto:**

- **Marrëdhënie:**

Të zhdrejta: ka të bëjë me variablat normë interesi & besueshmëri & frikë kreditimi & bonde (kërkesë, çmim), dhe normë interesi & para & bonde & agjente, ku vlera e variablave shkon në kah të kundërt me njëra tjetrën.

Të drejta: ka të bëjë me variablat normë interesi & frikë inflacioni & risk investimi & kompensim risku, ku vlera e variablave shkon në kah të njëjtë, pozitiv, ose negativ me njëra tjetrën.

- **Hipoteza:**

1) *Për marrëdhënien normë interesi & frikë inflacioni & risk investimi & kompensim rsku*

- Sa më e madhe/e vogël është frika ndaj inflacionit (kërkesa për para është më e madhe se oferta për para), aq më i madh/vogël është risku i investimit, aq më shumë rritet/ulet çmimi i kompensimit që kërkojnë investuesit, aq më e lartë/ulët bëhet norma e interesit;

2) *Për marrëdhënien normë interesi & besueshmëri & frikë kreditimi & bonde (kërkesë, çmim):*

- Sa më i lartë është besueshmëria e huamarrësit, aq më e vogël është frika e huadhënësit ndaj rrezikut, aq më e lartë është kërkesa/çmimi për bondet e huamarrësit, aq më e ulët është norma e interesit;
- Sa më i lartë të jetë mosbesimi ndaj huamarrësit, aq më e lartë është frika e kreditimit, aq më e ulët është kërkesa për bondet e tij, aq më i lartë është shitja e bondeve, aq më shumë ulet çmimi i tyre, aq më shumë rritet norma e interesit, aq më shumë investuesit lëvizin investimet e tyre drejt bondeve me më pak risk ose me risk të ulët;

3) *Për marrëdhënien normë interesi & para & bonde & agjente:*

- Sa më e lartë është kosto e mbajtjes së parasë në dorë, aq më e lartë është kërkesa/çmimi i bondeve, aq më shumë rritet fitimi i bondit interesit, aq më shumë ulet norma e interesit;
- Sa më e ulët është kostoja e mbajtjes së parasë kesh në dorë, aq më shumë njerzit priren të kërkojnë dhe mbajnë në dorë para kesh, aq më shumë ulet kërkesa, çmimi, dhe fitimi i bondeve, aq më shumë rritet norma e interesit;

- **Teoria e huasë artikulon dhe bën këto:**

- **Marrëdhënie:**

Të zhdrejta: ka të bëjë me variablat normë interesi & konsum & investime; normë interesi & rendiment i ekonomisë & çmime; normë interesi & kohë-preferencë & konsum; normë interesi & politikat fiskale të qeverisë & agjentët privat; normë interesi & struktura institucionale e tregjeve financiare, ku vlera e variablave shkon në kah të kundërt me njëra tjetrën.

Të drejta: ka të bëjë me variablat normë interesi & deviacion normë & investime (fitim, kërkesë); normë interesi & deviacion normë & sjellje agjentit; normë interesi & popullësi & fuqi punëtore & deviacion norme & investim; normë natyrale & investim & kursim; normë interesi & produktivitet & konsum; normë interesi & çmim risku, ku vlera e variablave shkon në kah të njëjtë, pozitiv, ose negativ me njëra tjetrën.

- **Hipoteza:**

1) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Deviacion Norme & Investime (fitim, kërkesë):*

- Kur norma natyrore është më e lartë/më e ulët se norma e tregjeve, norma e fitimit në investime rritet/ulet; nëse niveli i kursimeve mbahet i pandryshueshëm, atëherë rritja/ulja e kërkesës për investime shkakton gjithashtu edhe rritjen/uljen së normës së interesit;

2) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Deviacion Norme & Sjellje Agjentit:*

- Kur frika e agjentit ndaj riskut rritet/ulet, kursimi rritet/ulet; nëse raporti me investimet nuk ndryshon, atëhere norma e interesit real në ekuilibër shkon drejt uljes/rritjes;

3) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Konsum & Investime:*

- Kur njerëzit konsumojnë me shumë nga të ardhurat e tyre aktuale, nëse kërkesa për investime nuk ndryshon, atëhere kursimet ulen, norma e interesit rritet;

4) *Për marrëdhënien Normë & Popullësi & Fuqi Punëtore & Deviacion Norme & Investim:*

- Kur popullësia rritet, fuqia punëtore rritet, rritja ekonomike është më e lartë; nëse niveli i kursimeve nuk ndryshon, kërkesa për investime rritet, norma e tregjeve është mbi vlerën normale;
- Sa më shumë të rritet nevoja për investime, sa më të ulta kursimet, aq më shumë rritet norma natyrale, aq më shpejt balancohet raporti investim-kursim;

5) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Rendiment i Ekonomisë & Çmime:*

- Nëse norma e tregut është më e vogël/më e madhe se norma natyrale, atëhere rendimenti i ekonomisë rritet/zbret, çmimet rriten/zbresin;

7) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Kohë-Preference & Konsum:*

- Kur kohë-preferenca rritet/bie dhe gjithçka tjetër mbahet nënkontroll, atëherë rritet/ulet konsumi, bien/rriten kursimet, rritet/ulet norma e interesit;

8) *Për marrëdhënien Normë Natyrale & Investim & Kursim:*

- Nëse niveli i investimeve nuk ndryshon, rënie/rritja e kursimeve shpie në rritjen/rënien e normës natyrale të interesit;

9) *Për marrëdhënien Normë Interesi & Produktivitet & Konsum:*

- Sa më shumë që konsumatori të parashikon se të ardhurat e tij në të ardhmen do të jenë më të mëdha se në të tashmen, atëherë rritet konsumi, rritet norma natyrale reale;

10) Për marrëdhënien Normë Interesi & Politikat Fiskale & Agjentë Privat:

- Kur huamarrja qeverisë rritet, sektori privat nuk rrit kursimet, atëherë norma natyrale e interesit real rritet për të ekuilibruar kërkesë-ofertën e kursimeve;
- Kur qeveria krijon deficit, agjentët privat të tregut rrisin kursimet, pakësojnë konsumin, norma reale e interesit mbetet e pandikuar;

11) Për Marrëdhënien Normë Interesi & Çmim Risku;

- Sa më i pasigurtë/i paparashikueshëm është norma e këmbimit/inflacionit, atëherë më i lartë është çmimi i kompensimit, atëherë rritet norma natyrale e interesit real;

12) Për Marrëdhënien Normë Interesi & Struktura Institutionale e Tregjeve Financiare:

- Sa më eficient është tregu financiar (konkurrues) atëherë më i madh është spektri i zgjedhjeve që iu ofrohen kursimtarëve nga pikëpamja e normës së fitimit, riskut, dhe likuiditetit, atëherë rritet motivimi për të kursyer, atëherë me poshtë nivelin “në ekuilibër” e shpie normën reale të interesit;


Më poshtë paraqitet mekanizmi veprues dhe modeli shkaku pasojë për katër teoritë kryesore të normave të interesit.

2.3.7. Mekanizmi veprues dhe modeli shkak-pasojë

Mekanizmat veprues dhe modelet shkak-pasojë që ofrojnë paraqiten në vijim sipas teorive:


- Te **teoria e shkollës austriake**, mekanizmi i ekuilibrit të normës së interesit ngrihet mbi dy elemente: në kohë preferencën e individëve dhe marrdhënien e ulët/lartë në mes të individëve me kohë preferencën. Ekuilibri i normës së interesit arrihet përmes procesit kur njerzit me kohë-preferencë të ulët (huadhënësit) do japin hua deri në momentin kur nuk gjeneron fitim dhe deri kur dhënia e huasë ka më pak vlerë/dobi sesa të mbajturit e parasë në dorë.

Grafiku nr.4. Modeli shkak pasojë që e ofron teoria austriake



Te **teoria neoklasike** mekanizmi i ekuilibrit të normës së interesit ngrihet mbi dy elemente: në dobinë marginale të njerzve, në këmbimin mallra të tashmes & mallra të ardhmes; dhe norma marginale e fitimit që ekonomia gjeneron mbi kapitalin. Ekuilibri i normës së interesit arrihet përmes procesit kur në si situatë sigurie njerzit vendosin për dobinë marginale të mallrave dhe kapitaleve dhe ndërmarrin veprimet përkatëse në bazë të vlerësimit nga tre pikëpamje: kuadri zhvlerësues, kuadri shumë-periudhësh, kuadri i përkohshëm. Ndërsa në situatë pasigurie vendim-marrja e njerzve udhëhiqet nga tre qëndrime: risk-refuzues, risk-neutral, risk-marrës. Modeli shkak pasojë që e ofron teoria neoklasike është paraqitur në vijim.


Grafiku nr.5. Modeli shkak pasojë që e ofron teoria neoklasike



-Te **teoria e likuiditetit** mekanizmi i ekuilibrit të normës së interesit përcaktohet mbi tre tip të raportit kërkesë-ofertë: kërkesë/ofertës së barabartë; kërkesa për para është më e vogël se oferta për para; kërkesa për para është më e madhe se oferta për para; Ekuilibri i normës së interesit arrihet përmes procesit që kombinon këto tre momente:

- Momenti A: kërkesa për para dhe oferta për para janë të njëjta! Në këtë moment, raporti bonde/para është në ekuilibër.
 - Momenti B: kërkesa për para është më e ulët se oferta për para! Në këtë moment, kërkesa për bonde është e lartë, niveli i blerjes së bondeve rritet, çmimi i bondeve rritet për shkak të prirjes për të blerë bonde, norma e fitimit të bondeve shkon drejt uljes për shkak të rritjes së nivelit të blerjes së bondeve;
 - Momenti C: kërkesa për para është më e lartë se oferta për para! Në këtë moment, kërkesa për bonde është e ulët, niveli i shitjes së bondeve rritet, çmimi i bondeve bie për shkak të tendencës për të shitur bonde, norma e interesit të bondeve shkon drejt rritjes për shkak të rritjes së nivelit të shitjes së bondeve;
- Modeli shkak pasojë që e ofron teoria e likuiditetit paraqitet në grafikun me nr. 6.

Grafiku nr.6. Modeli shkak pasojë që e ofron teoria e likuiditetit



VP-Grupi 2

VP-Grupi 3


-Te **teoria e huasë** mekanizmi i ekuilibrit të normës së interesit përcaktohet nga dy tipe normash: normë natyrale e interesit dhe norma e interesit të tregjeve. Ekuilibri i normës së interesit arrihet përmes procesit që kombinon këto dy momente:

- Momenti A: Ndodh kur norma natyrale/norma e tregjeve janë të njëjta! Në këtë moment: oferta e parasë është e njëjtë me kërkesën për investime, stoku i parasë rritet përmes huadhënies së bankave, rritja e huadhënies ul normën e interesit të tregjeve; (M'esonnier, 2004)

Momenti B: Nodh kur norma natyrale shfaq dy ekuilibre: ekuilibër të përkohshëm dhe afatgjatë. Ekuilibri i përkohshëm ndodh kur raporti kursime/investime është më i lartë se kohë-preferenca e njerzve, njerzit reduktojnë kursim-investimet, konsumi rritet dhe ekonomia shkon në ekuilibër; Ndërsa ekuilibri afatgjatë ndodh kur kërkesa për mallra të së tashmes rritet, oferta e mallrave të tashmes zvogëlohet në raport me mallrat e së ardhmës, dhe norma reale dhe norma e tregjeve rriten paralelisht me rritjen e kursimeve dhe investimeve; (Manrique, 2004)

Modeli shkak pasojë që e ofron kjo teori paraqitet në grafik nr. 7.

Grafiku nr.7. Modeli shkak-pasojë që e ofron teoria e huasë



2.3.8. Zgjidhjet dhe politikat

Secila teori ka ofruar zgjidhje dhe sugjeruar politikat e veta.

- Teoria e shkollës Austriake ofron si zgjidhje fleksibilitetin përsa i takon ofertës së mallrave tashme me të tashme dhe mallrave të tashme me të ardhshme. Ndërsa sygjeron politika të jetë transaparetene transakcionet (mall, para, kredi).
- Teoria Neoklasike ofron si zgjidhje optimizim të dobisë së mallrave dhe produktivitetit të kapitalit dhe sugjeron që politika të jetë në raport këmbim mallra/çmim, mallra të mbahet në masë të njëjtë me raportin e dobisë së mallrave në qarkullim; rritje të rendimentit të investimit.
- Teoria e likuiditetit thotë se zgjidhja qëndron duke e mbajtur normën e interesit në nivele optimale dhe sugjeron se politika duhet të ketë rol më aktiv të qeverisë në mbajtjen nën kontroll të një niveli optimal të normës së interesit (Garrison, 2002) dhe se qeveria mund të ndërhyjë në përcaktimin e nivelit të normës së interesit dhe mund të menaxhojë faktorët që influencojnë stabilitetin makro-ekonomik të sistemit.

Teoria e huasë ofron zgjidhje duke thënë se norma e interesit duhet të shmangë deviacionet ekstreme dhe sugjeron këto politika: politika fiskale që stimulojnë stabilitet; efikasitet të tregjeve financiare përmes konkurrencës dhe transparencës; harmonizim të marrëdhënieve mes rritjes së popullsisë dhe raportit kapital/investime; menaxhim të risqeve; Normat e interesit janë ndër variablat më të vezhguar në ekonomi. (Gerdesmeier, 2003) (Reifschneider, 2000) Luhatja e tyre ndikon mbi kreditimin, investimin, prodhimin,

punësimin, konsumin dhe kursimin, duke e ndikuar në këtë mënyrë drejtëpërsëdrejti në ekonominë reale. (Leskaj, 2011)

Ka mënyra të ndryshme të llogaritjes së normës së interesit, kjo në varësi të qëllimit të investorëve. Pjesa më e madhe e investorëve janë të interesuar të dinë normën e interesit të tregut për një aktiv financiar. Përfitimin e vërtetë që e ofron një aktiv financiar më së miri e tregon norma efektive e interesit e cila e barazon vlerën aktuale të pagesave me vlerën aktuale të të ardhurave që pritet të gjenerojë një aktiv financiar. Aktivët mund të jenë instrumente financiare, kontrata të huasë. Për çdo rast, qoftë aktive afatshkurtër apo afatgjatë, nevojitet llogaritja e normës efektive të interesit bazuar në të dhënat e tregut. Metodatat bazë për llogaritjen e normës së interesit janë: interpolimi dhe ekstrapolimi. Interpolimi është llogaritje e një norme mesatare të ponderuar interesi bazuar në vërtetimet e normës së interesit ndërsa ekstrapolimi është gati i ngjajshëm me interpolimin por dallimi qëndron atëherë kur të dhënat e tregut nuk na krijojnë mundësinë që të kemi gjithmonë një normë për instrumentet me afat më të gjatë dhe një normë për instrumentet me afat më të shkurtër. Sipas autoreve Lesja dhe Kotorri, modelet që shpjegojnë faktorët që përcaktojnë normat e interesit janë kategorizuar në dy teori: Teoria e preferencës për likuiditete dhe Teoria e fondeve të luhajtshme. (Leskaj, 2011)

- a) Teoria e preferencës për likuiditete fokusohet në ofertën dhe kërkesën për aktive likuide veçanërisht para. Modeli i shpjegon lëvizjet e një norme të vetme interesi si mesatare të normave të interesit për instrumente afatshkurtër të cilët mund të konsiderohen para.

b) Teoria e fondeve të luhajtshme fokusohet në ofertën dhe kërkesën për fonde hua në ekonomi. Si i tillë ky model analizon faktorët të cilët ndikojnë vendimet e huamarrësve dhe huadhënësve në tregjet financiare. Ajo ka lidhje me fluksin e fondeve ndërmjet institucioneve dhe tregjeve dhe shpjegon lëvizjet e tregjeve të parasë dhe të kapitalit.

Rritja e marrëdhënieve ekonomike midis vendeve të ndryshme ka ulur ndikimin që ka mbi normat e interesit institucioni qendror bankar i vendit. Janë pikërisht lëvizjet në tregjet ndërkombëtare ato të cilat drejtojnë lëvizjen e normave të interesit në vend. Rritja apo ulja e normës së interesit shpesh mund të vërehet edhe nga vendimet e qeverive me ndikim në ekonominë botërore (SHBA, BE, Japoni, Kina), por teoria e fondeve të luhajtshme shpjegon edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në lëvizjet e normave të interesit, kryesisht nëpërmjet ballafaqimit të kërkesave të huamarrësve dhe ofertës së huadhënësve. Një faktorë tjetër që e ndikon normën e interesit që është shprehur në Efektin Fisher është inflacioni, i cili thotë se me rritjen e normës së inflacionit rritet në masë të njëjtë norma e interesit të tregut në mënyrë që investitorët të mund të ruajnë të njëjtin kthim të kërkuar. Pastaj kritikët Robert Mundell dhe James Tobin sjellin argumente se ndryshimet e inflacionit të pritur ndikojnë në ndryshimin e normës së kërkuar të interesit në një drejtim të kundërt. Pra, nëse inflacioni i pritur rritet atëherë norma e interesit në treg rritet në një masë më të vogël. Shkaku është se me rritjen e inflacionit të pritur bie norma e kërkuar e interesit dhe anasjelltas. Argumenti që mbështet këtë lidhje ka të bëjë me rangimin që sjellin pritjet për inflacion. Michael Darby dhe Martin Feldstein vazhduan debatin duke përmirësuar ekuacionin e Fisherit nëpërmjet përfshirjes të efektit të tatimit. Të dy autorët japin argumente se investitorët

janë të interesuar për kthimin neto pasi është zbritur tatimi dhe jo thjeshtë për normën e kërkuar të interesit. Pra, norma e interesit në treg është më e madhe se sa shumica e normës së kërkuar dhe inflacionit të pritur. Gjithashtu ajo tregon se me rritjen e inflacionit të pritur norma e interesit në treg rritet me një masë më të madhe. Shumica e ekonomistëve argumentojnë se niveli i normave të interesit dhe rritja ekonomike ndryshojnë në të njëjtën mënyrë përgjatë kohës. Normat e interesit rriten kur rriten shpenzimet totale dhe anasjelltas. Prioriteti i aktivitetit ekonomik vlerësohet bazuar në përqindjen e ndryshimit real të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). PBB-ja rritet kur konsumatorët rrisin shpenzimet (C), bizneset rrisin inventarët dhe shpenzimet kapitale (I), rriten shpenzimet publike (G), dhe eksporti neto (X-M). Pra, me rritjen e kërkesës për hua rriten shpenzimet dhe me rritjen e shpenzimeve (PBB) rriten normat e interesit dhe anasjelltas. Kur ekonomia është në rritje, individët dhe bizneset rrisin shpenzimet, kjo rritje e shpenzimeve bën që të rriten çmimet, rritja e çmimeve apo inflacioni rrit normën e interesit në treg. Vlen të theksohet se normat e interesit nuk mund të rriten pafundësisht sepse edhe rritja e tyre e ka një nivel maksimal pas të cilit normat mund të bien. Niveli i tyre varet nga niveli i zhvillimit të vendit. Zakonisht normat e interesit janë më të ulëta në vendet e zhvilluara dhe më të larta në vendet në zhvillim. Gjithsesi në një ekonomi që nuk është në krizë norma e interesit nuk është më e lartë se 20%. (Leskaj, 2011). Nuk do të thotë se kjo është normë standarde sepse varësisht prej nivelit të zhvillimit mund të ndryshojë edhe norma. Në momentin kur ekonomia ndodhet në pikën më të lartë, kemi rritje të normës së interesit dhe për qëllim të uljes së inflacionit, faktorë që ndikon në uljen e tyre përmes Bankës Qendrore është rezerva e detyrueshme, që paraqet një pjesë të depozitave të cilën bankat duhet të mbajnë si rezervë likuiditeti.

Në fazën e rënies ekonomike bien shpenzimet e individëve dhe bineseve duke sjellë rënien e kërkesës për hua. Kjo ndikon në rënien e normave të interesit dhe stabilizimit të inflacionit. E kundërta ndodh kur ekonomia ndodhet në pikën më të ulët, Banka Qendore nxit rritjen e rezervave me qëllim për të stimuluar shpenzimet dhe për të reduktuar papunësinë dhe rënien e normave të interesit. Kjo bën që normat e interesit së bashku me shpenzimet të fillojnë rriten duke përsëritur kështu ciklin. Përveç që norma e interesit e ndikon kërkesën dhe oferten në tregun e huasë ajo ka ndikim të madh edhe në tregun financiar. Në treg instrumentet financiare shiten duke reklamuar normat emërore të interesit e cila është përqindja shtesë e parave që premtun një instrument financiar. Ndërsa norma e interesit të lirë nga risku tregon rritjen reale të pasurisë së huadhënësit duke marrë në konsideratë inflacionin dhe riskun që ai ka marrë përsipër. Nëse në ekonomi nuk do të kishte inflacion dhe risk atëherë norma nominale e interesit do të ishte e barabartë me normën e lirë nga risku. Por në ekonominë reale inflacioni dhe risku janë elementë shoqërues të kontratave të huasë, prandaj thuhet se sa më i lartë inflacioni aq më i lartë niveli i riskut dhe aq më e lartë do të jetë norma e interesit të një instrumenti financiar. Në momentin kur një investitor apo huadhënës nuk është i aftë t'i përmbush obligimet apo ekziston mundësia e mos shlyerjes me korrektësi duke shkaktuar humbje të mundshme për investitorin apo bankën atëherë lind risku nga moskthimi dhe niveli i primit ndryshon varësisht nga niveli i riskut që mbart një investim i caktuar. Sa më i madh të jete probabiliteti i mospagesës (risku) aq më i lartë do të jetë norma e interesit. Faktorë tjetër që e ndikon normën e interesit është afati i maturimit i cili sa më i gjatë që është aq më shumë e ndikon riskun e likuiditetit, riskun e mospagesës dhe elemente të tjerë risku duke ndikuar në këtë mënyrë në çmimin e

aktivit financiar. Lidhur me afatet e ndryshme dhe normat e interesit të aktiveve e jap edhe teoria e pritjeve ku sipas saj investitorët janë indiferent lidhur me afatin e maturimit dhe krahasojnë investimet bazuar vetëm në normën e interesit që presin prej tyre. Në këtë mënyrë përfitimi (interesi) i marrë nga investimi afatgjatë synon të barazojë përfitimin (interesat) e marrë nga investimet afatshkurtëra që ndodhin përgjatë kohëzgjatjes së investimit afatgjatë. Teoria e pritjeve ka arritur në përfundim se aktivet financiare me afate të ndryshme janë zëvendësues të plotë të njëri tjetrit. Investitorët gjatë përzgjedhjes së aktiveve financiare krahasojnë fitimet e investimeve afatshkurtra me investimet afatgjata, duke zgjedhur atë alternativë që ofron interesin më të lartë. Nëse investimi afatgjatë ka një përfitim më të madh se sa investimet afatshkurtra atëherë kërkesa e rritur për këtë lloj investimi do të çojë në rënien e përfitimeve prej tij, gjë që afon fitimet e investimeve afatshkurtra me investimet afatgjata. Norma afatgjatë e interesit shërben si një sinjal i ecurisë së ardhme të normave afatshkurtra të interesit. Nëse norma afatgjatë ka diferencë të lartë me normën afatshkurtë të interesit atëherë pritet që normat afatshkurtë e interesit të rriten në të ardhmen. Në të kundërtën nëse ndodh që norma afatgjatë të jetë më e vogël se sa norma afatshkurtë e interesit atëherë mund të pritet një rënie e madhe e normave afatshkurtra të interesit në të ardhmen. (Leskaj, 2011) Kurse sipas teorisë së preferencës për likuiditete norma afatgjatë nuk është e barabartë me mesataren e normave afatshkurtra të interesit, kjo teori e tejkalon teorinë e pritjeve duke përfshirë edhe primin për riskun e çmimit. Sa më i gjatë afati i maturimit aq më shumë luhetet çmimi i investimit dhe aq më i lartë është primi i riskut të çmimit. Kjo nënkupton se normat afatgjate janë gjithmon më të larta se normat afatshkurtra të interesit. Teoria e tregjeve të segmentuara mbështet supozimin se

investitorët nuk i konsiderojnë aktivet financiare me afate të ndryshme si zëvendësues të plotë të njëri tjetrit. Sipas kësaj teorie investorët dhe huamarrësitë përqendrohen nga ekuilibrat në dy tregje të ndara. Në momentin e parë norma e interesit që përcaktohet në tregun e aktiveve afatshkurtra është më e ulët se sa norma e interesit që përcaktohet nga kërkesa dhe oferta e aktiveve afatgjata. Në këtë mënyrë kurba e normave të interesit ka prirje pozitive që nënkupton se me rritjen e afatit rritet edhe norma e interesit. Kurse në momentin e dytë ndodh e kundërta. Për shkak të rritjes së kërkesës më shumë se sa oferta mund të ndodh që të rritet norma e interesit për aktivet afatshkurtra deri në atë masë sa e tejkalon normën e interesit për aktive afatgjata. Për këtë arsye norma e interesit që e cakton tregu i aktiveve afatshkurtra është më e lartë se sa norma e interesit që e cakton tregu për aktivet afatgjata. Kjo bën që kurba e normave të interesit të ketë prirje negative.

2.4. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull, shqyrtohet kuadri teorik mbi debatin, teorinë, shkollat e normave të interesit. Në mënyrë të detajuar përshkruhen katër teoritë kryesore të normës së interesit, të cilat janë: Teoria e Shkollës Austriake; Teoria Neoklasike; Teoria e likuiditetit dhe Teoria e Huasë. Këto teori përveç që dallojnë nga koha kur janë formuluar, nga autorët dhe studiuesitë e ndryshëm që i artikulojnë, ato kanë edhe shumë dallime brenda vetës. Në këtë kapitull, u shpjeguan hap pas hapi të gjitha dallimet kryesore të këtyre teorive, duke i grupuar në këto elemente, si: Esenca e shpjegimit; Fjalët/Konceptet kyçe; Kuptimi dhe definimi i normës së interesit; Supozimet nistore; Variablat e pavarur (faktorët influencues të normës së interesit); Marrëdhëniet që trajtojnë & hipotezat që ngrenë; Mekanizmi

veprues në themel të procesit & modeli shkak-pasojë që sugjerojnë dhe Zgjidhjet që ofrohen & politikat që sugjerohen të zbatohen. Çdo teori ka karakteristikat e veta, të cilat kanë dhënë diçka veç e veç në kohën e tyre. Vetëm duke i analizuar dhe krahasuar teoritë, shkollat e debatet në këtë mënyrë mund të fillojmë studimit. Prandaj mund të themi se teoria e huasë është teoria më e përmbledhshme, e cila përmban në vete gati të gjitha supozimet dhe variablat që i kanë edhe teoritë tjera. Por norma e interesit akoma mbetet debat global, sepse shihet në mënyra të ndryshme, ekonomi të ndryshme. Globalizimi është një ndër faktorër që ka bërë që norma e interesit të bëhet çështje me interes për hulumtim, për arsye se sa më të globalizuara tregjet aq më rrezik përhapja e krizës në të gjitha vendet. Analizimi i këtij kapitulli më hapi më shumë rrugë drejt hulumtimit. Përmes këtij kapitulli u njoha më afër normës së interesit si fenomen. Prandaj, mund të themi se ky kapitull është një pikënisje e shumë problemeve që do të shqyrtohen në vazhdim, sidomos përpunimit dhe analizimit të përcaktuesëve të normave të interesit dhe kredisë, identifikimin e problemeve të normave të larta të interesit për kreditë në vendet në tranzicion, zhvillimin e politikave të bankës qendrore, etj. Ky kapitull mund të shërbërbejë edhe si pikënisje e shumë studimeve të tjera të cilat ndërlidhen me normën e interesit. Duke u thelluar më shumë në studim në kapitullin e dytë do të paraqitet kuadri teorik mbi marzhin neto të normave të interesit si variabël i varur i këtij studimi.

Do të përshkruhen analizat sipas rezultateve kontabël, teorik dhe empirik. Do të citohen shumë autorë të cilat i hedhën dritë kësaj çështjeje. Megjithatë, hapja e tregut global, përparimet e shumëta në teknologji, bëjnë që normat e interesit si pjesë e pandashme e bankave të jenë përherë çështje me interes për hulumtim.

KAPITULLI III: PËRCAKTUESITË E MARZHIT NETO TË NORMAVE TË INTERESAVE SIPAS REZULTATEVE KONTABËL, TEORIKE DHE EMPIRIKE

Mënyra e zhvillimit të ekonomisë së tregut, sidomos në 50 vitet e fundit, ka rritur rolin qendror të sistemit bankar në sistemin financiar të një vendi dhe në krejt sistemin ekonomik. Bankat tregtare me një gamën gjithnjë e më të gjerë të produkteve që ofrojnë, kanë forcuar lidhjet me sektorët e tjerë të ekonomisë. Krizat e fundit kanë treguar që ndikimi i tyre është i konsiderueshëm jo vetëm në suksesin e ekonomisë por dhe në dështimin e saj. Një sistem bankar i mirëorganizuar dhe i shëndetshëm përbën një infrastrukturë të mirë për një sistem ekonomik të zhvilluar.

Gjatë vitit 2007-2009 një pjesë e bankave më të mëdha në SHBA dhe Evropë deklaruan falimentimin e tyre për shkak të humbjeve të mëdha në kreditë, sidomos në kreditë hipotekare apo kreditë për shtëpi. Një pjesë tjetër e bankave kanë pësuar humbje por kanë shpëtuar nga falimentimi në sajë të ndihmës shtetërore apo edhe duke u përpjekur vetë për të evituar falimentimin. Zakonisht bankat përdorin kapitalin aksionar për të mbuluar humbjet. Nëse humbjet shoqërohen me mungesë likuiditeti atëhere bankat shesin një pjesë të aktiveve të tyre për të siguruar likuiditete. Shumë banka kohë pas kohe kanë kaluar në situata të ngjajshme të vështira që vijnë kryesisht nga humbjet e huave. Rënia e të ardhurave i ka gjetur në befasi aksionarët (pronarët) e bankës të cilat mund të mos e kenë vënë re rritjen e volumit të kredive me risk të lartë. Rritja e kompleksitetit të veprimtarisë bankare e ka bërë gjithnjë e më të vështirë vlerësimin e performancës bankare, të ardhurat neto të bankës mund të manipulohen lehtë nga ana e drejtuesëve për të fshehur problemet

kryesore të bankës. Banka është një biznes që tregon paranë. Nga njëra ana siguron paranë me një normë interesi të caktuar dhe nga ana tjetër e jep huan me një normë interesi më të lartë. Diferenca ndërmjet këtyre dy normave të interesit përbën marzhin e bankës që vjen nga ndërmjetësimi. Marzhi i ndërmjetësimit përbën të ardhurat bazë të veprimtarisë bankare dhe është diferencë ndërmjet normës mesatare të ponderuar të interesit të aktivitetit me normën mesatare të ponderuar të interesit të pasivit. (Leskaj, 2011) Përveç këtyre bankat kanë edhe të ardhura dhe shpenzime që nuk vijnë nga interesat por nga shërbime të ndryshme. (Luboteni, 2006) Nga pikëpamja kontabile fitimi i bankës përfshin shumë elemente. Ashtu si në çdo biznes tjetër fillimisht llogaritet diferenca në mes të ardhurave nga aktiviteti bazë dhe kostove që shkakton aktiviteti bazë. Aktiviteti bankar është huaja dhe të ardhurat dhe kostot e huasë të shprehura në interesa. Në këtë mënyrë llogaritet marzhi i veprimtarisë bankare që është diferenca në mes të ardhurave nga interesi me shpenzimet për interesa. Më tej mbledhen dhe zbriten të ardhurat dhe shpenzimet tjera për të dalë tek fitimi neto. Kështu zbriten rezervat për humbje nga kreditë (Provizionimi i kredive) e cila përfaqëson parashikimet e drejtuesëve të bankës për humbjet e mundshme që mund të vijnë nga kreditë e këqija. Hapi i fundit për llogaritjen e fitimit neto të bankës është marrja parasysh e të ardhurave jointeresprurëse dhe shpenzimeve jointerespaguese, pra që nuk vijnë nga interesat por nga drejtime të tjera të tilla si komisione të ndryshme shërbimi, pagesa për administrimin e sistemeve dhe administratës, etj. Edhe pse bankat përpiqen në mënyrë të vazhdueshme të rrisin të ardhurat jointeresprurëse dhe të pakësojnë shpenzimet jointerespaguese, zakonisht diferenca në mes tyre është negative dhe kjo diferencë pasqyrohet si barrë administrative. Nëse do të shënonim me:

AI – Të ardhurat nga interesi; SHI- Shpenzimet per interesa; ANI – Të ardhurat neto nga interesat; AJI – Të ardhurat jointeresprurese; SHJI – Shpenzimet jointerespaguese; BA – Barra administrative; RHK – Rezerva për humbje nga kreditë; T – tatimi mbi fitimin e biznesit dhe AN – të ardhurat neto. Atëherë do të kishim (Leskaj, 2011):

$$ANI = AI - SHI$$

$$BA = AJI - SHJI$$

$$AN = ANI - BA - RHK - T$$

Të ardhurat nga interesat është shuma e interesave të marra nga të gjitha aktivet e bankës. Huatë e formave të ndryshme, instrumentet financiare dhe depozitat në bankat e tjera. Përveç tyre banka përfiton të ardhura edhe nga kontratat e lizingut të cilat nuk janë të ardhura nga interesi por janë të ardhura të ngjajshme me interesat për shkak se në thelb në të dyja rastet banka financon klientët e saj.

Shpenzimet për interesat përbëhen nga interesat që banka u paguan depozituesve, blerësve të certifikatave të depozitës dhe huadhënësve të tjerë bankare ose jobankare. Për nga vetë volumi pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve vjen nga depozitat e formave të ndryshme. Siç edhe e thamë më lartë diferenca mes të ardhurave nga interesat dhe shpenzimeve për interesat përbën të ardhuren neto nga interesi (ANI). E cila paraqet pjesën kryesore të fitimit të bankës dhe varet shumë nga mënyra se si banka e menaxhon riskun e normave të interesit.

Të ardhurat jo interesprurëse (AJI), përveç të ardhurave nga interesat banka mund të sigurojë të ardhura nga komisionet për shërbimet gjithnjë në rritje që ato ofrojnë. Bankat

ofrojnë një sërë shërbimesh nëpërmjet llogarive rrjedhëse për të cilat merr komisione si nga klienti ashtu edhe nga tregtari. Kështu nëse një klient kryen një pagesë nëpërmjet një çeku në një pikë shitjeje banka i mban një komision tregtarit. Rritja nga dita në ditë e këtyre formave të pagesës, sidomos formave elektronike ka sjelle rritjen e të ardhurave që banka siguron nga komisionet. Përveç komisioneve mbi pagesat banka siguron të ardhura dhe nga shërbimi i kasave të sigurisë si dhe nga komisionet për administrimin e portofolit të investitorit. Në raste të veçanta banka mund të sigurojë të ardhura dhe rivlerësim të aktiveve ose nga shitja e tyre.

Shpenzimet jo interespaguese – përveç interesave dhe komisioneve banka paguan shpenzime për personelin që përbëhet nga pagat, honoraret pagesat ndaj sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve tjera që lidhen me personelin. Gjithashtu banka kryen shpenzime publicitare për të krijuar një imazh sa më të besueshëm në treg. Meqenëse biznesi bankar mbështetet në rradhë të parë në marrëdhënie besimi me klientët dhe për shkak se shumë shpesh mund të gjenden në vështirësi për shkak të mungesës së besimit nga ana e publikut, sidomos depozituesve, atëherë banka kryen shpenzime të konsiderueshme për krijimin dhe ruajtjen e një imazhi të mirë në treg. Shpenzimet të tjera janë të natyrës administrative ku futen shpenzimet për krijimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës, sistemeve, procedurave, etj.

Rezerva për humbjet nga kreditë është një shpenzim që ka si qëllim pakësimin e fitimit të çdo periudhe. Qëllimi është që banka të amortizojë humbjen e mundshme nga kreditë e këqija. Në thelb kjo është ruajtja e një pjese të fitimit në mënyrë që të përdoret për të mbuluar humbjet nga kreditë kur këto të ndodhin. Pra ky është një shpenzim që nuk

shoqërohet me dalje parash. Niveli i tij jep informacion për opinionin që ka drejtimi i bankës lidhur me cilësinë e kredive të dhëna.

Tatimi mbi fitimin, ashtu si të gjithë bizneset e tjera fitimi i bankës tatohet. Diferenca që mbetet pas tatimit (e ardhura neto) një pjesë mund të mbahet si fitim i pashpërndarë dhe një pjesë mund të shpërndahet në formën e dividendit. Kur ndodh diçka e tillë pronarët e bankës paguajnë dhe një tatim tjetër i cili është tatimi mbi të ardhurat personale.

Analizat tjera që ndihmojnë në performancën e bankës dhe që bazohen në raporte bazë janë: ROE dhe ROA. ROE përfaqëson fitimin (kthimin) në aksion ndërsa ROA përfaqëson fitimin (kthimin) mbi pasurinë e bankës. Përdorimi i tyre ka për qëllim karahasimin e dy bankave të ndryshme apo edhe të njëjta përgjatë një periudhe kohore. (Luboteni, “Bankat dhe afarizmi bankar”, 2008)

Përkufizimi që mbizotëron më së shumti në literaturën empirike lidhur me marzhin neto të interesave është raporti i të ardhurave neto nga interesat me aktivet që sjellin të ardhura, ku shpesh herë ky emërues llogaritet si aktivet totale pa ndryshim në të ardhura. Bernanke (1983) e ka përcaktuar koston e ndërmjetësimit si diferencë midis kostove bruto të paguara nga huamarrësit dhe kthimeve neto të marra nga kursimtarët. (Bernanke, 1983)

Ekzistojnë dy mënyra të matjes së marzhit neto të interesave: ex-ante dhe ex-post. Sipas mënyres ex-ante, marzhi neto i interesave llogaritet si diferencë e normave të interesit të kredive dhe depozitave që bankat specifikojnë në kontratë që në fillim. Ndërsa, sipas mënyres ex-post, marzhi neto i interesave llogaritet si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit që banka ka realizuar gjatë periudhës përkatëse. Diferenca midis

dy marzheve lidhet me nivelin e kredive me probleme. (Kalluci, 2010) NIM sipas mënyres ex-ante, duke qenë si mates i efijences te përfitimit dhe ndërmjetësimit, tregon aftësinë e menaxhmentit për të gjetur burimet më të lira të fondeve, menaxhimin optimal të portofolit, etj. Diferencat e normave të interesit mund të jenë tepër të larta, por shkalla në të cilën sektori bankar merr përsipër rrezikun, (KJP), etj. mund të ndikojnë në efikasitetin e ndërmjetësimit ex-post. (Toçi, 2005)

Mënyra më e përdorur është ex-post, për arsye se të dhënat mirren të sakëta ndërsa të mënyra ex-ante, të dhënat mund të jenë jokonsistente për arsye se mirren nga disa burime. Por edhe mënyra ex-post ka mangësitë e veta, pasi të ardhurat nga interesat dhe rezervat e krijuara për një kredi me problemeve materializohen në momente të ndryshme kohore. (Demirgüç-Kunt, 1998) Për identifikimin dhe analizën e faktorëve që përcaktojnë marzhin neto të interesave në sistemin bankar, përdoren dy metoda. E para, është metoda e zbërthimit kontabël të marzhit neto të interesave dhe e dyta, ka të bëjë me një trajtim teorik të faktorëve ndikues që më pas aplikohen edhe në praktikë nëpërmjet analizave ekonometrike.

3.1. Analiza kontabël e marzhit neto të normave të interesave

Një nga format për analizimin e marzhit neto të interesave është dhe forma kontabël e realizuar për herë të parë nga Hansen & Rocha. (Hanson, 1986) Duke u nisur nga pasqyrat financiare të bankave rezulton ky ekuacion:

$$NI = NII - (OE - NNII - NEI) - LLP - T$$

Ku, NI përfaqëson rezultatin neto të bankave, NII - rezultatin neto nga interesi, OE – shpenzimet e veprimtarisë, NNII – rezultatin neto nga veprimtaritë tjera, NEI – rezultati neto i jashtëzakonshëm, LLP – shpenzimet për provigjone dhe T – taksat dhe tatimet.

Nëse ekuacionin e përpjestojmë me totalin e aktiveve (TA), atëherë mund të vërehen zërat që ndikojnë në përcaktimin e marzhit neto të interesave (NIM), i cili llogaritet me këtë ekuacion:

$$NIM = \frac{(OE - NNII - NEI)}{TA} + \frac{LLP}{TA} + \frac{T}{TA} + \frac{NI}{TA}$$

Pra, nga ky ekuacioni sipas analizës kontabël vërehet se marzhi neto i interesave ndikohet nga masa e shpenzimeve të veprimtarisë që nuk mbulohet nga të ardhurat tjera, niveli i shpenzimeve për provigjone që bankat parashikojnë për portfolin e kredive, dhe nga shuma e taksave e tatimeve që paguajnë organeve tatimore dhe niveli i fitimit që ato sigurojnë nga operimi në treg.

3.2. Analiza teorike e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të normave të interesave

Trajtimi i parë teorik lidhur me marzhin neto të normave të interesave është aplikuar në modelin e ndërmjetësimit nga Ho & Saunders (1981). Sipas këtij studimi thuhet që rritjet apo shtesat që bankat i caktojnë mbi normat e interesit të depozitave apo kredive varen nga këta faktore: 1) qëndrimi i bankave ndaj rrezikut; 2) struktura e tregut të bankave; 3) madhësia mesatare e transaksioneve që bankat realizojnë dhe 4) luhatshmëria e normave të interesit. (Kalluci, 2010) Sipas këtyre autoreve, në rastet kur bankat veprojnë në një treg me konkurrencë të lartë, prap marzhet e normave të interesit vazhdojnë të jenë pozitive. Kjo do

të thotë që marzhet e normës së interesit nuk do të zhduken, pasi që pasiguria i shoqëron gjithmonë transaksionet e kryera. Ky lloj marzhi i shkaktuar nga pasiguria, quhet marzh “i pastër”, i cili sipas modelit të ndërmjetësimit zbatohet në dy faza. Faza e parë, përcakton madhësinë e këtij marzhi përmes paraqitjes së efektit të variablave shpjegues që nuk janë shprehur në mënyrë eksplicite në modelin teorik dhe faza e dytë, analizon marrdhënien në mes të marzhit “të pastër” dhe variablave të paraqitura në modelin teorik.

Çmimet e kredive dhe depozitave (P_L dhe P_D) vendosen nga banka ndërsa sasia e tyre përcaktohet në mënyrë ekzogjene. Modeli Ho & Saunders e përshkruan këtë sipas ekuacionit:

$$P_L = p - b \text{ dhe } P_D = p + a,$$

ku p – është opiniononi i bankës për çmimin e vërtetë të kredisë apo depozitës, ndërsa parametrat a dhe b janë marzhe sigurie për shpejtësinë e shërbimit. (Ho, 1981) Meqënëse P_L dhe P_D janë çmime, ato lidhen në mënyrë të zhdrejtë me normat e interesit të kredive dhe depozitave. Kështu, ndryshe mund të thuhet se $r_D = r - a$ dhe $r_L = r + b$ ku r_D dhe r_L - janë normat e interesit të depozitave dhe kredive që banka cakton, ndërsa r - është norma e interesit në tregun e parasë. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se marzhi i interesave (s) llogaritet:

$$s = r_L - r_D = a + b$$

Sipas Ho dhe Saunders (1981), pas një sërë transformimesh të këtij ekuacioni bazë, rezulton se

$$s = r_L - r_D = \alpha/\beta + \frac{1}{2} * R \sigma^2 Q$$

ku, tregon *spread*-in neutral të rrezikut ose vetë dhe shprehin përkatësisht ndërprerjen me boshtin vertikal dhe pjerrësinë e funksionit simetrik të mbërritjes së depozitave dhe kredive. Si rrjedhojë, ky raport mat në njëfarë mënyre shkallën e fuqisë monopolistike.

Pjesa tjetër e formulës përfshin elemente të një primi rreziku. R qëndron për koeficientin e sjelljes ndaj rrezikut, O^2 për variancën e luhatjes së normave të interesit dhe Q për madhësinë e transaksioneve të kryera.

3.3. Analiza empirike rreth përcaktuesve të marzhit neto të normave të interesave

Deri me tani, janë realizuar mjaft punime empirike rreth faktorëve që e përcaktojnë marzhin neto të normave të interesave, si për grup vendesh, si për ekonomi të veçanta, si për banka individuale ashtu edhe për të dhëna në nivel sistemi. Modeli i ndërmjetësimit i përdorur në këtë punim, është model dy fazësh, fillimisht është përdorur nga Ho & Saunders (1981), pastaj nga Saunders & Schumacher (2000). Avantazh i këtij modeli është përcaktimi i marzhit të “paster”. (Schumacher, 2000) I njëjti model por në një fazë të vetme është aplikuar nga McShane dhe Sharpe, Angbazo. (McShane, 1985) (Angbazo, 1997), ku në shpjegimin e marzhit neto të interesit kanë përfshirë variablat e modelit teorik dhe variabla shtesë ose papërsosmëritë që pasqyrojnë aspekte të tjera dhe që nuk përfshihen në modelimin e marzhit të pastër. Sipas Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999) në studimin e tyre kanë analizuar një grup prej 80 vendesh dhe kanë parë se marzhi neto i interesave rezulton më i lartë për vendet në tranzicion sesa për ato të industrializuara. (Demirgüç-Kunt, 1999) Gjithashtu, është dalë në konkluzionin se bankat e huaja kanë prirjen që të caktojnë marzhe më të larta interesi në vendet në zhvillim sesa në vendet e zhvilluara (Claessens. Stijn, 1997, 2001) Arsyeja e kësaj sjelljeje mund të lidhet me faktin se bankat e huaja kanë avantazhe teknologjike krahasuar me bankat vendase (në vendet në zhvillim), por nga ana tjetër zotërojnë disavantazhin e mungesës së informacionit të plotë për tregun

vendas. Për më tepër, këto banka mund të jenë edhe subjekt i pagesës së taksave apo edhe i provigjoneve në nivele më të ulëta.

Faktorët që e ndikojnë marzhin neto të interesave sipas disa studimeve dhe rezultateve empirike janë:

Niveli i kapitalizimit - (Demirgüç-Kunt, 1998), (Schumacher, 2000), (Afanasieff, 2002), (Liebeg, 2006) kanë gjetur lidhje pozitive midis marzhit neto të interesave dhe kapitalizimit të bankave. Brock dhe Franken (2002) kanë gjetur lidhje negative midis këtyre dy treguesve, duke dhënë si shpjegim se bankat e mirëkapitalizuara janë më konservatore në drejtim të dhënies së kredive (duke rezultuar në marzhe më të ulëta) pasi kapitali aksioner është më i rrezikuar. (Brock, 2002) Ndërsa bankat më pak të kapitalizuara janë më të nxitura për të marrë më shumë rrezik (duke rezultuar në marzhe më të larta) për të siguruar më shumë fitime.

Shpenzimet operative – Në studimin e tyre, Ho dhe Saunders nuk kanë përfshirë kostot operative si një nga faktorët përcaktues të marzhit të interesave. Lerner (1981) e ka kritikuar këtë fakt, duke argumentuar se bankat kanë edhe shpenzime të tjera operative gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si ndërmjetës financiarë. (E.M., 1981) Për këtë arsye, Maudos dhe Fernández de Guevara (2004) e kanë përfshirë në modelin e tyre të përmirësuar, këtë faktor përcaktues. Kuptohet që sa më të larta të jenë kostot operative, aq më të larta do të jenë edhe marzhet që bankat caktojnë për të mbuluar këto kosto. (Liebeg dhe Schwaiger 2006), (E strada, 2006), (Naceur, 2003), (Affanasief et al. 2002), (Maudos dhe Fernández de Guevara 2004) kanë gjetur lidhje pozitive midis marzhit të interesave dhe shpenzimeve operative. Koeficienti përpara këtij variabli tregon se ç'pjesë e kostove operative të bankës kalon te depozituesit dhe huamarrësit (në terma të normave më të ulëta

të interesit për depozitat dhe/ose normave më të larta për kreditë). Edhe në mungesë të fuqisë në treg dhe të çdo lloj rreziku, bankat caktojnë marzhe pozitive për të mbuluar pikërisht kostot e veprimtarisë.

Madhësia e bankave – (Naceur, 2003), shprehet se bankat e mëdha priren të ulin marzhet si rezultat i ekonomive të shkallës. Pjesa e tregut të depozitave apo kredive – ku studime të ndryshme kanë marrë rezultate të ndryshme. Nëse lidhja rezulton pozitive, do të thotë se një bankë që ka një pjesë të lartë të tregut të depozitave, ka më shumë fuqi dhe si e tillë ajo mund të vendosë marzhe më të larta. Një shenjë negative e koeficientit tregon për eficiencë në përdorimin e ekonomive të shkallës, duke transferuar disa nga përfitimet të klientët, në formën e marzheve më të ulëta.

Rreziku i kredisë – kreditë me probleme janë një matës i rrezikut të kredisë. Në këtë mënyrë, sa më i lartë niveli i tyre, aq më i lartë rreziku i kredisë e rrjedhimisht më i lartë do të jetë edhe marzhi i interesave pasi banka kërkon të mbulojë humbjet nga këto lloj kredish duke i kaluar kostot shtesë të klientët, nëpërmjet normave më të larta të interesit për kreditë ose më të ulëta për depozitat, apo një kombinim të të dyjave. Maudos dhe Fernández de Guevara (2004), Brock dhe Franken (2002) e Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1998) kanë gjetur një lidhje pozitive të marzhit të interesave me rrezikun e kredisë.

Nga studime të realizuara për disa vende të Amerikës Latine ka rezultuar një lidhje negative midis dy variablave (Brock P. a., 2000) Kjo mund të shpjegohet me rënien e normës së interesit për kreditë ose me rritjen e normës së interesit të depozitave. Rënia e normës së interesit të kredive mund të ndiqet nga bankat që, pavarësisht nivelit të lartë të kredive me probleme, rrezikojnë të ulin të ardhurat duke synuar rritjen e pjesës së tregut. Nga ana tjetër, në studimet e bëra për vendet e Amerikës Latine shprehet se norma e

interesit të depozitave rritet si kundërpërgjigje ndaj rritjes së normes së kredive me probleme, në nivel sistemi. Këto rezultate mund të kenë dy shpjegime: së pari, rritja e nivelit të kredive me problem mund të rrezikojë mundësitë e qeverisë për të ofruar garanci te depozituesit, çka do të shoqërohet me reagimin e bankave për të rritur normat e interesit të depozitave që t'i bëjnë më tërheqëse. Së dyti, për sistemet bankare jo të konsoliduara, bankat e kapitalizuara në mënyrë të pamjaftueshme, do të gjejnë një mënyrë për rritur burimet e financimit nëpërmjet rritjes së normave të depozitave. Në nivel bankash individuale, efekti i rritjes së normave të interesit si kundërpërgjigje ndaj rritjes së kredive me probleme, nuk do të jetë aq i madh sa në nivel sistemi, pasi depozituesit shqetësohen më tepër për sigurimin e depozitave sesa për problemet e një banke të veçantë. Nëse sistemi i sigurimit të depozitave funksionon si duhet, bankat ndeshen me një ofertë elastike të depozitave, kështu që mjafton një rritje e vogël e normës së interesit për të siguruar fonde për mbulimin e humbjeve nga kreditë.

Të ardhurat jo nga interesat – zakonisht kanë një ndikim negativ mbi marzhin e interesave. Bankat janë të gatshme të ulin marzhet e tyre nëse do të sigurojnë një rritje kompensuese në të ardhurat nga komisionet dhe jo nga interesat. Megjithatë, në literaturë paraqiten dy lloj lidhjesh midis këtyre faktorëve. Në një treg bankar me konkurrencë të lartë, ku bankat nuk mund të ndikojnë plotësisht, të ardhurat nga komisionet pritet të funksionojnë si zëvendësuese të të ardhurave nga interesi. Në këtë rast, lidhja midis marzhit neto të interesave dhe të ardhurave neto nga komisionet do të rezultojë negative. Nëse bankat gëzojnë një lloj fuqie në tregun ndërbankar (si pasojë e specializimit në produkte dhe shërbime të veçanta), ato mund të ndikojnë në caktimin e normës së interesit duke bërë që

në këtë rast të ardhurat nga komisionet dhe nga interesat të rezultojnë si plotësuese të njëra-tjetrës dhe lidhja të rezultojë pozitive (E strada, 2006).

Cilësia e administrimit - Angbanzo (1997) dhe Maudos e Fernández de Guevara (2004) shprehen se një administrim cilësor nënkupton përzgjedhjen e aktiveve me cilësi të mirë (me rrezik të ulët e kthim të lartë) dhe pasiveve me kosto të ulët. Meqënëse cilësia e administrimit matet nga raporti kosto/të ardhura, një rritje e këtij raporti do të thotë një përqendrim i cilësisë së administrimit dhe si pasojë, edhe rënie në marzhin neto të interesave.

Kostot oportune – Siç dihet, bankat janë të detyruara të depozitojnë pranë bankës qendrore, rezervën e detyruar⁴. Kostoja oportune e mbajtjes së rezervës, duhet të kompensohet nga caktimi i normave më të larta të interesit për kreditë. Në studimin e tyre, (E strada, 2006) dhe (Gelos, 2006), kanë gjetur një vlerë pozitive të koeficientit para këtij variabli.

Rritja e PBB-së - Bernanke dhe Gertler (1989) kanë arritur në konkluzionin se aftësia paguese e huamarrësve është kundërciklike. Koeficienti duhet të ketë një shenjë negative, pasi gjatë periudhave të rënies ekonomike, aftësia paguese bie dhe në këtë mënyrë, huamarrësit mund të marrin hua vetëm me norma më të larta interesi, duke rritur kështu marzhin e interesave.

Duke patur parasysh rezultatet e marra nga të gjithë autorët e sipërpërmendur për lidhjen e këtyre faktorëve me marzhin neto të interesave, duket e arsyeshme që disa prej këtyre variablave të përfshihen edhe në ekuacionet që do të vlerësohen për rastin e sistemit bankar shqiptar. Nga ana tjetër, duke konsideruar kushtet financiare apo makroekonomike të vendeve në zhvillim si dhe disa karakteristika të veçanta në sjelljen e bankave të këtyre vendeve, do të shtohen edhe variabla të tjerë për t'i përshtatur me këto kushte.

Marzhi neto i interesit është investiguar nga shumë autorë të ndryshëm në mbarë botën. Rezultatet empirike të autorëve të ndryshëm lidhur me përcaktuesite e marzhit neto të interesit janë paraqitur, në vijim: Sipas autorit Angbazo (1997) i cili e bëri hulumtimin për bankat amerikane për periudhen 1989-1993, konkludoj se rreziku i kredisë, kostoja e mundshme e rezervave jo nga interesi, qëndrueshmëria e kapitalit dhe efikasiteti i menaxhimit janë lidhur pozitivisht me marzhin e neto të interesave bankare. Ndërsa sipas këtij autori likuiditeti ka pasur një ndikim negativ. (Angbazo, 1997)

Sipas autorëve Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999), të cilët hulumtuan rreth 80 shtete të zhvilluara dhe në zhvillim për periudhen 1988-1995, sipas analizës ekonometrike, rezultuan se inflacioni ka marrëdhënie të drejtë me marzhe neto më të larta të interesit përderisa raporti i përqendrimit, madhësia e bankave dhe bankat e huaja ndikojnë pozitivisht në marzhin neto të interesit. Poashtu variablat me karakteristika bankare, siç janë: Kreditë në raport me totalin e aseteve, kapitali ndaj totalit të aseteve dhe raporti i kapitalit ndaj aseteve kanë ndikim pozitiv në NIM. Rritja e PBB-së dhe rregullat ligjore – institucionale (treguesit e zbatimit më të mirë të kontratave, efikasitetin në sistemin ligjor dhe mungesa e korrupsionit) kanë rezultuar me një ndikim negativ në NIM.

Demirgüç-Kunt dhe Huizinga së bashku me Claessens e vazhduan po të njëjtin hulumtim në vitin 2001, poashtu për 80 shtete dhe për periudhën e njëjtë 1988-1995, mirëpo arriten në rezultate tjera ekonometrike, ku sipas tyre hyrja e bankave të huaja nuk ka dhënë ndikim potencial në marzhin neto të interesave. Ndërsa inflacioni, norma reale e interesit, rritja e PBB-së dhe totali i shpenzimeve operative në raport me asetet totale janë të lidhura pozitivisht me marzhet neto të interesit. (Claessens. Stijn, 1997, 2001) Me rritjen e pranimit të bankave të huaja në treg vërehet një reduktim i marzheve të interesit për bankat vendase.

Autori Drakos (2002), hulumtimin e tij e bërë për bankat greke për periudhën 1992-1999 dhe erdhi në përfundim se rreziku i kredisë, qëndrueshmëria e kapitalit, rritja e PBB-së, norma e inflacionit dhe rritja e ofertës monetare kanë ndikim pozitiv në marzhet neto të interesit. (Drakos, 2002) Ndërsa likuiditeti dhe pronësia e bankave vendore e zvogëlojnë marzhin neto të interesave. Rreziku i normës së interesit dhe aftësia e menaxhimit sipas rezultateve të Drakos nuk kanë asnjë ndikim.

Autoret Abreu dhe Mendes (2003) hulumtuan bankat e Portugalisë, Spanjës, Francës dhe Gjermanisë për periudhën 1986-1999, dhe erdhën në përfundim se variablat si: Kreditë në raport me total asetet, shpenzimet operative dhe kapitali në raport me total asetet kanë një ndikim pozitiv në marzhin neto të interesave. Kurse struktura e tregut, shkalla e papunësisë, rritja e PBB-së dhe kursi nominal i këmbimit nuk kanë efekte në marzhin neto të interesave. Sipas rezultateve inflacioni si variabël i pavarur rezultoi me ndikim negativ. (Abreu, 2003)

Autori Drakos e vazhdoi hulumtimin e tij për bankat e vendeve, si: Bjellorusia, Bullgaria, Republika e Çekisë, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Ukraina. Hulumtimin e bëri për periudhën 1993-1999, dhe erdhi në përfundim se bankat me pronësi vendore kanë lidhje më të ngushtë të margjinave neto të interesave. Hyrja e bankave të huaja në treg drejtpërdrejtë i ul margjinat neto të interesit kështu duke e intensifikuar konkurrencën dhe në mënyrë indirekte duke prodhuar eksternalitete pozitive ndaj sektorit bankar në përgjithësi duke shpërndarë praktika të mira. (Drakos K., 2003)

Autori Nys (2003), hulumtoi dymbëdhjetë shtete të Bashkimit Evropian, si: Belgjikën, Danimarkën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Irlandën, Italin, Luksemburgun, Hollandën, Portugalin, Spanjën, dhe Anglinë. Hulumtimin e bëri për periudhën 1989-1999, gjetjet që

kishin marrëdhënie pozitive me marzhin neto të interesave ishin rreziku i kredisë, shpenzimet administrative dhe operative ndërsa tarifat neto kanë ndikim negativ në marzhin neto të interesave. (Nys, 2003)

Autoret Demirgüç-Kunt, Laeven and Levine (2004), vazhduan hulumtimin e marzhin neto të interesave si variabël i varur për 72 shtete për periudhën 1995-1999, dhe arritën në konkludim se madhësia e bankave, likuiditeti dhe rritja e PPB-së kanë ndikim negativ në marzhet neto të interesit, ndërsa përqendrimi apo stuktura e tregut, kapitali dhe inflacioni kanë ndikim pozitiv. Rregullat e rrepëta për hyrjen e bankave të reja në treg, kufizimet në aktivitetet bankare dhe rregullorët që e pengojnë lirinë e bankierëve për të kryer rritjen e bizneseve rrisin marzhet neto të interesave të bankave. (Levine, 2004)

Autoret Maudos and Fernández de Guevara (2004), hulumtoi përcaktuesitë e marzhit neto të interesit në vendet, si: Gjermania, Franca, Anglia, Italia, dhe Spanja, për periudhën 1993-2000, dhe erdhen në konkludim se fuqia e tregut (e përfshirë nga Indeksi i Lerner-it dhe Herfindahl- Hirschman- Indeks), rreziku i normës së interesit, rreziku i kredisë, rreziku ndaj aversionit, shpenzimet operative dhe pagesat nga interesi ndikojnë pozitivisht në margjinat neto të interesave. Menaxhimi i cilesisë dhe madhësia e bankave kanë pasur ndikim negativ në marzhin neto të interesave. (Maudos, 2004)

Autoret Martinez Peria and Mody (2004), hulumtin e tyre e zhvilluan për vendet, siç janë: Argjentina, Kili, Kolumbia, Meksika dhe Peru për periudhën 1995-2001, ku sipas reultateve ekonometrike erdhen në konkludime se likuiditeti i bankës, kostot administrative dhe struktura bankare kanë ndikim pozitiv në spread-at e bankave përderisa bankat e huaja kërkojnë spread-a më të ulëta. (Martinez Peria M. S., 1998) (Martinez Peria, 2004)

Autori Sologoub (2006), hulumtoi 30 bankat e mëdha të Ukrainës për periudhën 2002-2005. Gjetjet që kanë marrëdhënie pozitive në marzhin neto të interesave janë: Mjaftueshmëria e kapitalit, shpenzimet e përgjithshme, raporti i kredive të humbura dhe provizioneve, të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet dhe madhësia e bankave. Ndërsa asetet likuide dhe inflacioni kanë marrëdhënie negative me marzhin neto të interesave. Bankat në pronësi të huaj kanë tendencë të kenë margjina më të ulët të interesit, por përparësia krahasuese e tyre është se zvogëlohet me kalimin e kohës. (Sologoub, 2006)

Autorët Claeys and Vander Venet (2007) hulumtuan 31 vende perëndimore dhe lindore Evropiane për periudhën 1994-2001, erdhën në përfundim se struktura e tregut, raporti i kapitalit ndaj aseteve, raporti i huave ndaj aseteve, rritja e PBB-së dhe inflacioni kanë ndikim pozitiv në marzhin neto të interesave ndërsa raporti i efikasitetit ka ndikim negativ dhe hyrja e bankave të huaja poashtu i zvogëlon margjinat neto të interesave. (Claeys, 2007)

Autoret Carbo and Rodriguez (2007), hulumtuan 7 shtete Evropiane për periudhën 1994-2001. Ata përdorin disa mesatare të margjinave të interesit si kreditë në raport me spreadin e normave të depozitave, të ardhurat bruto dhe indeksin e Lerner-it. Rezultatet në terma të kredive në raport me spread-in e normave të depozitave tregojnë një marrëdhënie pozitive me kreditë, rrezikun e likuiditetit dhe normën e interesit, po aq me ndikim ka edhe joefikasiteti operativ dhe raporti i kapitalit ndaj aseteve. PBB-ja dhe raporti i kredive ndaj aseteve totale duket se i redukton margjinat e interesit, ku në ndërkohë që struktura e tregut (Indeksi Herfindahl-Hirschman) ka ndikim të parëndësishëm. (Carbo V.S., 2007)

Sipas Maria Eleni K. Agoraki në punimin e saj “Përcaktuesit e marzhit neto në vendet e Evropës jug-lindore”, variablat i determinon në tre kategori: të bankës, të industrisë dhe ato

makroekonomike për periudhën 1998-2007. Sipas analizës empirike, rezulton se NIM ndikohet me së shumëti nga variablat e bankave si: risku, kapitali dhe madhësia e bankës. Poashtu, struktura rregullative luan një rol të rëndësishëm te institucionet e huaja. Me zhvillimin e sistemit financiar dhe përfundimin e procesit të reformave, rritja ekonomike e tashme dhe e ardhshme do të kenë ndikim më të madh në margjinat e bankës. (Agoraki, 2010)

Autorët Kaiguo Zhou dhe Michael C.S. Wong nga Mainlanda e Kinës analizuan përcaktuesit e marzhit neto të interest në bankat komerciale të Kines prej vitit 1996 deri 2003. Rezultatet në ndikimin e NIM rrjedhin nga këto variabala: struktura e tregut shpezimet operuese, risku, transakcionet numerike, pagesat nga interesi, rezervat, efienca menaxheriale. (Wong, 2008)

Autoret Louvti Rodney Sidabalok nga Banka qendrore e Indonezisë dhe Viverita D., profesor ne Universitetin Indonezisë, analizuan përcaktuesite e marzhit neto të sektorit bankar Indonezian për vitet 2003-2009. Gjetjet e tyre treguan se ndikim të lartë në marzhin neto të interesit shkaktohen nga faktorët e bankës, si: risku kreditor dhe shpenzimet operative, faktorët e tregut. (D., 2011)

Autori Fatih Kansoy analizoi përcaktuesitë e marzhit neto në sektorin bankar të Turqisë për periudhen 2001-2012, ku rezultoi se kostot e diversitetit, rreziku i kredisë dhe shpenzimet operative janë përcaktuesit më të rëndësishem në sektorin bankar të Turqisë. Bankat më efikase shfaqin diferencë më të ulët dhe stabiliteti i çmimeve kontribuon poashtu në diferencë më të ulët. Efekti i përcaktuesve kryesorë të tilla si rreziku i kredisë, madhësia e bankës, përqendrimit të tregut dhe inflacioni ndryshojnë në të gjithë, bankat e kontrolluara nga shteti dhe private e të huaja. Në të njëjtën kohë, ndikimet e pagesës

nënkuptuar te interesit, diversitetit operacional dhe kostot operative janë homogjene gati në të gjitha bankat. (Kansoy, 2012)

Zahler (2004) ka vlerësuar koston e ndërmjetësimit financiar (për shkak të nivelit të lartë të shpenzimeve, ROE të lartë, ofertës së lartë për kredi) në 13.5% për bankat në Kosovë. (Toçi, 2005) Kostoja e lartë e ndërmjetësimit financiar pasqyron ndërveprimin ndërmjet mungesës së efikasitetit të madh dhe premisë me rrezik të lartë në një sektor tepër të koncentruar (FMN, 2004)

Duke i analizuar dhe paraqitur me kujdes faktorët që e përcaktojnë marzhet neto të normave të interesit në vende të ndryshme të botës, në vijim do të mundohemi që të paraqesim sektorin bankar të Kosovës në përgjithësie më pas të bëjmë një analizë paneli për vendet e Ballkanit.

3.4. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua dhe u paraqit në mënyrë të detajuar kuadri teorik mbi përcaktuesitë e marzhit neto të normave të interesit. Përveç analizës teorike, u shtjelluan edhe analiza kontabël dhe ajo empirike e përcaktuesëve të marzhit neto të normave të interesit. Analiza empirike shtjellohet duke treguar mbi variablat e pavarura të shumë autorëve, hipotezat e tyre dhe rezultatet empirike. Sipas kuadrit teorik marzhi neto i normave të interesit ndikohet nga karakteristikat bankar, të tregut dhe makroekonomik. Në kuadër të karakteristikave bankare hyjnë: *Performanca e portfoliosë*, e cila matet nga raporti i kredive ndaj mjeteve totale. (Clayes, 2007). *Qëndrimi ndaj rrezikut*, që paraqet raportin e kapitalit me totalin e mjeteve. (Maudos dhe Fernández deGuevara, 2004;

Angbazo, 1997; Saunders dhe Schumacher, 2000; Drakos, 2002, Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sologoub, 2006).

Rreziku i likuiditetit përcaktohet nga aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve. (Angbazo, 1997; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). *Rreziku i kredise* që paraqet raportin e kredive me probleme ndaj totalit të bruto kredive. (Drakos, 2002, Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004). *Shpenzimet operative* te llogaritura në raport me totalin e mjeteve. (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999, Abreu dhe Mendes, 2003, Demirgüç-Kunt dhe të tjerët, 2004; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007). *Madhësia e bankave* e llogaritur sipas madhësisë së aseteve. (Naceur, 2003; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Gual, 1999)

Pronësia e bankave paraqet variablin e fundit në kuadër të karakteristikave bankare; (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sapientza, 2002). Përveç analizës të kuadrit teorik të karakteristikave bankare, kemi edhe karakteristikat e tregut dhe makroekonomik. Në kuadër të karakteristikave të tregut kemi variablin *struktura e tregut* e shprehur përmes HHI-së, e vlerësuar kështu nga shumë autore të ndryshëm. (Berger, 1995b; Carbo dhe Rodriguez, 2007; Demsetz, 1973; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). Kurse në kuadër të karakteristikave makroekonomikë kemi PBB-në (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999 dhe Demirgüç-Kunt et al., 2004 ; Brock dhe Suarez, 2000; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Vein, Carbo dhe Rodriguez, 2007; Drakos, 2002). Konsiderohet si pjesa më e rëndësishme e punimit apo më mirë të themi pjesa e pikënisjes së hulumtimit të studimit, kështu duke i identifikuar metodologjitë dhe metodat,

variablat dhe marrdhëniet e tyre, hipotezat, modelin e analizat tjera të cilat e bëjnë të veçantë këtë studim.

KAPITULLI IV: SEKTORI BANKAR NË KOSOVË DHE NORMAT E INTERESIT

4.1. Sektori bankar në Kosovë

Bankat luajnë rol shumë të rëndësishëm në sistemin financiar dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit e sidomos në vendet në zhvillim siç është Kosova. Struktura e sistemit financiar të Kosovës vazhdon të dominohet nga sektori bankar, aktivet e të cilit zënë rreth 70 përqind të aktiveve të të gjithë sistemit financiar. (BQK, 2015).

Për dallim nga vendet tjera të rajonit, të cilat u deshën të ndjekin një proces të gjatë e të vështirë të tranzicionit të sektorit bankar nga sistemi i ekonomisë së centralizuar drejtë ekonomisë së tregut, Kosova u gjend në një situatë më ndryshe duke mos trashëguar asgjë nga sistemi financiar i kaluar. Në njërën anë, kjo paraqiste një disavantazh të theksuar me që gjithëçka rreth funksionalizimit të sektorit bankar dhe financiar në përgjithësi duhej të nisej nga e para, gjë që paraqiste një proces mjaft sfidues. Në anën tjetër, e gjithë kjo ka paraqitur një përparësi me që u mundësua krijimi i një sistemi financiar i cili që nga fillimi u bazua në parimet e ekonomisë së tregut dhe evitoi problemet me të cilat u ballafaquan shtetet tjera. Në këtë kontekst, Kosova që nga fillimi u përcaktua për një sektor bankar të bazuar në pronësinë private dhe i hapi dyert hyrjes së bankave të huaja, të cilat, përveç kapitalit, sollën edhe praktikrat bashkëkohore të afarizmit bankar, duke mundësuar kështu një konvergjim më të shpejtë të industrisë bankare të Kosovës drejtë atyre të vendeve me

përvojë më të gjatë në këtë fushë. Zhvillimi i sektorit bankar të Kosovës gjatë kë- tyre 15 viteve me të drejtë është konsideruar si “tregim i suksesshëm”. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar ka shërbyer si burim shumë i rëndësishëm i financimit për ekonominë e vendit. Përkundër se është sektori më i ri bankar në gjithë rajonin, sektori bankar i Kosovës ka një karakteristikë të veçantë dalluese, e që është niveli i lartë i stabilitetit që e ka karakterizuar prej fillimit të funksionimit të tij e që vazhdon edhe tani. Ky sektor në vazhdimësi ka gëzuar pozitë të kënaqëshme likuiditeti, cilësi të mirë të portofolit kreditor si dhe nivel të lartë të kapitalizimit. Me gjithë arritjet e deritanishme, sektorin bankar të Kosovës e presin sfida të mëtutjeshme për të avancuar rolin e tij në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të kreditimit, raporti ndërmjet kredive dhe produktit të brendshëm bruto në Kosovë vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me vendet tjera, duke sugjeruar kështu se ka hapësirë për zgjerim të mëtutjeshëm të ndërmjetësimit financiar. Kreditimi i deritanishëm ka qenë kryesisht i koncentruar në sektorin e tregtisë, mirëpo kërkohet një zgjerim më i shpejtë i kreditimit edhe për sektorët tjerë, siç janë prodhimtaria e bujqësia, sektorë këta që kanë rëndësi të madhe për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Rritja e kreditimit për këta sektorë pa dyshim se varet edhe nga vetë zhvillimi i këtyre sektorëve, por një parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tyre është pikërisht financimi. Në këtë kontekst, bankat duhet të ndjejnë përgjegjësinë për të rritur përkrahjen ndaj sektorëve më pak të zhvilluar të ekonomisë, gjë e cila do të ndikojë edhe në rritjen e tregut për vetë bankat si dhe do të përmirësojë ambientin e përgjithshëm ku ato operojnë. Në këtë aspekt, mes tjerash, bankat mund të japin kontribut të rëndësishëm përmes aktiviteteve të ndryshme të edukimit dhe trajnimit, duke ndihmuar përgatitjen e këtyre sektorëve në përmbushjen e kriterëve të

kërkuara nga bankat për kreditim. Në vitet e fundit, kreditimi nga sektori bankar është karakterizuar me ngadalësim të vazhdueshëm të normës së rritjes, përderisa depozitat kanë vazhduar të rriten me trend mjaft të qëndrueshëm. Kjo tregon se kemi të bëjmë me tërheqje të likuiditetit nga ekonomia, gjë e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Andaj, bankat duhet të reflektojnë me kujdes ndaj këtyre zhvillimeve, duke marrë masa që sigurojnë kreditim të qëndrueshëm për ekonominë e vendit dhe rritje të kërkesës.

Sektori bankar në Kosovë perbehet nga dy nivele të bankave. Banka Qendrore e Kosovës e cila i takon nivelit të parë dhe bankat komerciale të cilat u takojnë nivelit të dytë.

4.1.1. Banka Qendrore e Kosovës dhe mbikëqyrja bankare

Reformimi i sistemit bankar në Kosovë filloi pas luftës të vitit 1999, udhëhequr nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (ABPK), si paraardhës i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). BQK-ja është institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullativ në sistemin financiar të Kosovës dhe ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. BQK-ja luajti rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit bankar në Kosovë dhe ruajtjen e stabilitetit të tij, duke zhvilluar një kornizë rregullative të bazuar në praktikën bashkëkohore dhe poashtu duke siguruar implementimin adekuat të kësaj kornize rregullative, duke bërë që sjellja e bankave të jetë në përputhje me parimet e bankëut të shëndoshë. Kujdes i veçantë i'u kushtua politikës së licencimit të bazuar në parimet e licencimit të shëndoshë, çka paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin dhe stabilitetin e sektorit bankar. Në këtë kontekst, një ndër aktivitetet e rëndësishme të

Bankës Qendrore është promovimi i vazhdueshëm i ambientit financiar e ekonomik të investitorët e rinjë, duke synuar kështu nxitjen e konkurrencës së shëndoshë në sistemin bankar. Objektivi parësor i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Objektivi shtesë i BQK-së, i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore. Poashtu, vëmendje e veçantë i'u kushtua zhvillimit të infrastrukturës bankare, duke përfshirë sistemin e pagesave, regjistrin e kredive, si dhe skemat tjera të cilat kanë lehtësuar afarizmin e bankave.

Detyrat e BQK-së në arritjen e objektivave të përcaktuara përfshijnë:

- ☐ përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent;
- ☐ rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare;
- ☐ promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë;
- ☐ sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë;
- ☐ mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare;
- ☐ mbledhjen dhe publikimin e statistikave;
- ☐ kontribuimin në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
- ☐ informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj;
- ☐ veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë dhe çdo organ publik dhe organizatë publike të Kosovës;

- bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare përkitazi me çështje brenda fushës së saj të kompetencave; dhe
- realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedh nga ushtrimi i detyrave të saj.

Veprimtaria e BQK-së sigurohet nga organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj. Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga kryetari dhe tre anëtarë të tjerë joekzekutivë si dhe nga Guvernatori dhe është i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe ushtrimit të operacioneve të BQK-së. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët dhe është i ngarkuar me zbatimin e vendimeve të BQK-së, si dhe administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të saj. Guvernatori shërben si kryeshef ekzekutiv i BQK-së i ngarkuar me aktivitetet e përditshme të BQK-së, në realizimin e të cilave ndihmohet nga zëvendësguvernatorët. Personeli i BQK-së është i strukturuar në njësi organizative të përcaktuara në bazë të veprimtarive të veçanta operacionale dhe administrative. (BQK, Plani strategjik 2015-2019, 2015). Mbikëqyrja financiare ka zgjedhur një qasje graduale drejt përafrimit me standardet ndërkombëtare me fokus të veçantë direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian për mbikëqyrjen e bankave, të cilat rregullojnë veprimtaritë e institucioneve kreditore dhe përcaktojnë kërkesat për kapitalin e tyre. Ky është një proces gradual, duke marrë në konsideratë se pas krizës së fundit financiare të vitit 2008, standardet ndërkombëtare të njohura si Korniza e Bazel II, kanë pësuar mjaft ndryshime, për adresimin e çështjeve të cilat janë konsideruar si faktor nxitës të krizës financiare, si dhe duke konsideruar zhvillimin dhe nevojat e sistemit bankar të Kosovës. Gjatë vitit 2015, në drejtim të kornizës së Bazel II janë bërë ndryshime të rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave,

me anë të së cilës përcaktohen kërkesat për kapital për të adresuar kërkesat ndaj kredive hipotekare rezidenciale. Ky ndryshim ka rrjedh si rezultat i adaptimit të rregullores së re për kreditë hipotekare rezidenciale, e cila është e bazuar në Direktivën e BE-së dhe standardet e Bazel-it. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 janë përgatitur dy rregullore të rëndësishme për sa i përket adaptimit të kërkesave të Basel-it, rregullorja për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ, e cila tani veç është në fuqi pasi është miratuar nga Bordi i BQK-së me 28 janar 2016, si dhe rregullorja për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, , e miratuar nga Bordi me 29 prill 2016, pasi që janë kryer të gjitha përgatitjet dhe studimet e impaktit të saj në sektorin bankar. Me këto ndryshime parashihet një adaptim i plotë i qasjes së standardizuar për peshimin me rrezik të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, duke zgjeruar numrin e klasave të ekspozimit për të reflektuar ndaj zhvillimeve të tregut bankar në Kosovë, si dhe duke adaptuar parimet dhe rregullat më të sofistikuar për përlllogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezik, për secilën klasë ekspozimi; parimet dhe metodat e njohjes së teknikave të zbutjes ndaj rrezikut kreditor. Gjithashtu, do të adaptohen edhe kërkesat për kapital për mbulimin e rrezikut të tregut, si dhe do të rishikohet përkufizimi i kapitalit sipas kornizës së re të Bazel III. Si hap tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është edhe përshtatja e kërkesave të shtyllës së dytë – lidhur me rishikimin nga mbikëqyrësi të procesit të brendshëm të bankave për vlerësimin e nevojave të bankës për kapital. Gjithashtu me hyrjen në fuqi të kërkesave të reja për kapital, do të rishikohen dhe përditësohen edhe kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës për palët e interesit dhe të cilat janë të njohura si kërkesat e shtyllës së tretë të Kornizës së Bazelit me qëllim rritjen e disiplinës së tregut

përmes kërkesave për shpalosje dhe rritjen e transparencës. Në këtë drejtim, në shtator të vitit 2014, BQK-ja ka startuar me projektin specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza Bazel-it për Kapitalin. Si një objektiv afatgjatë i Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe si një ndër qëllimet kryesore strategjike, BQK-ja ka filluar këtë projekt duke marrë mbështetje të fuqishme nga institucioni Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ.

4.1.2. Bankat komerciale dhe veprimtaria e tyre

Bankat komerciale janë bërë aktorët kryesorë në kanalizimin e fondeve nga huadhenësit të huamarrësit, burim i financimit të bizneseve, individeve dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Pas luftës sistemi bankar dhe përgjithsisht sistemi i kreditimit në Kosovë është dashur të ndërtohet që nga fillimi. Për një periudhë prej 7 mujore, deri sa filloi funksionimi i bankës së parë (MEB, Janar 2000) nuk funksiononte asnjë bankë tjetër. Gjatë vitit 2001, në periudhën Mars – Nëntor, u formuan edhe 6 banka tjera. Numri i bankave komerciale në Kosovë deri në fund të vitit 2016 është dhjetë. Ato përfshijnë 67.6 përqind të strukturës së aseteve të sistemit financiar në përgjithësi. (BQK, Raporti i stabilitetit financiar, Qershor 2016). Deri në vitin 2016 zhvillimi i bankave ka shkuar në drejtim të zgjerimit të rrejtit të tyre në territorin e Kosovës, kështuqë është rritur dukshëm numri i degëve dhe nëndegëve të tyre, duke u realizuar një shtrirje në të gjitha komunat e Kosovës. Veprimtaria e këtyre bankave bazohet në rregulloret që u përgjigjen standardeve ndërkombëtare dhe mbikëqyret nga BQK-ja. Veprimtaria e bankave komerciale me degët dhe nëndegët e saj për periudhën 2004-2015, poashtu dhe numri i të punësuarëve është paraqitur në tabelën me nr.5.

Tabela nr.5. Veprimtaria e bankave komerciale dhe numri i te punësuarëve

Vitet	Bankat	Degët	Nëndegët	Nr. i të punësuarëve
2004	7	45	194	2066
2005	7	35	171	2341
2006	6	33	170	2416
2007	9	34	183	2715
2008	8	46	233	3607
2009	8	49	238	3459
2010	8	49	254	3610
2011	8	43	259	3728
2012	9	43	258	3727
2013	9	44	245	3549
2014	9	45	223	3507
2015	10	45	210	3375

BQK (2016)

Në tabelën nr. 5 shohim se veprimtaria e bankave komerciale në Kosove duke përfshirë numrin e degëve dhe nëndegëve prej vitit 2004 deri ne vitin 2015, ka gjithsej dhjetë bankave komerciale, gjithsej 45 degë dhe 210 nëndegë. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe nëndegëve të bankave përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe nëndegëve bankare në regjionin e Prishtinës (35%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (25%). (BQK, Raporti vjetor, 2015). Numri i të punësuarëve në banka shënon 3,375 punonjës.


Produktet dhe shërbimet e bankave komerciale ne Kosove përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Në mënyrë të specifikuar, bankat në Kosovë ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve dhe shërbimeve bankare. Edhe pse shumica e këtyre produkteve hyjnë në grupin e shërbimeve klasike bankare, kohëve të fundit bankat kanë

filluar zgjerimin gamës së shërbimeve të tyre me disa risi për tregun, të tilla si Lizingu, Shërbimet bankare elektronike (Mobile Banking) dhe shërbime të tjera. Në përgjithësi, produktet dhe shërbimet e ofruara nga Bankat përshijnë: Depozita; Kredi; Shërbimi i pagesave/transfertave të brendshme dhe të jashtme; Biznes dokumentar (Garancione dhe letër kredi); Shërbime elektronike dhe produkte të tjera. Bazuar në metodologjinë për raportimin e instrumenteve të pagesave, bankat komerciale kanë vazhduar raportimin e rregullt të statistikave për instrumente të pagesave në Departamentin e Sistemit të Pagesave në BQK.

Nga të dhënat e mbledhura, përpunuara dhe të analizuara gjatë vitit 2015 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave.


Në figurën nr.1. është paraqitur numri i terminaleve të ATM-ve kurse në figurën nr.2. është paraqitur numri i terminaleve të POS-ave. Të dhënat e paraqitura janë marrë nga Banka Qendore e Kosovës për periudhën 2011-2015.

Figura nr.1. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2016)

Figura nr.2. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2016)

Përveç numrit të kartelave me funksion pagesë që është rritur, rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2015, janë raportuar 837,747 kartela me funksion debiti, 203,845 kartela me funksion krediti. Këto kartela kanë mundur

të përdoren në 540 terminale ATM (bankomat) dhe 9,705 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpër Kosovë. Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 8.4% dhe numri i terminaleve POS me 3.8%. Në figurën me nr.3. është paraqitur vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave.

Figura nr.3. Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Nga figura, shihet se kemi një tendencë në rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave e-banking u rrit për 46.3%, ndërsa vlera e tyre u rrit për 36.2%. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 16.5%, ndërsa vlera e tyre është rritur për 27.3%. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale u karakterizuan me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2015 është rritur për rreth 5 %, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 22.7%.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2015, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 1.89 milion, që paraqet një rënie prej 1.6 % krahasuar me fundin e vitit 2014. Rreth 98.52 % e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.48 % janë të jorezidentëve. Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2015, rreth 187.3 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë,

duke shënuar një rritje prej 18.7% në krahasim me vitin 2014. Në tabelën nr.6. është paraqitur një tabelë krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave në vendet e Ballaknit.

Tabela nr.6. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.82	274	5,137	66,842	372,577	86,681
Shqipëria	2.89	281	2,276	29,351	268,926	50,246
Republika Çeke	10.51	423	9,618	150,796	894,314	-
Turqia	76.67	594	31,163	743,523	1,376,202	-
Slovenia	2.06	821	15,962	56,465	1,158,719	-
Bulgaria	7.24	776	10,532	129,549	868,282	-
Hungaria	9.88	494	10,617	140,928	756,474	-
Bosnja	3.83	372	6,004	-	-	55,760
Mali i Zi	0.62	560	20,619	78,813	573,292	101,598
Kroacia	4.25	993	23,415	50,100	1,588,397	-
Maqedonia	2.06	466	18,945	154,344	597,812	273,203

Burimi: BQK (2016) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

Bazuar në të dhënat statistikore zhvillimi i infrastrukturës ka një ritëm më të shpejt krahasuar me vendet e regjionit. Inkurajues mbetet trendi i shpejt i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

4.1.2.1. Pronësia e kapitalit dhe shkalla e koncentrimit bankar

Deri me tani në Kosovë janë duke operuar gjithsej 10 banka komerciale. Shpërhapja gjeografike e degëve të këtyre bankave është e ndryshme. Shtrirjen më të madhe gjeografike e ka ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank, kjo për shkak të potencialit bankar

që kanë. Shtrirje të konsiderueshme gjeografike kanë edhe NLB, TEB, BpB, BE, BKT, ndërsa Banka Ekonomike, IS dhe Ziraat kanë degët e saja në pak rrethe të vendit.²

Bankat me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara që operojnë në vend, tetë janë me pronësi të huaj. Nga bankat me pronësi të huaj, pesë prej tyre kanë vend të origjinës Austrinë, Gjermaninë, Slloveninë, Shqipërinë dhe Serbinë, përderisa tri të tjera kanë vend të origjinës Turqinë. Në sektorin bankar të Kosovës operojnë edhe dy banka me pronësi vendore. Në tabelen nr.7 janë paraqitur bankat sipas emrave dhe vendeve të origjinës që operojnë në Kosovë.

Tabela nr.7. Bankat komerciale në Kosovë dhe vend origjina e kapitalit të tyre


Nr.	Emri i bankes	Vend origjina e kapitalit
1.	Procredit Bank	Gjermani Austri
2.	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C	Gjermani Austri
3.	NLB Prishtina	Slloveni
4.	Banka per biznes	Kosove
5.	Banka ekonomike	Kosove
6.	TEB	Turqi
7.	Banka kombetare tregtare	Shqiperi
8.	Komercijalna Banka – Mitrovicë	Serbi
9.	Turkiye is bankasi – Prishtina	Turqi
10.	Ziraat bank – Prishtina	Turqi

BQK (2016)

² Banka komerciale në Kosovë janë 10-të (Banka për Biznes-2001; Banka Ekonomike-2001; ProCredit Bank-2000; Raiffeisen Bank-2003; Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë-2007, Dega në Kosovë; TEB sh.a.-2008; Banka Komerciale e Beogradit, Dega në Mitrovicë-2008; NLB Prishtina-2008; Turkiye is bankasi, Dega në Prishtinë-2015, Ziraat bank, Dega në prishtinë-2015).

Bankat me pronësi të huaj, udhëheqin me 89.8 përqind të gjithsej aseteve dhe zotëruan me 91.9 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. (BQK, Raporti i stabilitetit financiar, Qershor 2016). Në grafikun me nr.8. është paraqitur struktura e aseteve të sektorit bankar sipas pronësisë.


Grafiku nr.8. Stuktura e aseteve të sektorit bankar, sipas pronësisë



Sistemi bankar në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë të lartë të koncentrimin të tregut, ku rreth 77.4 përqind e gjithsej aseteve të sistemit bankar menaxhohen nga tri bankat më të mëdha. Dy bankat më të mëdha ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank kanë një pjesëmarrje në tregun e përgjithshme të kredive prej 68%. Struktura e tregut llogaritet përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH)³ për gjithsej asetet, kredi dhe depozita.

³ IHH-ja përdoret si një tregues i mundshëm i fuqisë së tregut ose i konkurrencës midis bankave. Ky indeks mat përqendrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e tregut. Sa më i lartë të jetë IHH-ja për një treg të caktuar, aq më shumë është i përqendruar produkti i atij tregu në një numër të vogël të bankave.

Grafiku nr.9. Shkalla e koncentrimit të sektorit bankar në Kosovë




Burimi BQK (2016)

Në grafikun me nr.9, është paraqitur shkalla e koncentrimit të bankave komerciale në Kosovë për vitet 2012 – 2015, duke u bazuar në të dhënat e BQK-së. Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar ka vazhduar trendin rënës në asete dhe kredi, dhe po ashtu në depozita për dallim nga vitet paraprake kur shkalla e koncentrimit të tregut në depozita kishte shënuar rritje. Rënia e koncentrimit në asete ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të aseteve të tri bankave më të mëdha. Ndërkaq, rënia e shkallës së koncentrimit në depozita erdhi si pasojë e rënies së depozitave në dy nga bankat më të mëdha, krahasuar me rritjen më të lartë të nivelit të depozitave në bankat tjera.

4.1.2.2. Struktura e asetëve dhe kreditë

Kreditë zënë pjesën më të madhe të strukturës së asetëve të sektorit bankar. Në vitin 2015 sektori bankar i Kosovës zgjeroi vlerën e asetëve në 3.39 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.3 përqind. Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve të sektorit bankar e kishte zgjerimi i portfolios së kredive që vazhdon të jetë kategoria dominuese në strukturën e asetëve të sektorit bankar. Përsheptimi i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar reflekton edhe ecurinë e qëndrueshme të depozitave, të cilat po ashtu shënuan përsheptim të ritmit të rritjes.


Grafiku nr.10. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Në kuadër të asetëve të sektorit bankar, rritjen më të theksuar vjetore prej 23.4 përqind e shënoi kategoria e letrave me vlerë. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kategorisë së letrave me vlerë në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 14.0 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në

vitin 2014. Zgjerimi i portfolios së letrave me vlerë gjatë vitit 2015 i atribuohet kryesisht rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, për dallim nga viti paraprak kur kontributin kryesor në rritje e kishin investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në vitin 2015, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja u karakterizuan me rritje prej 29.4 përqind krahasuar me rënie prej 25.0 përqind të shënuar në vitin 2014. Ndërsa, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 17.4 përqind, e cila paraqet rritje më të ngadalshme krahasuar me rritjen vjetore prej 92.6 përqind të shënuar një vit më parë. Kjo u reflektua edhe në ulje të pjesëmarrjes së letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës në 47.8 përqind, krahas zgjerimit të letrave me vlerë të qeverive të huaja në 52.2 përqind në gjithsej portfolion e letrave me vlerë të sektorit bankar në vitin 2015 (figura 4).

Figura nr.4. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Këto zhvillime mund të jenë rrjedhojë e ofertës më të ulët të Qeverisë së Kosovës për emetimin e letrave me vlerë krahasuar me vitin paraprak. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK- në po ashtu shënoi rritje të theksuar gjatë vitit 2015. Në vitin 2015, paraja e gatshme

u karakterizua me rritje vjetore prej 9.9 përqind krahasuar me rënien prej 3.5 përqind të shënuar në vitin 2014. Rritja e kësaj kategorie reflekton rritjen e depozitave në sektorin bankar dhe po ashtu normat e ulëta të interesit, madje edhe negative, në tregjet ndërkombëtare të cilat kanë kufizuar mundësitë e bankave komerciale për investime në këto tregje. Këto zhvillime ndikuan edhe në zvogëlimin e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit. Kjo kategori regjistroi rënie vjetore prej 19.1 përqind në vitin 2015, gjë që shkatoi zbritjen e pjesëmarrjes së kësaj kategorie në 9.3 përqind të gjithsej aseteve në vitin 2015 (tabela nr. 8).

Tabela. nr. 8. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	2012		2013		2014		2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	425.7	15.0%	463.3	15.1%	447.1	14.0%	491.2	14.5%
Bilanci me bankat komerciale	287.9	10.2%	339.9	11.1%	390.7	12.3%	316.0	9.3%
Letrat me vlerë	256.6	9.1%	354.5	11.6%	383.8	12.0%	473.5	14.0%
Kreditë bruto	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%	1,882.4	59.1%	2,019.4	59.6%
Asetet Fikse	57.7	2.0%	55.5	1.8%	53.7	1.7%	57.3	1.7%
Asetet Tjera	38.1	1.3%	40.3	1.3%	27.9	0.9%	29.8	0.9%
Gjithsej	2,829.3	100%	3,059.3	100%	3,185.6	100%	3,387.3	100%


Burimi: BQK (2016)

Pasi që kreditë zëne pjesën më të madhe të aseteve të sektorit bankar në Kosovë, do t'i hedhim një vështrim analitik rreth ecurisë katër vjeçare.

Kreditë vazhduan të karakterizohen me rritje të përshpejtuar që nga vitet paraprake. Në vitin 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.02 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.3 përqind. Në kuadër të gjithsej kredive, kreditë ndaj ekonomive familjare në vitin 2015 shënuan rritje prej 9.7 përqind. Rritja e kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet rritjes prej 27.7 përqind të kredive të reja hipotekare dhe rritjes prej 55.8 përqind të kredive të reja me kushte favorizuese, krahas rënies prej 2.8 përqind të kredive të reja konsumuese. Kontributin kryesor në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kreditimit të sektorit e kanë dhënë

kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat edhe kanë peshën kryesore në kuadër të gjithsej kredive (65.9 përqind të gjithsej kredive). Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind në vitin 2015.

Figura nr.5. Kreditë sipas sektorëve, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2016)

Rritja e kreditimit gjatë vitit 2015 i atribuohet lehtësimit kushteve të kreditimit nga ana e bankave, të realizuar përmes uljes së normave të interesit, zgjerimit të shumës së kredisë si dhe afatit të maturimit në kreditë e ofruara, si dhe rritjes së kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Rritja e kërkesës për kredi në masë të konsiderueshme është nxitur nga rënia e normave të interesit në kredi gjatë këtij viti.

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e kryesuar nga kreditë e destinuara për sektorin e tregtisë (me pjesëmarrje prej 51.2 përqind), pasuar nga ato për sektorin e prodhimtarisë (12.3 përqind) dhe sektorin e ndërtimtarisë (7.5 përqind). Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të ulët në financimin bankar me pjesëmarrje prej 4.5 përqind, por gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me rritje të përshpejtuar.

Figura nr. 6. Kreditë sipas sektoreve ekonomik, në përqindje




Sa i përket tendencave të fundit të kreditimit të sektorëve ekonomik, deri në vitin 2015, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje, duke përjashtuar sektorin e ndërtimtarisë i cili vazhdon të karakterizohet me trend rënës që nga viti 2013. Vlen të theksohet që sektorët të cilët përgjithësisht kanë pjesëmarrje më të ulët në kreditimin bankar, siç janë sektori i bujqësisë dhe i shërbimeve financiare, gjatë vitit 2015 shënuan rritje më të theksuar, gjë që paraqet zhvillim të rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit ekonomik në vend.

Rritjen më të theksuar vjetore prej 55.1 përqind në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve e regjistroi kreditimi për sektorin e shërbimeve financiare që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me rënien prej 11.9 përqind të shënuar në vitin 2014. Kjo rimëkëmbje deri në një masë mund t'i atribuohet rritjes së regjistrimit të ndërmarrjeve të reja me aktivitet financiar dhe sigurime, ku viti 2015 reflekton numrin më të madh të regjistrimeve në këtë sektor në krahasim me të gjitha periudhat paraprake. Më specifikisht, deri në vitin 2015, numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2015 ishte 95 ndërmarrje, që paraqet dyfishin e ndërmarrjeve të reja të regjistruara në këtë sektor gjatë vitit paraprak (43 deri në vitin 2014).

Normën e dytë më të lartë të rritjes prej 20.3 përqind e regjistroi kreditimi i sektorit të bujqësisë që paraqet një përmirësim të theksuar krahasuar me rritjen prej 8.7 përqind të shënuar në vitin 2014. Përmirësimi mund të jetë ndikuar nga dyfishimi i buxhetit të qeverisë për vitin 2015 për programin e subvencioneve dhe granteve në këtë sektor, gjë që u reflektua edhe në rritjen e numrit të bizneseve të reja të regjistruara në këtë sektor. Deri në vitin 2015, janë raportuar rreth 40 përqind më shumë biznese të reja në sektorin e bujqësisë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Figura nr.7. Kreditë sipas veprimtarive ekonomike, ndryshimi vjetor



Njëkohësisht, edhe norma e interesit në kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë në vitin 2015 shënoi rënien më të theksuar prej 4.3 pikë përqindje krahasuar me sektorët tjerë. Si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar, në vitin 2015, norma e interesit në kreditë për ndërmarrjet bujqësore ishte më e ulëta nga të gjithë sektorët e tjerë për dallim nga vitet paraprake kur normat e interesit për ndërmarrjet bujqësore ishin më të lartat. Kreditimi i sektorit të tregtisë në vitin 2015 shënoi rritje prej 1.3 përqind që paraqet ngadalësim krahasuar me rritjen prej 5.3 përqind të shënuar në vitin 2014.

Ritmi më i ngadalësuar i rritjes, mes tjerash, reflekton ecurinë e ngjashme të aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera, ku vërehet performancë më e dobët si te eksportet ashtu edhe te importet.

Figura nr. 8. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Rritje të kredive të pranura regjistroi edhe sektori i prodhimtarisë, që megjithëse me ritëm më të ngadalësuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak, ishte ndër sektorët me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë vitit 2015. Norma vjetore e rritjes së kredive për këtë sektor në vitin 2015 ishte 7.3 përqind .Në anën tjetër, përkundër rënies së normave të interesit dhe lehtësimit të standardeve të përgjithshme të kreditimit nga ana e bankave, kreditimi i sektorit të ndërtimtarisë vazhdon të zvogëlohet. Në vitin 2015, kreditë për sektorin e ndërtimtarisë regjistruan rënie vjetore prej 7.0 përqind (rënie prej 9.9 përqind në vitin 2014). Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, gjegjësisht kreditë me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’. Megjithatë, krahasuar me periudhat e kaluara, vërehet një tendencë e zhvendosjes drejt kreditimit afatgjatë. Në vitin 2015, kreditë afatshkurtra ‘deri në 1 vit’ shënuan rënie të pjesëmarrjes në

strukturë ndërsa, kategoria e kredive afatgjata ‘mbi 5 vite’ vazhdoi të rritet me ritëm më të shpejtë.

4.1.2.3. Struktura e detyrimeve dhe depozitat

Në anën tjetër të bilancit i kemi detyrimet, ku struktura e tyre në sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë rreth 79.8 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesor të financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në depozitat e mbledhura brenda vendit, dhe veçanërisht në depozita të ekonomive familjare të cilat konsiderohen burim më i qëndrueshëm i financimit, eviton ekspozimin e sektorit ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme financiare. Kategoria e bilancit me bankat tjera në vitin 2015 arriti në 43.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 37.2 përqind. Kategoria e huazimeve tjera (përfshirë çertifikatat e depozitave) regjistroi rritje prej 24.7 përqind në vitin 2015 dhe arriti vlerën prej 17.6 milionë euro (tabela 9). Me rritje të theksuar u karakterizuan edhe mjetet vetanake të sektorit bankar, që janë kategoria e dytë për nga pjesëmarrja me 11.6 përqind në gjithsej detyrimet e sektorit. Në vitin 2015, mjetet vetanake shënuan rritje vjetore prej 21.9 përqind (16.3 përqind në vitin 2014). Rritja e mjeteve vetanake ishte kryesisht si rezultat i profitit të lartë të realizuar nga sektori bankar gjatë vitit 2015.


Tabela.9. Struktura e detyrimeve e sektorit bankar

Përshkrimi	2012		2013		2014		2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	6.0	0.2%	16.5	0.5%	31.6	1.0%	43.4	1.3%
Depozitat	2,279.0	80.6%	2,449.0	80.1%	2,537.5	79.7%	2,701.4	79.8%
Huatë tjera	18.9	0.7%	13.4	0.4%	14.1	0.4%	17.6	0.5%
Detyrimet tjera	223.6	7.9%	246.2	8.0%	232.1	7.3%	194.3	5.7%
Borxhi i ndërranur	31.0	1.1%	56.3	1.8%	47.3	1.5%	36.8	1.1%
Mjetet vetanake	270.8	9.6%	277.8	9.1%	323.0	10.1%	394.0	11.6%
Gjithsej detyrimet	2,829.3	100%	3,069.3	100%	3,185.6	100%	3,387.3	100%

Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.70 miliardë euro në vitin 2015, që paraqet rritje vjetore prej 6.5 përqind (3.6 përqind në vitin 2014). Kjo normë e rritjes paraqet rimëkëmbje të ecurisë së depozitave krahasuar me vitet paraprake, kur ritmi i rritjes së depozitave ishte ngadalësuar. Rritjes së depozitave, ndër tjerash, ka mund t'i ketë kontribuar edhe ndërprerja e trendit rënës së normave të interesit në depozita që nga tremujori i dytë i vitit 2015.


Figura nr.9. Vlera e depozitave në sektorin bankar në Kosovë, ndryshimi vjetor



Struktura e gjithsej depozitave të sektorit dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.7 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 21.6 përqind janë kategoria e dytë për nga pesha në strukturë. Ndërsa, pjesa tjetër prej 5.7 përqind përbëhet nga depozitat e tjera (depozitat e jorezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale). Sa i përket ecurisë së depozitave, ritmi i rritjes së gjithsej depozitave më së shumti diktohet nga depozitat e ekonomive familjare si kategoria dominuese. Në vitin 2015, depozitat e ekonomive familjare regjistruan normë vjetore të rritjes prej 6.3 përqind (4.1 përqind në vitin 2014). Rritje shënuan edhe depozitat e ndërmarrjeve që në vitin 2015 ishin për 4.2 përqind krahasuar me

vitin 2014 (ritje vjetore prej 0.7 përqind në vitin 2014). Depozitat tjera (depozitat e jorezidentëve, organizatave jo-qeveritare, qeveritë qendrore dhe lokale, etj.) gjithashtu u karakterizuan me ritje të përshpejtuar, duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 19.0 përqind në vitin 2015 (9.4 përqind në vitin 2014), si rrjedhojë e rritjes së theksuar të depozitave të jorezidentëve në bankat që operojnë në Kosovë.

Figura nr.10. Stuktura e depozitave, në përqindje





Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara krahasuar me vitet paraprake. Depozitat e afatizuara vazhdojnë të ngushtojnë pjesëmarrjen në strukturë me një ritëm të theksuar që nga viti 2013, që mund të jetë si rezultat i rënies së normave e interesit gjatë asaj periudhe. Në vitin 2015, depozitat e afatizuara ngushtuan pjesëmarrjen në 24.7 përqind të gjithsej depozitave (nga 31.7 përqind në vitin 2014), përderisa depozitat e transferueshme zgjeruan pjesëmarrjen në 54.7 përqind (47.2 përqind në vitin 2014). Kategoria e mbetur, ajo e depozitave të kursimit, në vitin 2015 lehtësisht ka zvogëluar pjesëmarrjen në 20.6 përqind të gjithsej depozitave (nga 21.1 përqind në vitin 2014)

Figura nr.11. Struktura e depozitave sipas

Figura nr.12. Depozitat e afatizuara

afatit të maturimit




Edhe pse gjithsej depozitat e afatizuara janë karakterizuar me rënie, në kuadër të strukturës së tyre vërehet një zhvendosje e theksuar drejt afateve më të gjata të maturimit. Depozitat me afat të gjatë maturimi ‘mbi 2 vite’ dhe ato afatmesme ‘mbi 1 deri në 2 vite’ kanë rritur pjesëmarrjen në strukturë, ndërsa depozitat afatshkurta ‘deri 1 vit’ kanë zvogëluar pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave të afatizuara (figura 12). Këto lëvizje janë konform lëvizjeve të normave të interesit, të cilat mbesin më të larta në depozitat me maturitet më të gjatë.

4.1.2.4. Performanca dhe rreziqet sektorit bankar në Kosovë

Profiti i realizuar nga sektori bankar në vitin 2015 arriti vlerën prej 94.7 milionë euro (60.5 milionë euro në vitin 2014), që paraqet shumën më të lartë të profitit të regjistruar që nga fillimi i funksionimit të këtij sektori (figura 13). Rritja e profitit gjatë këtij viti rezultoi nga zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve të sektorit bankar.

Figura nr.13. Performanca financiare e sektorit bankar, në milion euro




Në vitin 2015, të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën 238.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind (figura 13). Kontributin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave kishin të hyrat nga interesi që në vitin 2015 shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind. Rënia e të hyrave nga interesi në masë të madhe i atribuohet zvogëlimit të të hyrave nga interesi në kredi kryesisht si rrjedhojë e rënies së normave të interesit, pavarësisht përshpejtimit të aktivitetit kreditor gjatë kësaj periudhe. Të hyrat nga jo-interesi në vitin 2015 shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet, që ndër tjerash reflekton shtrenjtimin e shërbimeve të ofruara në degët bankare. Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në vitin 2015 arriti në 143.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 22.3 përqind (figura 13). Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve në masë të madhe ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve të jo-interesit, që shënuan rënie vjetore prej 88.6 përqind. Në kuadër të tyre, rënie më të theksuar shënuan shpenzimet për provizione në kredi të cilat regjistruan rënie vjetore prej 141.1 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të kredive joperformuese. Gjithashtu, në rënien e gjithsej shpenzimeve ndikim të konsiderueshëm kishin edhe shpenzimet e interesit që shënuan rënie vjetore prej 48.7 përqind, kryesisht si rezultat i rënies për 54.0 përqind të shpenzimeve të interesit në

depozita. Pavarësisht rritjes së lehtë të normave të interesit në depozita gjatë pjesës më të madhe të vitit 2015, ulja e theksuar e tyre gjatë dy viteve të fundit u reflektua në rënien e shpenzimeve në vitin 2015. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, ishin e vetmja kategori e cila shënoi rritje, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 5.2 përqind në vitin 2015. Kjo rritje kryesisht i atribuohet shpenzimeve tjera nga jo interesi (marketingut, shpenzimeve ligjore, shpenzimeve të pashpalosura etj.), ndërsa në një shkallë më të ulët i atribuohet edhe rritjes së shpenzimeve të personelit. Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i rënies së theksuar të shpenzimeve. Në vitin 2015, ky indikator u përmirësua në 60.3 përqind, krahasuar me 75.3 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Profiti i realizuar në vitin 2015 ka ndikuar në përmirësimin e mëtutjeshëm të indikatorëve të profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA arriti në 2.9 përqind, nga 2.0 përqind sa ishte në 2014, derisa ROAE arriti në 26.4 përqind, nga 20.3 përqind sa ishte në 2014 (figura 14).

Figura nr.14. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës mbeten në nivel të ulët edhe në vitin 2015. Për më tepër, sektori bankar regjistroi rënie të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor dhe solvencës.


Tabela nr.10. Indikatorët e rreziqeve të sektorit bankar

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Treguesi i njafueshmërisë së kapitalit (TMK)	14.2%	16.7%	17.8%	19.0%
Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%
Mbuleshmëria e KJP-ve me provizione	112.6%	110.6%	114.4%	115.1%
Raporti kredidepozitë	77.4%	73.7%	74.2%	74.8%
Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtera	40.8%	48.0%	43.6%	44.9%
Raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	93.4%	129.7%	97.1%	67.1%

Burimi: BQK (2016)

Në vitin 2015, raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive zbriti në 6.2 përqind nga 8.3 përqind sa ishte në vitin 2014. Kjo rënie ishte rezultat i zvogëlimit të vlerës së kredive joperformuese, si dhe rritjes së përsheptuar të stokut të kredive gjatë vitit 2015 (tabela 10). Kosova vazhdon të jetë vendi me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor krahasuar me vendet e tjera të rajonit, të cilat kanë një mesatare të raportit të KJP-ve ndaj gjithsej kredive prej rreth 16 përqind.


Grafiku nr.11. Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në Kosovë dhe vendet e rajonit, 2015



Burimi: FMN, Bankat Qendrore të vendeve përkatëse (2016)

Për më tepër, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë në vitin 2015 është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione në vitin 2015 është rritur në 115.1 përqind nga 114.4 përqind në vitin 2014. Sektori bankar gjithashtu u karakterizua me rënie të trendit të koncentrimit të rrezikut kreditor. Shkalla e ekspozimit kreditor në sektorin bankar, që matet si raport i vlerës së gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, në vitin 2015, u zvogëlua në 67.1 përqind nga 97.1 përqind në vitin 2014. Rënia i atribuohet kryesisht rritjes së theksuar të kapitalit të klasit të parë si rrjedhojë e rritjes së lartë të profitit të realizuar gjatë vitit 2015 mirëpo kontribut kishte edhe rënia e vlerës së ekspozimeve të mëdha. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit vazhdon të mbetet i ulët përkundër rritjes së përshpejtuar të kreditimit, kryesisht rezultat i rritjes së përshpejtuar të depozitave. Në vitin 2015, raporti i kredive ndaj depozitave shënoi rritje të lehtë në 74.8 përqind nga 74.2 përqind në vitin 2014 si rezultat i rritjes më të lartë vjetore të kredive në krahasim me rritjen e depozitave. Rritja e përshpejtuar e depozitave ka ndikuar në rritjen e lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra, që mbetet mjaft mbi nivelin minimal të përcaktuar me kërkesat rregullatore. Raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtra u rrit në 44.9 përqind në vitin 2015 krahasuar me 43.6 përqind në vitin 2014, dhe vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore.

Grafiku nr.12. Treguesi i mjaftueshmërisë së Kapitalit në sektorin bankar në Kosovë dhe vendet e rajonit, 2015



Kapitali i sektorit bankar shënoi rritje gjatë vitit 2015 si rrjedhojë e rritjes së fitimit neto, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Në vitin 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, që paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe asetëve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 19.0 përqind krahasuar me 17.8 përqind sa ishte një vit më parë. Krahasuar me shtetet tjera të rajonit, Kosova vazhdon të jetë në mesin e shteteve me shkallën më të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (grafiku 12). Në vitin 2015, shkalla mesatare e këtij treguesi në shtetet tjera të rajonit ishte 16.8 përqind. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit (91.5 përqind e gjithsej kredive përkatësisht 100.0 përqind e depozitave) si dhe për faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutën euro (99.7 përqind në vitin 2015) dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Edhe gjatë vitit 2015, sektori bankar ka vazhduar në zhvillimin e kanaleve elektronike të ofrimit të

shërbimeve të klientëve me një shkallë të lartë të automatizimit në njërën anë, e cila është e shoqëruar edhe me një shkallë në rritje të ekspozimit të tyre ndaj rrezikut operacional. Sidoqoftë, bankat janë treguar aktive në ndërmarrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të BQK-së, të cilat kanë për qëllim sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat rregullative dhe uljen e rrezikut operacional në sektorin bankar.

4.1.3. Normat e interesit dhe marzhi neto i tyre


Normat e interesit kanë fuqinë të ndikojnë jetët e njerëzve: sa dëshirë kanë njerëzit të kursejnë dhe sa interes kanë bizneset të investojnë? Duke ndikuar vendimet ekonomike që personat e ndryshëm ndërmarrin, ato shërbejnë si faktor përcaktues për investimet në nivelin e përgjithshëm të ekonomisë. Kur normat e interesit ulen, investimet rriten, si rezultat i uljes së kostos së huamarrjes. Në këtë rast, njerëzit nxitojnë të blejnë një shtëpi, një makinë, dhe në këtë mënyrë ata ndihen më optimistë për të ardhmen. Edhe pse njerëzit kanë një marrëdhënie të tillë me normat e interesit, jo gjithmonë ata kanë njohuritë e duhura rreth asaj çfarë përfaqësojnë ato, ose si janë të lidhura norma të ndryshme me njëra-tjetrën. Norma e interesit është një çmim, dhe si çdo çmim tjetër ajo lidhet me një shkëmbim ose transfertë të një malli apo shërbimi ndërmjet një blerësi dhe një shitësi.

Ky lloj i veçantë shkëmbimi është një hua ose kredi, e cila përfshin një huadhënës dhe një huamarrës. Në rastin e një kredie, huamarrësi merr një shumë parash për t'i përdorur për një periudhë kohe të caktuar, ndërsa huadhënësi merr premtimin e huamarrësit se këtë borxh do ta shlyejë në të ardhmen. Huamarrësi ka përparësinë e përdorimit të menjëhershëm të fondeve që merr, ndërsa huadhënësi i dorëzon këto fonde duke hequr

përkohësisht dorë nga përdorimi i tyre. Për shkak se këta huadhënës sakrifikojnë përdorimin e menjëhershëm të fondeve, ata kërkojnë një kompensim shtesë përveç shumës së parave të dhëna borxh. Ky kompensim quhet interes ose ndryshe, çmimi që një huamarrës paguan për vënien në përdorim të fondeve të huadhënësit. E shprehur më thjesht, normat e interesit janë çmimi i huamarrjes.

Normat e interesit po luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Për momemntin konsiderohen relativisht të larta në Kosovë. Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur normat e interesit në Kosovë dhe vendet e rajonit, sipas FMN-së dhe Bankave Qendrore të vendeve përkatëse.

Grafiku nr.13. Normat e interesit në Kosovë dhe vendet e rajonit



Grafiku nr.13, tregon se normat e interesit në Kosovë, si ato në kredi ashtu edhe ato në depozita, kanë konvergjuar me normat e aplikuara nga vendet tjera të rajonit.

Në vitin 2015, norma e interesit për kredi në Kosovë ishte më e ulët se sa në Shqipëri dhe Mal të Zi, ndërsa ishte më e lartë se sa norma e interesit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni. Për sa i përket depozitave, Kosova dhe Mali i i Zi kishin normat më të ulëta të

interesit në mesin e vendeve të rajonit. Normat e interesit për Serbinë nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së të dhënave të krahasueshme me vendet tjera.

Kriza të shpeshta kanë çuar në debatin për një rritje të normave të interesit në të gjithë botën. Prandaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet luhatjes në normat e interesit. Gjatë dekadës së fundit, normat e interesit të depozitave kanë rënë më shumë se ato të kredive; Kjo tregon që bankat kanë likuiditet të mjaftueshëm. Megjithatë rregullimi dhe procedurat gjyqësore të përshpejtuara, marrja e pengut kolateral dhe identifikimi i faktorit në reduktimin e normës së interesit për huatë mund të kenë ndikim në një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik.

4.1.3.1. Normat e interesit të depozitave dhe kredive

Në tabelën numër 11, është paraqitur mesatarja e normave të interesit për depozitat. Analiza është bërë për dy kategori kryesore të depozitave në bankat komerciale në Kosovë, që është: depozitat jofinanciare të korporatave dhe depozitat e individëve. Depozitat e korporatave jofinanciare mund të jenë të transferueshme, depozita të tjera dhe depozita kursimi. Depozitat e tjera mund të jenë më të vogla se 250,000 € dhe më shumë se 250,000 €, të cilat mund të depozitohen për një muaj, një deri në tre muaj dhe gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj. Klasifikimi është gjithashtu i njëjtë për depozitat e ekonomive familjare, të cilat depozitat e tjera megjithatë mund të depozitohen brenda dymbëdhjetë e njëzet e katër muajve dhe më shumë se njëzet muaj. Norma mesatare më e lartë e interesit të depozitave në bankat komerciale në Kosovë ishte 4.3 për qind në vitin 2009 dhe më e ulët është 0.9 për qind në vitin 2016.

Ndërsa, në tabelën numër 12, ju mund të shihni mesataren e normave të interesit për kreditë. Gjithashtu, dy kategori kryesore të kredive në bankat tregtare në Kosovë, janë: huatë jofinanciare të korporatave dhe kreditë e individëve. Kreditë e korporatave jofinanciare mund të jenë duke investuar hua, kredi jo-investuese, mbitërheqje, linja kreditore dhe mbuluar hua me depozita. Huaja e investimit ka maturim për këto periudha: një vit, një deri në pesë vjet dhe mbi pesë vjet. Ndërsa kredia jo-investuese ka një periudhë shumë të gjatë të maturimit: një vit dhe një deri në pesë vjet. Klasifikimi i kredive për individë është: Mbitërheqja, mbulimi i kredive me depozita, kreditë konsumatore dhe kreditë hipotekare. Maturimi i kredive hipotekare është një deri në pesë vjet dhe mbi pesë vjet. Norma mesatare më e lartë e interesit të kredive në bankat komerciale në Kosovë ishte 15.0 për qind në vitin 2004 dhe më e ulët është 7.8 për qind në vitin 2016.

Për më detalisht, sa i përket normave të interesit për vitet e tjera, mund të shihen në tabelën e paraqitur më poshtë. Luhatëshmëria e tyre, tendenca e lëvizjes dhe krahasimi përmes trendit të periudhës 2007-2016, do të paraqitet në vijim.

Tabela nr. 11. Norma efektive e interesit të depozitave, në përqindje ⁴

Vitet	Norma e interesit depozitave	Korporatat jo financiare								Ekonomite familjare						
		Depozitat e transferueshme /1	Depozitat tjera						Depozitat e kursimit	Depozitat e transferueshme /1	Depozitat tjera					Depozitat e kursimit
			>250.000€			<=250.000€					1 muaj	1-3 muaj	6-12 muaj	12-24 muaj	<24 muaj	
			1 muaj	1-3 muaj	6-12 muaj	1 muaj	1-3 muaj	6-12 muaj								
2004	2.8	0.1	1.7	2.3	.9	.3	-	-	.6	-	1.6	2.1	2.8	3.8	4.0	.7
2005	2.9	0.1	1.8	2.2	2.9	2.7	2.5	-	1.	-	1.7	2.2	3.0	3.9	4.1	1.7
2006	3.0	0.4	1.9	2.4	3.7	3.0	3.0	-	1.6	-	1.9	2.3	3.2	4.2	4.4	1.7
2007	3.3	0.4	2.2	2.7	3.6	3.8	3.9	-	1.9	-	2.1	2.5	3.3	4.2	4.5	2.0
2008	4.2	0.5	2.8	3.5	4.4	4.0	4.8	-	2.7	0.1	2.9	3.4	4.2	4.7	5.1	2.4
2009	4.3	0.8	3.1	3.7	5.0	3.9	4.5	-	2.9	0.2	3.2	3.5	4.4	4.8	5.4	2.5
2010	3.7	1.1	2.8	3.1	5.0	3.1	3.5	5.4	2.4	0.3	2.8	2.9	4.4	4.6	5.3	2.3
2011	3.5	1.0	2.2	3.0	4.7	2.4	3.7	5.2	2.2	0.4	2.5	2.6	4.2	4.5	5.1	2.0
2012	3.6	0.9	2.2	2.8	4.7	1.8	3.9	4.7	2.1	0.5	2.4	2.5	4.2	4.5	5.2	2.0
2013	3.4	0.7	1.1	2.0	3.1	1.7	3.5	4.3	2.0	0.6	2.1	2.3	3.7	4.3	4.5	1.5
2014	1.1	0.2	0.5	0.8	1.41	0.6	-	1.35	0.8	0.1	0.5	0.6	1.0	1.2	1.9	0.7
2015	0.9	0.08	0.6	1.0	0.9	-	0.3	0.9	0.1	0.01	0.3	0.6	0.6	0.9	1.9	0.3
2016	0.9	0.04	0.5	0.5	1.2	-	0.3	1.4	0.1	0.01	0.5	0.5	0.7	1.0	2.0	0.2

Burimi: BQK (2017)

⁴ Shënim: informata më të detajuara për këtë tabelë gjenden në linkun:

http://www.bqkkos.org/repository/docs/time_series/13%20ODC%20effective%20interest%20rates%20on%20loans.xls

Tabela nr. 12. Norma efektive e interesit të kredive, në përqindje


Vitet	Norma e interesit të kredive	Korporatat jo financiare								Ekonomite familjare				
		Kredite investuese			Kredite jo investuese		Mbiterheqjet/1	Linjat kreditore/1	Cover loans ëith deposit/1	Mbiterheqjet/1	Cover loans ëith deposit/1	Kredite konsumuese	Kredite hipotekare	
		1 vit	1-5 vit	< 5 vite	1 vit	1-5 vite							1-5 vite	<5 vite
2004	15.0	15.4	14.9	14.9	15.0	15.0	15.3	12.8	-	-	-	12.8	-	-
2005	14.9	16.3	14.3	14.3	14.7	15.2	15.3	12.4	-	-	-	12.4	-	-
2006	14.7	16.4	14.4	14.4	15.4	15.0	15.4	12.5	-	-	-	12.5	13.4	-
2007	14.6	-	14.8	14.8	15.2	15.2	14.8	13.0	-	-	-	13.0	12.2	-
2008	14.7	21.1	15.0	15.0	16.6	15.3	13.9	14.1	-	19.2	-	14.1	11.2	9.5
2009	14.3	16.6	14.6	14.6	14.0	15.6	14.6	14.6	-	17.7	-	13.1	10.6	10.0
2010	14.6	18.0	14.9	11.5	18.2	16.5	12.4	13.5	6.7	21.9	6.8	13.8	12.1	10.7
2011	14.1	16.3	14.1	12.3	18.1	16.2	12.1	13.2	6.4	18.9	6.4	13.6	11.9	10.6
2012	13.4	14.9	12.9	10.9	16.3	14.7	11.0	12.1	6.6	16.3	6.8	13.5	11.4	10.1
2013	12.4	13.4	12.2	10.4	14.5	13.6	10.2	11.9	6.0	15.5	6.3	12.2	10.9	9.6
2014	10.6	11.6	10.5	10.0	11.8	11.0	9.3	11.3	5.5	13.6	3.9	10.9	9.4	9.1
2015	8.3	9.2	8.4	7.3	9.0	8.0	7.9	9.5	2.9	13.1	5.1	9.0	7.5	7.4
2016	7.8	7.5	7.3	6.3	7.1	6.6	7.1	8.7	2.9	13.2	5.1	8.6	7.1	7.0

Burimi: BQK (2017)

4.1.3.2. Variancat dhe tendecat e normave të interesit


Rëndësia e normave të interesit në ekonominë e një vendi është folur nga shumë autorë. Grafiku i mëposhtëm paraqet ndryshimin e normave të interesit të depozitave dhe kredive për trembëdhjetë vitet e fundit në bankat komerciale në Kosovë. Në grafikun nr. 14, mund të shihet se norma më e lartë mesatare e interesit të depozitave në bankat komerciale në Kosovë është 4.3 për qind në vitin 2009 dhe më e ulëta është 0.9 për qind në vitin 2016. Në të kundërt, mund të shihni se norma mesatare e interesit më të lartë të kredive në tregun e bankave në Kosovë është 15.0 për qind në vitin 2004 dhe më e ulëta është 7.8 për qind në vitin 2016.

Grafiku nr.14. Variancat e normave të interesit për sektorin bankar në Kosovë



Duke i krahasuar dhe analizuar këto të dhëna, në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e trendit prej vitit ne vit.

Grafiku nr. 15: Tendencat e normave të interesit (2004-2016)



Trendi i normës mesatare të interesit të kreidve dhe depozitave sqarohet në grafikun me nr.15. Vërehet qartë se trendi i depozitave ka pësuar një rënie drastike në vitet e fundit, kjo si pasojë e likuiditetit të tepruar që kanë bankat tona.

Norma mesatare e interesit të kredive ka vazhduar poashtu një trend rënës, por krahasuar me vendet në zhvillim, akoma konsiderohen këto norma të larta.

Prandaj, duke u bazuar në këtë ecuri dymbëdhjetëvjeçare, mund të themi se sektori bankar në Kosovë, duhet vazhduar me trendit rënës të normave të interesit të kredive ndërsa duhet t'i ngrisin pak normat e interesit të kredive, për arsye që të paktën klientët të kanë një motiv që të janë pjesë e bankës përkatëse.

4.1.3.3. Marzhi neto i normave të interesit

Nga literatura e mësipërme e dim se marzhi neto i normave të interesit është si rezultat i zbritjes së të hyrave nga interesi dhe shpenzimeve nga interesi.

$$\text{NIM} = \text{Të hyrat nga interesi} - \text{Shpenzimet nga interesi}$$

Poashtu e dijmë se ekzistojnë dy mënyra të matjes së marzhit neto të interesave: ex-ante dhe ex-post. Sipas mënyres ex-ante, marzhi neto i interesave llogaritet si diferencë e normave të interesit të kredive dhe depozitave që bankat specifikojnë në kontratë që në fillim. Ndërsa, sipas mënyres ex-post, marzhi neto i interesave llogaritet si diferencë e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit që banka ka realizuar gjatë periudhës përkatëse. Diferenca midis dy marzheve lidhet me nivelin e kredive me probleme.

Mënyra më e përdorur është ex-post, për arsye se të dhënat mirren të sakëta ndërsa të mënyra ex-ante, të dhënat mund të jenë jokonsistente për arsye se mirren nga disa burime. Në tabelën nr.13, është paraqitur marzhi neto i interesave për sektorin bankar në Kosovë për periudhën 2001-2016.

Llogaritja e marzhit neto të interesit është bërë sipas mënyrës ex-post, sipas formulës së paraqitur më lartë. Të dhënat janë marrë nga Banka Qendrore e Kosovës, përkatësisht linku i statistikave. Të dhënat ishin paraqitur në periudha mujore, mirëpo janë llogaritur edhe kalkuluar nga autori në periudhë vjetore, kështu duke i paraqitur vit për vit dhe duke e nxjerrur NIM-in për vitin përkatës.

Për më detalisht lidhur më NIM-in nëpër vite mund të shihni tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.13. Marzhi neto i interesit të sektorit bankar në Kosovë (2001-2016)

Vitet	Të hyrat nga interesi	Shpenzimet nga interesi	NIM expost
2001	38.7	6.1	32.6
2002	102.0	24.2	77.8
2003	180.9	28.6	152.3
2004	329.4	58.0	271.4
2005	448.1	94.7	353.4
2006	558.9	121.9	437.0
2007	718.6	161.7	556.9
2008	963.8	232.7	731.1
2009	1,045.8	329.9	715.9
2010	1,118.4	368.7	749.7
2011	1,235.1	369.5	865.6
2012	1,298.7	401.6	897.1
2013	1,276.5	415.2	861.3
2014	1,252.0	315.6	936.4
2015	1,217.8	153.9	1,063.9
2016	1,160.7	119.8	1,040.9

Burimi: BQK, llogaritje të autores. Vlerat janë në milion.


Nëse e shikojmë tabelën, shofim se të hyrat nga interesi të sektorit bankar kanë pasur rritje të vazhdueshme prej vitit 2001 në vlerë prej 38.7 deri në vitin 2012 prej 1,298.7, ndërsa prej vitit 2013 vlera e tyre filloi të bie në 1,276.5, e kjo rënie e të hyrave nga interesi vazhdoi deri në vitin 2016 në vlerë prej 1,160.7. Në anën tjetër kemi rritje të NIM-it, kjo përshkak se në të njëjten periudhë, pra në vitin 2014 shohim se kemi zvogëlim të shpenzimeve nga interesi në vlerë prej 315.6, nga 415.2 sa ishte në vitin 2013.

Vlera e shpenzimeve nga interesi vazhdoi të bie, deri në vitin 2016, vlera e saj u zvogëluar në 119.8. Nga kjo shohim se te bankat komerciale në Kosovë, përveç që u zvogëluar të hyrat nga interesi, u zvogëluar edhe shpenzimet, mirëpo NIM-i, apo fitimet e bankave

vazhduan të mbesin në rritje e sipër. Vlera e NIM-it në vitin 2001 ishte 32.6 dhe vlera e saj u rrit deri në 1,040.9 në vitin 2016.


Me këtë nënkuptohet se janë zvogëluar të ardhurat nga interesi apo norma e interesit të kredive dhe në anën tjetër janë zvogëluar shpenzimet e interesit apo norma e interesit të depozitave. Që të shihet më qartë, në vijim paraqitet grafiku i të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi për vitet 2001-2016.

Grafiku nr. 16. Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi për sektorin bankar në Kosovë



Shihet qartë lëvizshmëritë e tyre nga viti 2001 deri në vitin 2016. Rënia e tyre vërehet gjatë viteve të fundit. Më poshtë do të paraqitet edhe grafiku për NIM-in si varibaël i vaurur i këtij studimi, me qëllim që të shihet lëvizshmëria e tij nëpër vitet e hulumtuara.

Grafiku nr. 17. NIM-i në Kosovë (2001-2016)



Nga ky grafik vërehet se kemi rënie të lehte në vitin 2009 dhe në vitin 2013, kurse lartësinë më të madhe NIM-i e arrin në vitin 2015.

4.2. Përmbledhje e kapitullit

Ky studim synon të analizojë sistemin bankar në Kosovë, duke përcaktuar dhe më pas analizuar: strukturën e tij, shkallën e përqendrimit të bankave komerciale në tregun bankar, sjelljen e tyre ndaj çmimit të kredisë dhe depozitave, numri i pjesëmarrësve /bankat që operojnë në këtë treg, llojet e produkteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë, me qëllim vlerësimin e nivelit të konkurrencës të këtij sektori, në zbatim të së drejtës së konkurrencës. Në fund paraqiten normat e interesit të kredive dhe depozitave duke i pasqyruar sipas variancës dhe tendecës së tyre. Poashtu, paraqiten të hyrat dhe shpenzimet nga interesi duke i kalkuluar dhe paraqitur marzhin neto të interesit të sektorit bankar në Kosovë.

KAPITULLI V: METODOLOGJIA

5.1. Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik

Kuadri teorik mbi normat e interesit ka qene me se i mjaftueshem. Një pjesë e mirë e saj është përfshirë në kuadër të këtij punimi, te cilat janë paraqitur te pjesa e studimit empirik ne funksion te pyetjeve kerkimore dhe hipotezave baze. Punimi synon të jap përgjigje në disa pyetje kërkimore mbi marzhet neto të normave të interesit të bankave komerciale në disa nga vendet e Ballkanit. Kuadri teorik u ndërtua në tre faza. Faza e parë identifikimi i teorive, faktorëve dhe rezultateve empirike të studiuesëve tjerë. Faza e dytë analizimi dhe krahasimi i literaturës së identifikuar dhe faza e tretë paraqitja dhe harmonizimi i faktorëve me ekonomite e vendeve te Ballkanit. Për realizimin e këtij punimi është shfrytëzuar literatura e huaj dhe vendore. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë faktorët influencues në marzhet e normave të interesit, dhe të tregojë marrdhënien e tyre kundrejt këtij treguesi. Sipas kuadrit teorik marzhi neto i normave te interesit ndikohet nga karakteristikat bankar, të tregut dhe makroekonomik. Në kuadër të karakterisitkave bankare hyjnë: *Performanca e portfoliosë*, e cila matet nga raporti i kredive ndaj mjeteve totale. (Clayes, 2007). *Qëndrimi ndaj rrezikut*, që paraqet raportin e kapitalit me totalin e mjeteve. (Maudos dhe Fernández deGuevara, 2004; Angbazo, 1997; Saunders dhe Schumacher, 2000; Drakos, 2002, Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sologoub, 2006). *Rreziku i likuiditetit* përcaktohet nga aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve. (Angbazo, 1997; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). *Rreziku i kredise* që paraqet raportin e kredive me probleme ndaj totalit të bruto kredive. (Drakos, 2002, Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004).

Shpenzimet operative te llogaritura në raport me totalin e mjeteve. (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999, Abreu dhe Mendes, 2003, Demirgüç-Kunt dhe të tjerët, 2004; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007). *Madhësia e bankave* e llogaritur sipas madhësisë së aseteve. (Naceur, 2003; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Gual, 1999) *Pronësia* e bankave paraqet variablin e fundit në kuadër të karakteristikave bankare; (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sapienza, 2002). Përveç analizes të kuadrit teorik të karakteristikave bankare, kemi edhe karakteristikat e tregut dhe makroekonomik. Ne kuadër të karakteristikave të tregut kemi variablin *struktura e tregut* e shprehur përmes HHI-së, e vlerësuar kështu nga shumë autore të ndryshëm. (Berger, 1995b; Carbo dhe Rodriguez, 2007; Demsetz, 1973; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). Kurse në kuadër të karakteristikave makroekonomikë kemi PBB-në (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999 dhe Demirgüç-Kunt et al., 2004 ; Brock dhe Suarez, 2000; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Vein, Carbo dhe Rodriguez, 2007; Drakos, 2002). Duke i analizuar dhe nxjerrur te dhënat konkrete për vendet e Ballkanit përmes modelit të ndërmjetësimit (Ho dhe Saunders, 1986), ngritëm pyetjet kërkimore dhe hipotezat, të cilat u testuan, kështu duke arritur te rezultatet dhe konkludimet përfundimtare.

5.2. Burimet e informacionit

Investigimi i këtij studimi është bërë për bankat e nivelit të dytë përkatesisht për bankat komerciale të vendeve te Ballkanit, si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Serbia. Të dhënat i përkasin periudhës 2007-2013. Të dhënat janë marrë

nga Banscope dhe raportet vjetore të bankave qendrore të ketyre vendeve. Gjithashtu, ky studim përdor hulumtime të rëndësishme të Bankës botërore, FMN-së, Bankës Evropiane, dhe hulumtuesëve tjerë të kësaj lëmie e që janë paraqitur ne punim. Duke rikujtuar se ky studim mbështetet në 4 pyetje kërkimore dhe 4 hipoteza:

Ky punim ka një interes të veçantë për rolin dhe influencën mbi marzhin neto të normave interesit, dhe do të tentojë tu jap përgjigje disa pyetjeve. Ky studim mbështetet në 4 pyetje kërkimore dhe 4 hipoteza:

Pyetja qendrore e punimit është: Pse, biznese dhe individë në vende si Kosova i perceptojnë si tejet të larta normat e interesit të kredive bankare, në të njëjtën kohë kur normat e interesit të depozitave perceptohen si mjaft të ulta?

Pyetjet sekondare të punimit janë:

- Cilat janë efektet tek marzhet neto të normave të interesit e faktorëve të tillë të rrezikut si raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuar me rrezikun, shpenzimet operative, raporti kredi/mjetet totale, raporti kredi jo performuese/kredi bruto, si edhe raporti mjete likuide/mjetet totale?
- Pasi kontrollojmë për faktorët e tjerë, kush ndikon me shumë në rritjen e marzhit neto të normave të interesit: bankat me pronësi të huaj apo bankat me pronësi vendore?
- A është shkalla relativisht mesatare e konkurrencës në sistemin bankar një nga faktorët e rritjes së marzhit të normave të interesit?

Në formulimin e hipotezës kryesore ne nisemi nga dy fakte:

Së pari, ka vite që në vende si Kosova niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit bankar (dmth. raporti i kapitalit rregullator ndaj mjeteve të peshuara me rrezikun) është mjaft më i lartë se niveli minimal i kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Kështu në vitin 2015, niveli faktik i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte mesatarisht 19% kundrejt një niveli minimal të kërkuar prej 12%;

Së dyti, janë të njohura perceptimet e biznesit dhe individëve se normat e interesit të kredive bankare janë tejet të larta, ndërsa ato të depozitave bankare mjaft të ulta.

Teoria na mëson se përcaktimi i niveli të duhur të kapitalit nga ana e bankave është ushtrim mjaft i rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut. Një nivel i lartë kapitali e mbron bankën nga falimenti në rast humbjesh tejet të mëdha e të papritura. Por, nga ana tjetër, për gjëra të tjera të pandryshuara një nivel më i lartë se ç’duhet i kapitalit rëndon në fitimet e bankës. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me kosto që vijnë nga siguria më e lartë se ç’duhet.

Ne mendojmë se në vende si Kosova, një pjesë e “kostos së sigurisë” që vjen nga niveli më i lartë i kapitalit kundrejt atij minimal të kërkuar, bankat ua përcjellin bizneseve dhe individëve që marrin kredi e hapin depozita. Nëse ky mendim do të ishte i bazuar atëhere do të duhej të kishte një lidhje të fortë pozitive midis nivelit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe marzhit neto të interesit.

Pra, mbajtja e kapitalit relativisht të lartë është një mjet për bankat që të sinjalizojnë siguri të lartë në aftësinë paguese dhe aftësinë kreditore dhe të frymëzojnë besimin e depozituesëve, veçanërisht në vendet e Ballkanit.

Hipoteza bazë e këtij punimi është: Në vende si Kosova, një nivel mjaft më i lartë i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit bankar, relativisht nivelit minimal të kërkuar nga banka qendrore, siguron qëndrueshmërinë e bankave në rast humbjesh të mëdha e të papritura, nga njëra anë, por është edhe faktori kryesor në rritjen e marzhit neto të interesit, nga ana tjetër.

Hipoteza 2: Efektet e performancës së portfolios, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit i bashkëngjiten efektit të kapitalit në rritjen e marzheve neto të normave të interesit.

Hipoteza 3: Bankat e mëdha me pronësi të huaj kanë marzhe më të larta në kahsim me bankat e vogla me pronësi vendore.

Hipoteza 4: Rritja e konkurrencës bankare ndikon në uljen e marzhit neto të normës së interesit.

Si, burime parësore të informacionit për testimin e këtyre hipotezave janë: Të dhënat e mbledhura nga pasqyrat financiare dhe bilanci i gjendjes të gjithsej 116 bankave komerciale të 5 vendeve të Ballkanit. Këto të dhëna janë marrur nga Bankscope dhe në mungesë të të disa të dhënave janë plotësuar nga autori i punimit, duke u bazuar në të dhënat e FMN-së, Bankës Botërore, Bankës Europiane, Bankave Qendrore dhe komerciale të shteteve në hulumtim. Ndërsa si burime dytësore të informacionit për testimin e këtyre hipotezave janë: Shfrytëzimi i literaturës egzistuese dhe studimeve të ndryshme, kryesisht të huaj mbi marzhin neto të normave të interesit.

5.3. Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit

Punimi ka karakter vlerësues. Metodatat që janë përdorur është ajo e analizës përshkruese, krahasuese dhe e regresionit. Të dhënat pasi që janë mbledhur, janë përpunuar nga autori në programin excel duke i bartur pastaj në programin STATA për vlerësim dhe nxjerrje rezultatesh. Modeli bazë i përdorur në literaturë për identifikimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të normave të interesave, është ai i ndërmjetësimit⁵, i përdorur për herë të parë nga Ho dhe Saunders (1981), sipas të cilit bankat shihen si ndërmjetës financiarë kundërshtarë të rrezikut. Më pas, autorë të tjerë kanë punuar mbi këtë model, duke paraqitur në studimet e tyre edhe përmirësime e përshtatje me gjendjen specifike të ekonomive ku është aplikuar. Debati empirik që pasoi sugjeroi dy qasje empirike për analizën e NIM-it, një qasje e vetme dhe dyfazore. Modeli i ndërmjetësimit i përdorur në këtë punim, është model dy fazësh, fillimisht është përdorur nga Ho & Saunders (1981), pastaj nga Saunders & Schumacher (2000). Avantazhi i këtij modeli është përcaktimi i marzhit të “paster”. (Schumacher, 2000) Sipas këtyre autoreve, në rastet kur bankat veprojnë në një treg me konkurrencë të lartë, prap marzhet e normave të interesit vazhdojnë të jenë pozitive. Kjo do të thotë që marzhet e normës së interesit nuk do të zhduken, pasi që pasiguria i shoqëron gjithmonë në transaksionet e kryera. Ky lloj marzhi i shkaktuar nga pasiguria, quhet marzh “i pastër”, i cili sipas modelit të ndërmjetësimit zbatohet në dy faza. Faza e parë, përcakton madhësinë e këtij marzhi përmes paraqitjes së efektit të variablave shpjegues që nuk janë shprehur në mënyrë eksplicite në modelin teorik dhe faza e dytë, analizon marrëdhënien në mes të marzhit “të paster” dhe variablave të paraqitura në modelin teorik. I njëjti model por në një fazë të vetme është aplikuar nga MsShane dhe Sharpe,

⁵ Dealer Model (Ho& Saunders, 1981)

Angbazo. (McShane, 1985) (Angbazo, 1997) , ku në shpjegimin e marzhit neto të interesit kanë përfshirë variablat e modelit teorik dhe variablate shtesë ose papërsosmëritë që pasqyrojnë aspekte të tjera dhe që nuk përfshihen në modelin e marzhit të pastër. Në punim është përdorur metoda e regresionit linear, panel data me qasjen dy fazësh. Poashtu në këtë punim, shqyrtohen karakteristikat e sipërmendura kështu duke i vlerësuar me modelet statike, dinamike dhe empirike.

5.4. Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre

Në këtë studim është përdorur informacion i marrë kryesisht nga Bankscope, bankat qendrore, FMN por edhe institucione të tjera ndërkombëtare. Të dhënat janë vjetore dhe për banka të veçanta përgjatë periudhës 2007-2013. Për rastin e bankave të sistemit bankar, vlerësimi i ekuacionit do të bëhet në Panel Data me metodën e efekteve njëpasnjëshme (Random effect), duke bërë të mundur kështu identifikimin e ndikimeve që mund të kenë karakteristikat specifike të çdo shteti. Testi Haouseman i dha më shumë hapësirë efektit të njëpasnjëshem se sa atij fiks për shkak të mos humbljes së lëvizmëshirës së shkallëve. Prandaj edhe hipotezat testohen me testin R^2 dhe Wald χ^2 e T-test, jo me testin Fisher si behet te efektet fikse. Numri total i observimeve të përdorura në studim është 812 dhe të dhënat janë të pabalancuara. Duke ndjekur edhe modelin e studimit të Maudos e Fernández de Guevara (2004), janë përdorur filtrime sipas dy kriterëve: së pari, për bankat e reja që janë krijuar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, janë hequr nga studimi të dhënat e vitit të parë të veprimtarisë, për të shmangur efektin e ndonjë vlere jonormale në të dhënat. Së dyti, edhe për bankat që kanë pësuar ndryshime strukturore gjatë periudhës së marrë në studim, janë eliminuar të dhënat.

Përmes analizës statistikore janë paraqitur variablat në tërësi: të varur dhe të pavarur. Kështu, duke bërë krahasime përmes mesatares aritmetike dhe devijimit standard. Fillimisht paraqitet analiza në mes të shteteve, pastaj paraqitet analiza e variablave në baze të pronësise së huaj dhe vendore. Përmes T-testit, testohet kjo variabël dhe fiton hipoteza 0. Me pas paraqitet mesatarja e variablave sipas trendit nëpër vite dhe krahasimi i tyre nëpër shtetet e Ballkanit.

Në baze të analizës së regresionit paraqitet modeli statik dhe dinamik. Modeli statik përfshin katër ekuacione. Ekuacioni i parë paraqet variablin e varur marzhi neto i normave të interesit (NIM) dhe të pavarur: performanca e portfolios (PP), qëndrueshmëria ndaj rrezikut (QR), rreziku i likuiditetit (LQ), rreziku i kredisë (CR), shpenzimet operative (OE) dhe madhësia e bankave (S). Ekuacionit të dytë i shtohet variabli i pavarur bruto produkti i brendshëm (PBB). Ekuacionit të tretë i shtohet variabli i pavarur struktura e tregut (HHI) dhe ekuacionit të katërtë i shtohet variabli i pavarur pronesia (O).

Poashtu Modeli dinamik i përfshin katër ekuacionet me të gjitha këto të dhëna mirëpo ndryshon sepse bëhet krahasimi i këtyre të dhënave me shtetet në hulumtim. Të gjitha variablat e përdorura në punim përmbajnë karakter sasior.

5.5. Përmbledhje e kapitullit

Ky kapitull shpjegon kuadrin teorik që është shfrytëzuar për këtë studim, metodologjinë, metodat dhe instrumentet e punimit. Poashtu shpjegohen burimet e informacionit duke i rikujtuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat në baze të studimit. Pjesa e fundit e këtij kapitulli shpejgon në mënyrë të detajuar përpunimin, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave përmes metodës së analizës statistikore përshkruese, krahasuese dhe regresionit.

KAPITULLI VI: ANALIZA EMPIRIKE

Shumë studime empirike janë realizuar për identifikimin e faktorëve përcaktues të marzhit neto të interesave, si për grup vendesh, ashtu edhe për ekonomi të veçanta; si për banka individuale ashtu edhe për të dhëna të agreguara në nivel sistemi. Sistemet bankare të ekonomive në proces liberalizimi dhe reformimi të sistemeve financiare, nuk janë në ekuilibër afatgjatë (Brock dhe Rojas-Suarez, 2000). Për këtë arsye, interpretimi i rezultateve të marra, duhet bërë me kujdes pasi ato nuk janë të drejtpërdrejta ashtu siç ndodh për ekonomitë e zhvilluara. Sistemet bankarë jo të konsoliduara janë të prirura për të ndërmarrë më shumë rrezik. Në këto sisteme, përgjigjja e normave të interesit të kredive dhe depozitave si dhe e marzhit të interesave, mund të jetë e ndryshme nga ajo që pritet dhe nga sa është provuar për sistemet e zhvilluara. Në këtë seksion do të analizohen me metoda ekonometrike faktorët që mendohet se kanë ndikim në marzhin neto të interesave për bankat e vendeve të zhvillim.

6.1. Specifikimi i modelit

Modeli i ndërmjetësimit i Ho dhe Saunders (1981) vlerëson faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave duke ndjekur dy faza, por kërkon seri të gjata kohore. Më pas, autorë të tjerë (McShane dhe Sharpe 1985, Angbazo 1997 dhe Maudos e Fernández de Guevara 2004) kanë aplikuar modelin njëfazësh për përcaktimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave.


Meqenese, në rastin tonë i kemi të dhënat e pesë shteteve të zhvillim, aplikohet modeli dy fazësh për periudhën 2007-2013. Maudos e Fernández de Guevara (2004) e kanë matur fuqinë e bankave në treg një herë duke përdorur indeksin LER NER dhe herën tjetër atë të

Herfindahl-Hirschman, ndërsa në rastin tim është përdorur vetëm ky i fundit si pasojë e mungesës së të dhënave të nevojshme për llogaritjen e indeksit të parë.

Zërat e bilancit dhe pasqyres se te ardhurave të përfshirë në llogaritjen e variablave, janë llogaritur si vlera mesatare vjetore të marrë në shqyrtim.

Në modelin tim, do të përdoren 9 variabla shpjgues që mendohet se ndikojnë marzhin neto të interesave, nisur nga modeli teorik apo edhe studime empirike të të njëjtës natyrë.

Figura nr. 15. Skema konceptuale e studimit



Kështu, variablat e pavarur të përfshirë në studim janë:

- a) ***Performanca e portfoliosë (PP)*** - kap aftësinë e bankës në përputhjen me nevojat për depozita dhe shërbimet e kredisë. Matet nga raporti i kredive ndaj aktiveve totale (TA). Dihet se kreditë bankare janë burimi kryesor i të ardhurave, duke qenë kështu më të rrezikuarat dhe që kane rendimentin më të lartë (në terma të kthimit të pritshëm) midis aseteve të bankës, për këtë arsye duhet të krijohen kosto të larta operacionale për shërbimin dhe monitorimin e tyre. Gjëja tjetër e njetjete është se sa më shumë depozita transformohen në hua, aq më i lartë do të jete fitimi dhe NIM-i. Prandaj, një rritje në kredi mund të rezultojë në margjina më të larta dhe të reflektoj në aftësinë e bankave për të marrë në konsideratë rrezikun dhe koston e sjelljes së çmimeve të tyre të kredisë. Megjithatë, nëse një bankë ka nevojë për të rritur rrezikun që të ketë një raport më të lartë hua-pasuri, atëherë fitimet mund të ulen. Me këtë nenkuptojmë kur bankat kane rritje të shpejta të kredise dhe e kane të vështirë vlerësimin e cilësive të kredise. Dhe kështu vëllimi i madh i kredive të reja tenton të ulët dhe kredite me probleme të rriten. Për më tepër, zgjerimi i shpejtë i kredisë mund të sjellë standarde më të ulëta, në këtë mënyrë duke rezultuar në huadhënien e klientëve më pak të besueshëm. Gjetjet e Claëys dhe Vander Vennet (2007) tregojnë se raporti i kredive me asete totale është një signifikant e rëndësishme në shpjegimin e një pjese të konsiderueshme të margjinave të interesit dhe për disa vende mund të konsiderohet kryesisht si kompensim për marrjen e rrezikut.
- b) ***Qëndrimi ndaj rrezikut (QR)*** - Si një përafrues i mirë i qëndrimit që bankat shfaqin ndaj rrezikut, shërben raporti i kapitalit të vet me totalin e aktiveve. Shërben si një

tregues për rrezikun e falimentimit dhe vlerën e tregut të aktiveve (Maudos dhe Fernández deGuevara, 2004). Kapitali vepron si rrjet i sigurisë në rast të zhvillimeve të pafavorshme. Ne te vertet, rreziku nga falimentimi ndikon në të ardhurat e firmës nëpërmjet primeve të rrezikut që banka duhet të paguajë për të marrë fonde hua. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme në vendet në tranzicion për shkak të përqindjes së lartë të kredive joperformuese në portofolin e huave. Nga ana tjetër, pasi ekuiteti është një burim relativisht i shtrenjtë i financimit, një rritje e kapitalit në baza vullnetare ose si rezultat i rregullimit mund të rrisë koston mesatare të tij. (Angbazo, 1997, Saunders dhe Schumacher, 2000, Drakos, 2002, Martinez Peria dhe Mody, 2004). Dhe si rezultat, mund të kërkohej NIM më i lartë. (Saunders dhe Schumacher, 2000). Megjithatë, bankat me mjaftueshmëri të konsiderueshme të kapitalit po përballen me rrezik më të ulët të falimentimit duke ulur kështu kostot e tyre të financimit dhe janë në gjendje të kenë marzhe më të larta duke u ngarkuar me më shumë kredi apo të paguajnë më pak për depozitat (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sologoub, 2006). Për më shume, mbajtja e kapitalit të tepruar është një mjet për bankat që të sinjalizojnë aftësinë paguese dhe aftësinë kreditore dhe të frymëzojnë besimin e depozituesve, veçanërisht në vendet në zhvillim apo në periudhat e krizës financiare (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Claeyns dhe Vander Vennet, 2007). Kjo veçori do të nxisë depozituesit, sidomos pjesëmarrësit profesional të tregut, të veprojnë me maturi dhe të shmangin depozitimin e parave në bankat me kapital të keq. Kur depozituesit ushtrojnë "disiplinën e tregut të depozituesve", kjo mund t'i lejojë bankës të ulë depozitën e

saj, shpenzimet e financimit dhe rrjedhimisht, të rrisë diferencën e saj të interesit. Normalisht pritet një lidhje pozitive me variablin e varur, pasi bankat që janë më rrezikundërshtuese, do të priren të caktojnë marzhe më të larta si kundërpërgjigje. Megjithatë, një nivel më i lartë kapitalizimi i bankave duhet të interpretohet me kujdes, pasi jo domosdoshmërisht mund të shkaktohet si pasojë e qëndrimit të bankave ndaj rrezikut. Shpeshherë bankat janë të detyruara të mbajnë një nivel të caktuar kapitali si pasojë e kërkesave rregullative dhe mbikëqyrëse dhe jo pse ato mund të jenë rrezikundërshtuese.

c) **Rreziku i likuiditetit (LQ)** - përcaktohet nga aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve.

Një nivel i lartë i raportit të likuiditetit nënkupton që një bankë ka pasuri të mjaftueshme likuide për të parandaluar tërheqjet e papritur të depozitave ose për të financuar kërkesat e rritura ndaj kredisë. Megjithatë, bankat me nivele të larta të aktiveve likuide, qoftë vullnetarisht për shkak të kujdesit apo si rezultat i rregullimit, mund të marrin të ardhura më të ulëta të interesit sesa bankat me më pak asete likuide, të cilat zakonisht tregojnë tregjet në zhvillim. Në këtë rast, duke e pasur parasysh se tregjet për depozitat janë mjaft konkurruese, marrëdhënia me marzhin neto të interesave pritet të jetë negative (Angbazo, 1997; Demirgüç-Kunt et al., 2004). Megjithatë, bankat me nivele të larta të aktiveve likuide në të holla dhe letrat me vlerë të qeverisë mund të marrin të ardhura më të ulëta të interesit sesa bankat me mjete me më pak likuide. Nga ana tjetër, Martinez Peria dhe Mody (2004) deklarojnë se raporti i likuiditetit mund të ketë një ndikim pozitiv në marzhet e interesit në masën që bankat janë në gjendje të transferojnë koston e kësaj mundësie për huamarrësit.

- d) ***Rreziku i kredise apo mospagimit (CR)*** – i cili tregon cilësinë e aktiveve të një banke. Ky tregues është llogaritur si raport i kredive me probleme ndaj totalit të kredive dhe është menduar të vendoset në ekuacion me kohë vonesë, sepse është normale që bankat të reagojnë pas njëfarë kohe ndaj nivelit të kredive me problem, i referohet pasigurisë lidhur me shlyerjen e kredisë. Pjesa më e madhe e pasurisë së bankës është në formë të huave apo kredive dhe problemet me cilësinë e kredisë kanë qenë shkak kryesor i dështimit të bankave. Simptomat e cilësisë së dobët të kredisë përfshijnë nivele të larta të kredive me probleme dhe humbjeve nga kreditë. Një përqindje e lartë e provigjoneve të kredisë në lidhje me aktivet e huaja dhe rritja e shpejtë e portofolit të kredisë janë sinjale paralajmëruese të hershme të problemeve të cilësisë së kredisë, të cilat mund të tregojnë dështim potencial. Bankat që kanë të bëjnë me kredi të rrezikshme janë të detyruara të mbajnë një sasi më të lartë të provigjoneve. Nga ana tjetër, kjo mund t'i detyrojë ata për të ngarkuar margjina më të larta të interesit në mënyrë që të kompensojnë rrezikun më të lartë të parazgjedhur, duke çuar natyrshëm në një pozitive (Drakos, 2002, Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004). Zakonisht, pritet një koeficient pozitiv para këtij variabli, pasi për një nivel më të lartë rreziku, bankat do të caktojnë më shumë prim rreziku mbi normat e interesit të kredive të reja. Pra në njëfarë mënyre, do të jenë kredimarrësit e rinj ata që do të paguajnë kostot e moskthimit të kredive të vjetra.
- e) ***Shpenzimet operative (OE)*** - Variabli që do të përdoret për shpenzimet operative, llogaritet si raport i shpenzimeve të veprimtarisë me totalin e aktiveve dhe pritet të ketë ndikim pozitiv mbi marzhin neto të interesave. Shpenzimet e veprimtarisë do të përfshihen në ekuacion për të provuar nëse kostot më të larta kalohen apo jo te

klientët e bankës, në trajtën e caktimit të marzheve më të larta. Variabli poashtu përdoret për të kapur dallimet ndërbankare në formën e tyre organizative dhe operacionale, duke përfshirë koston (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999, Abreu dhe Mendes, 2003, Demirgüç-Kunt dhe të tjerët, 2004). Bankat që mbajnë shpenzime mesatare më të larta operative mund të zgjedhin për margjina më të larta për të kompensuar ato kostot më të larta të transformimit, që nënkupton një marrëdhënie pozitive (Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). Nga ana tjetër, efikasiteti më i lartë mund të nxisë bankat që të kalojnë shpenzimet më të ulëta mbi klientët e tyre në formën e normave më të ulëta të huave dhe / ose depozitave më të larta duke zvogëluar kështu diferencën e interesit (Claeys dhe Vander Vennet, 2007).

- f) ***Madhësia e bankave (S)*** – matet duke përdorur llogaritmin e total aktiveve për të kapuar efektin e madhësisë së bankës që ndikojnë marzhin neto të interesit. Sipas Naceur (2003) shprehet se bankat e mëdha priren të ulin marzhet si rezultat i ekonomive të shkallës. Martinez Peria dhe Mody (2004) pohojnë se bankat më të mëdha mund të jenë në gjendje të korrin përfitime si rezultat të ekonomive të shkallës dhe këto përfitime të kalojnë tek klientët e tyre në formën e marginës më të ulët. Madhësia e bankës mund të sjellë në vetvete një ulje të kostos së marrjes së burimeve (depozita ose huamarrja) nëse banka ka një reputacion ("shumë i madh për të dështuar"), pasi që bankat e mëdha shihen nga konsumatorët më të sigurtë dhe kështu duke përfituar kosto më të ulët të burimeve të jashtme (Gual, 1999). Për më tepër, bankat e vogla supozohet se vuajnë nga problemet e asimetrisë informative më shumë se sa bankat e mëdha. Ndërsa, për bankat që bëhen

jashtëzakonisht të mëdha, efekti i madhësisë mund të jetë negativ për shkak të arsyeve burokratike ose të tjera. Ne tjetrën anë, problemet e agjencisë, problemet e kontrollit dhe të gjitha vështirësitë dhe kostot që lidhen me menaxhimin e një institucioni të madh mund të ulin përfitimet e ekonomive të shkallës. Bankat e mëdha mund të kenë një përmbajtje të konsiderueshme në sasinë e fuqisë së tregut dhe nivele më të larta të efikasitetit që do t'u lejonte atyre të ofrojnë margjina më të larta.

g) **O - Pronësia**, paraqet variablin tjetër të pavarur. Institucionet bankare janë klasifikuar në vendore dhe të huaja. Variabli është vlerësuar si dummy variabel, ku me zero janë paraqitur bankat vendore kurse me një janë bankat e huaja. Sipas Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999) e gjejnë atë se bankat e huaja kanë tendencë të kenë edhe margjina edhe fitimet më të larta. Në të kundërt, Martinez Peria dhe Mody (2004) të cilat kanë studiuar bankat e Amerikës Latine dhe sugjerojnë që bankat e huaja janë në gjendje të ngarkojnë spread-a më të ulëta në krahasim me bankat vendase. Demirgüç-Kunt et al. (2004), përfundojnë se shkalla e pronësisë shtetërore të industria e bankave lidhet pozitivisht me margjinat e interesave. Sapientza (2002) gjen prova se bankat me pronësi shtetërore ngarkohen me norma të ulëta të interesit, veçanërisht për firmat e vendosura në rajone dhe me ndikim të fortë politik.

h) **PBB – Produkti i brendshëm bruto**, për të kapur efektin makroekonomik në model kam përfshirë edhe Rritjen e PBB-se. Demirgüç-Kunt dhe Huizinga (1999) dhe Demirgüç-Kunt et al. (2004) sugjerojnë që PBB-ja për frymë shërben si një tregues i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik duke reflektuar dallimet në teknologjinë dhe

mundësite bankare. Gjithashtu, me rritjen në PBB-se për koke banori mund të pritët rritje e të ardhurave të bankës si rezultat i kreditimit më të madh dhe ulje të normave të mospagimit. (Brock dhe Suarez, 2000, Claeyss dhe Vander Vennet, 2007). Në të kundërt, GDP e ulët për kokë banori dobëson kapacitetin e borxhit të huamarrësve të brendshëm dhe kontribuon në rritjen e rrezikut të kredisë. Ngjajshëm me këtë, Vein, Carbo dhe Rodriguez (2007) sugjerojnë një lidhje negative midis rritjes së PBB-së dhe marginave të bankës. Megjithatë, Drakos (2002) pohon se marrëdhënia midis rritjes së PBB-se dhe marginave është e paqartë, në varësi të faktit se kërkesa agregate për shërbimet e shitblerjes është një funksion rrites i PBB-së apo jo.

- i) **Indeksi i përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI)** - Në studimin në fjalë, ky tregues matet nga indeksi i përqendrimit në terma të aseteve. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) matet si shuma e katrorëve të pjesës së tregut të aseteve të çdo banke në treg. Një nivel më i lartë përqendrimi do të thotë më tepër fuqi nga ana e bankave, çka mund të sjellë në marzhe më të larta interesi. Fuqia e tregut, nënkupton atë që bankat mund të zbatojnë margjinat më të larta të interesit, ose duke vendosur norma më të ulëta të depozitave ose norma më të larta kredie ose duke ushtruar të dyja së bashku. Një literaturë e gjerë studion ndikimin e përqendrimit në përfitueshmërinë e bankës (Berger, 1995) (A.N, 1995) (N., 2007) (Berger A. M., 1997) Literatura sugjeron dy hipoteza të kundërta në lidhje me ndikimin e përqendrimit në sjelljen e bankave ndaj çmimit. Hipoteza e parë është ajo Strukturë-Performancë (SPH), e cila argumenton se një sistem bankar më i përqendruar do të sillët në mënyrë oligopolistike dhe një përqendrim më i lartë do të sjellë vendosjen e

marzheve më të larta nga ana e bankave. (Carbo V.S., 2007) Hipoteza e dytë është ajo e Strukturës Eficiente (ESH) që pohon se përqendrimi prodhon rritje efience (në terma të reduktimit të kostove) duke shkaktuar rënie të marzheve. (Demsetz, 1973) Një tjetër arsye mund të jetë se bankat e mëdha kanë një strukturë të ndryshme të aktiveve që sjellin të ardhura apo pasiveve që paguajnë interes, nga ajo e bankave më të vogla, çka mund të ndikojë interesat e marrë apo të paguar e detyrimisht edhe nivelin e marzhit të interesave. Disa studiues sugjerojnë se marrëdhënia midis përqendrimit dhe margjinave të bankave është pozitive bazuar në hipotezën SCP (Berger A. B., 2000), (Carbo V.S., 2007), (Claeys, 2007). Në të kundërt, Claeys dhe Vander Vennet (2007) dështojnë të gjejnë një marrëdhënie të rëndësishme midis përqendrimit të tregut dhe marzhes se interesit si një pasqyrim i mundshëm i zhvillimit të shpejtë të huadhënies bankare në ekonomitë e anëtarësimit dhe rritjen e konkurrencës pas hyrjes së bankave të huaja. Sipas Demirgüç-Kunt et al. (2004), nëse përqendrimi i bankave pasqyron vetëm kufizimet rregullatore mbi konkurrencën, atëherë çdo marrëdhënie pozitive midis margjinave të bankave dhe përqendrimit duhet të zhduken kur kontrollojnë kufizimet rregullatore. Nga ana tjetër, një marrëdhënie negative do të mund të ekzistonte. Në të njëjtën mënyrë, Maudos dhe Fernández de Guevara (2004) përfundojnë, duke përdorur një mostër të gjerë të bankave evropiane në periudhën 1993-2000, se rënia e marzheve në sistemin bankar evropian është në përputhje me një rritje të fuqise se tregut, që perfaqesohet nga indekset Lerner dhe Herfindahl-Hirschman. Martinez Peria dhe Mody (2004), deklarojnë se bankat relativisht më efikase duhet të jenë në gjendje të ngarkojnë spread-a më të ulëta, si rezultat i kësaj për me pas kosto më të ulëta.

6.2. Rezultatet empirike

Ekuacioni që do të vlerësohet mund të paraqitet në mënyrë të përmblendhur si më poshtë:

$$NIM_{it} = \alpha_i + \beta_1 \cdot PP_{it} + \beta_2 \cdot QR_{it} + \beta_3 \cdot LQ_{it} + \beta_4 \cdot CR_{it} + \beta_5 \cdot OE_{it} + \beta_6 \cdot S_{it} + \beta_7 \cdot O_{it} + \beta_8 \cdot PBB_{it} + \beta_9 \cdot HHI_{it} + \beta_{10} \cdot X_{1t} + \beta_{11} \cdot X_{2t} + \beta_{12} \cdot X_{3t} + \beta_{13} \cdot X_{4t} + \beta_{14} \cdot X_{5t} + \varepsilon_{it}^6$$

ku:

$i = 1, 2, \dots, N$ është banka e i -të; $t = 4, 5, \dots, T$ i përket vitit përkatës të marrë në shqyrtim α_i , $\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5, \beta_6, \beta_7, \beta_8, \beta_9, \beta_{10}, \beta_{11}, \beta_{12}, \beta_{13}, \beta_{14}$ është një vektor parametrash dhe α_i përfaqëson Efektet Fikse. Ndërsa X është vektor i variablave të shteteve. Ku, X_1 është Shqipëria, X_2 - Bosnja e Hercegovina, X_3 - Kosova, X_4 - Maqedonia dhe X_5 - Serbia. Kurse ε paraqet termin e gabimit të modelit.

Variabli i varur:

Marzhi neto i normave të interesit (NIM) i llogaritur, $NIM = \text{Të ardhura neto nga interesat} / \text{Të ardhurat nga interesat}$ apo $NIM = \text{Te ardhurat nga interesi} - \text{Shpenzimet nga interesi} / \text{Mjetet totale}$;

Variablat e pavarura:

Performanca e portfoliosë (PP) = Kreditë / Mjetet totale;

Qëndrimi ndaj rrezikut (QR) = Kapitali / Mjetet totale;

Rreziku i likuiditetit (LQ) = Mjetet likuide / Mjetet totale;

Rreziku kreditor (CR) = Kreditë joperformuese / Total kreditë bruto;

Shpenzimet operative (OE) = Total shpenzimet nga jo interesat / Mjetet totale;

⁶ Dealer model (Ho and Saunders, 1986) – Modeli i ndërmjetësimit

Madhësia e bankave (S) = Logaritmi i mjeteve totale të bankave

Pronesia (O) – paraqet variabel “dummy”, që do të thotë se me numrin zero janë koduar bankat vendore ndërsa me numrin një janë koduar bankat e huaja.

Ekonomia (PBB) – e matur me Produktin e Brendshëm Bruto

Stuktura e tregut (HHI) - e matur me indeksinë e përqendrimit Herfindahl-Hirschman në terma të aseteve;

6.2.1. Rezultatet sipas analizës statistikore deskriptive

Siç u tha më lartë metoda e pare e analizimit të të dhënave është analiza e statistikës descriptive apo përshkruese. Përmes kësaj metode e kemi mundësinë e paraqitjes së rezultateve, kështu duke e nxjerrur mesataren aritmetike dhe devijimin standard. Duke i paraqitur dhe analizuar të dhënat, kjo metodë na jap mundësinë e krahasimit. Krahasimet janë bërë duke u bazuar në të dhënat e variablave me karakter bankar, të tregut dhe makroekonomik, duke i krahasuar pesë shtetet dhe shtatë vitet e paraqitura në hulumtim. Në tabelën me nr.14 janë paraqitur rezultatet e analizës statistikore deskriptive për variablin e varur (Marzhin neto të interesit – NIM) dhe disa nga varibalat e pavarura (Performancën e portfoliosë – PP; Qëndrimi ndaj rrezikut – QR; Rreziku i likuiditetit – LQ; Rreziku i kredisë – CR; Produkti i Brendshëm Bruto – PBB dhe Indeksi i përqëndimi – HHI. Paraqitet mesatarja aritmetike e tyre dhe devijimi standard (devijimi standard minimal dhe maksimal). Të dhënat janë paraqitur dhe ndarë sipas 5 shteteve të paraqitura në studim.

Tabela nr.14. Analizat statistikore deskritive e variablave, sipas shteteve

Shteti	Statistikat	NIM	PP	QR	LQ	CR	PBB*	HHI** ⁷
SHQIPËRIA	Mesatarja	0.54	0.53	0.13	0.22	0.16	1220	1583.47
	Devij. Standard	0.09	0.16	0.05	0.12	0.18	741	225.82
	Min	0.29	0.26	0.00	0.05	0.00	10700	1367.50
	Max	0.77	0.94	0.29	0.70	1.00	12900	1931.73
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	Mesatarja	0.64	0.67	0.16	0.24	0.15	17300	1272.49
	Devij. Standard	0.11	0.14	0.10	0.14	0.19	1010	578.01
	Min	0.23	0.30	0.00	0.01	0.00	15400	1115.55
	Max	0.99	0.95	0.52	0.69	1.00	18700	10000.00
KOSOVA	Mesatarja	0.68	0.65	0.10	0.25	0.11	6020	2981.96
	Devij. Standard	0.09	0.07	0.03	0.08	0.17	748	813.59
	Min	0.52	0.54	0.07	0.09	0.00	4690	2206.88
	Max	0.81	0.85	0.20	0.41	0.62	7070	4543.12
MAQEDONIA	Mesatarja	0.49	0.56	0.18	0.32	0.26	9540	1959.10
	Devij. Standard	0.10	0.19	0.15	0.24	0.31	683	228.90
	Min	0.23	0.01	0.07	0.04	0.01	8160	1541.16
	Max	0.79	0.80	0.92	0.98	1.00	10400	2212.06
SERBIA	Mesatarja	0.58	0.63	0.21	0.24	0.17	43500	1518.71
	Devij. Standard	0.17	0.20	0.11	0.18	0.19	3420	206.76
	Min	0.32	0.00	0.00	0.00	0.01	3940	1287.95
	Max	0.96	1.62	0.66	0.89	1.00	49300	1985.23
Total	Mesatarja	0.59	0.62	0.17	0.25	0.18	22700	1612.81
	Devij. Standard	1.53	0.18	0.11	0.17	0.22	14500	565.75
	Min	0.23	0.00	0.00	0.00	0.00	4690	1115.55
	Max	0.99	1.62	0.92	0.98	1.00	49300	10000.00

Në këtë tabelë shihen qartë statistikatat përshkruese për pesë shtetet në zhvillim, si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Serbia. Statistikatat përshkruese janë vlerësuar përmes programit STATA version 11.0, duke e llogaritur mesataren aritmetike, devijimin standard, minimumin dhe maksimumin për variablat, si: variablin e varur NIM dhe variablat e pavarur PP, QR, LQ, CR, PBB dhe HHI. Nga tabela shihet se

⁷ * Vlera e PBB-se është në milion. ** HHI e vlerësuar në termin e aseteve.


mesatarja më e lartë e NIM-it është në Kosovë me 0.68 përqind me 0.09 të devijimit standard, duke pasquruar nga Bosnja dhe Hercegovina me 0.64 me 0.11 të devijimit standard, Serbia me 0.58 me 0.17 të devijimit standard, Shqipëria me 0.54 me 0.09 të devijimit standard dhe Maqedonia 0.49 me 0.10 të devijimit standard. Mesatarja e përgjithshme e të gjitha vendeve është 0.59 me 1.53 të devijimit standard. Minimumi i NIM-it në mesataren e përgjithshme të të gjitha shteteve është 0.23 ndërsa maximum 0.99. Performanca e portfolios (PP) apo kreditë në raport me asetet totale sipas statistikave përshkruese dhe të dhënave të disponuara paraqiten me mesataren më të lartë prej 0.67 në Bosnje dhe Hercegovinë dhe devijim standard 0.14, më pas vijon Kosova me mesatare të PP-së prej 0.65 dhe 0.07 të devijimit standard, pastaj Serbia me 0.63 të mesatares së PP-së dhe 0.20 të devijimit standard, Maqedonia 0.56 të mesatares së PP-së dhe 0.19 të devijimit standard dhe vlerat më të ulëta të mesatarës së PP-së rezultojnë Shqipëria me 0.53 dhe 0.16 të devijimit standard. Mesatarja e përgjithshme e portfolios së kredive për pesë shtetet e lartëcekura është 0.62 dhe 0.18 të devijimit standard, ku minimumi është 0.0 ndërsa maksimumi i mesatarës së PP-së është 1.62. Variabli i tretë i pavarur dhe i llogaritur është QR apo qëndrimi ndaj rrezikut që paraqet raportin e kapitalit me asetet totale, ku mesatarja më e lartë e saj paraqitet në Serbi me 0.21 përqind dhe 0.11 devijim standard, më pas është Maqedonia me 0.18 të mesatarës së QR-së dhe 0.15 të devijimit standard, Bosnja dhe Hercegovina me 0.16 të QR-së dhe 0.10 të devijimit standard, Shqipëria me 0.13 të QR-së dhe 0.05 të devijimit standard dhe më e ulëta e mesatarës së QR-së është Kosova me 0.10 dhe 0.03 të devijimit standard. Mesatarja e përgjithshme e qëndrimit ndaj rrezikut për të gjitha shtetet është 0.17 me 0.11 të devijimit standard. Variabli tjetër i pavarur është LQ apo risku i likuiditetit si rrjedhojë e raportit të rezervave likuide dhe aseteve totale. Nga

tabela vërehet se mesatarja më e lartë e LQ është paraqitur në Maqedoni në vlerë prej 0.32 me 0.24 të devijimit standard, më pas është Kosova me 0.25 të mesatares së LQ-së dhe 0.08 të devijimit standard, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina së bashku me Serbinë kanë përqindje të njëjtë të mesatares së LQ-së me 0.24, për dallim nga devijimi standard i cili 0.18 është në Serbi kurse 0.14 është në Bosnje dhe Hercegovinë. Norma më e ulët e mesatares së LQ-së është paraqitur në Shqipëri në vlerë prej 0.22 dhe 0.12 të devijimit standard. Mesatarja e përgjithëshme e LQ-së për të gjitha shtetet është 0.25 me 0.17 të devijimit standard. Variabli tjetër i pavarur është Risku kreditor apo CR i cili paraqet raportin e kredive me probleme me bruto kreditë. Norma më e lartë e mesatares së riskut kreditor në bazë të analizës së statistikës përshkruese rezulton te shteti i Maqedonisë me normë të përqindjes prej 0.26 dhe 0.31 devijim standard. Me pas është Serbia me normë mesatare të LQ-së prej 0.17 dhe 0.19 të devijimit standard, pastaj vjen Shqipëria me 0.16 të LQ-së dhe 0.18 të devijimit standard, Bosnia dhe Hercegovina me 0.15 të LQ-së dhe 0.19 të devijimit standard dhe me normë mesatare më të ulët rezulton Kosova prej 0.11 të LQ-së dhe 0.17 të devijimit standard. Norma mesatare e përgjithëshme e CR-së për të gjitha shtetet është 0.18 me normë të përgjithëshme mesatare të devijimit standard prej 0.22. Variabli tjetër i pavarur i përdorur në model është PBB-ja. E nxjerrur prej fëbsajtit të statistikave të Bankës Botërore për vitet 2007-2013, e cila paraqet ndikimin e zhvillimit ekonomik të vendeve në shqyrtim. Vlera e PBB-së është paraqitur me shkurtesa në tabelë përderisa vlerat e saj janë milionëshe. Sipas të dhënave mesatarja aritmetike me vleren më të lartë të PBB-së e ka Serbia prej 43,500 dhe 3,420 të devijimit standard. Pastaj me normë më të lartë mesatare vijon Bosnja dhe Hercegovina 17,300 të PBB-së dhe 1,010 të devijimit standard, Shqipëria me 12,200 të PBB-së dhe 741 të devijimit standard, Maqedonia me 9,540 të PBB-së dhe

683 të devijimit standard dhe Kosova me vlerën mesatare më të ulët të PBB-se prej 6,020 dhe 748 të devijimit standard. Vlera mesatare e PBB-së për pesë shtetet në zhvillim është 22,700 me devijim standard prej 14,500 dhe me vlerë minimale prej 4,690 dhe maksimale prej 49,300. Struktura e tregut të bankave është matur me Indeksin e përqendrimit Herfindahl-Hirschman në terma të aseteve, i cili është llogaritur në STATA si rrjedhojë e HHI-së në terma të kredive dhe depozitave. Sipas analizës statistikore strukturë të fuqishme të tregut dominon Kosova me vlere prej 2,981.96 dhe 813.59 të devijimit standard, pastaj vijon Maqedonia në vlerë prej 1,959.10 dhe 228.90 të devijimit standard, Shqipëria me vlerë të HHI-së prej 1,583.47 dhe devijim standard prej 225.82, për afërsisht e ngjajshme me Shqipërinë është shteti i Serbisë në vlerë prej 1,518.71 të HHI-së dhe me vlerë prej 206.76 të devijimit standard. Bosnja dhe Hercegovina rezultojn me vlerën mesatare minimale të HHI-së prej 1,272.49 dhe 578.01 të devijimit standard. Vlera mesatare e përgjithëshme për të gjitha shtetet e investiguara është 1,612.81 të HHI-së dhe 565.75 të devijimit standard. Vlera minimale e përgjithëshme është 1,115.55 ndërsa maksimalja 10,000.00.

Që të ilustrohen më mire rezultatet e arritura, vlerat e mesatares aritmetike janë paraqitur në mënyrë grafike. Në grafikun numër 18 është paraqitur analiza statistikore deskriptive e variablave me karakter bankar, siç janë: Marzhi neto i interesit (NIM); Performanca e portfoliosë (PP); Qëndrimin ndaj rrezikut (QR), Rreziku i likuiditetit (LQ) dhe Rreziku i kredisë (CR).


Grafiku nr. 18. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter bankar, sipas analizës statistikore deskriptive



Sipas mesatares aritmetike, në këtë grafik mund të shohim se marzhi neto i interesit (NIM) është më i lartë në shtetin e Kosovës, duke pasuar nga Bosnja e Hercegovina, Serbia Shqipëria dhe Maqedonia. Performanca e portfoliosë përfaqësohet më së shumti nga shteti i Bosnjës e Hercegovinës, më pas kemi shtetin e Serbisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë. Qëndrueshmëria ndaj rrezikut paraqitet me mesatare më të lartë në shtetin e Serbisë, pastaj Maqedonisë, Bosnje e Hercegovinë kurse Shqipëria e Kosova renditen me mesatare mw të ulët të PP-së. Rreziku likuiditetit dominon në Kosovë, pastaj në Bosnje e Serbi, kurse vlerë përafësisht të ngjajshme e ka Shqipëria me Maqedoninë. Rrezik të lartë të kredisë apo kredi jo performuese kanë dal në Bosnje, Serbi e Kosovë kurse me nivel pak më të ulët e ka

Shqipëria me Maqedoninë. Ndërsa sa i përket vlerave mesatare të PBB-së dhe HHI-së janë paraqitur në grafikun me nr.19, pasi që shumat e tyre janë në vlerë e jo përqindje.

Grafiku nr. 19. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter makroekonomik, sipas analizës statistikore deskriptive



Në këtë grafik, shihet se variabli i pavarur PBB, dominon në Serbi pastaj Bosnje, Shqipëri e Maqedoni, vlera mesatare më e vogël e PBB-së dominon në Kosovë.

Mund të themi se vlerat e mesatares janë vlerësuar vetëm për 116 banka të këtyre pesë shteteve dhe nuk mund të mirren si analizë përfundimtare. Analiza e regresionit do të na ndihmojë që më detalisht dhe në mënyrë më të përmblëdhur t'i analizojmë rezultatet e këtij studimi. Më poshtë do të analizohen mesataret aritmetike të variablave me karakter bankar, të tregut dhe makroekonomik duke u bazuar në pronësinë e kapitalit të bankave të

hulumtuara. Variabli i pavarur, pronësia është i llogaritur si “dummy variabel” apo i dyfisht, ku me kodin zero janë paraqitur bankat me pronësi vendore kurse me kodin një janë paraqitur bankat me pronësi të huaj.

Tabela nr.15. Analizat statistikore deskpritive e variablave, sipas pronësisë

Sipas	Pronësisë	NIM	PP	QR	LQ	CR	PBB	HHI ⁸
Vendore	<i>Mesatarja</i>	0.2199061	0.5693914	0.1788098	0.3070101	0.2100726	22510	1657.147
	<i>Devij. Stand.</i>	2.848929	0.2293448	0.1236146	0.2293639	0.2265507	14710	705.3014
	<i>Min</i>	0.2378995	0.0006244	0.0022779	0.0022552	0.0089422	46909	1115.545
	<i>Max</i>	0.9696095	1.624761	0.5913749	0.9829161	1	49310	10000
Te huaja	<i>Mesatarja</i>	0.6016718	0.6319587	0.1698675	0.2296388	0.1628584	22810	1590.935
	<i>Devij. Stand.</i>	0.1196739	0.1544193	0.1009496	0.1335265	0.2186559	14410	481.5018
	<i>Min</i>	0.1128341	0.1620317	0.0038724	0.0027002	0.0016685	46909	1115.545
	<i>Max</i>	0.9953488	1.28021	0.923585	0.7391092	0.9994346	49310	4543.118
Total	<i>Mesatarja</i>	0.5921685	0.6155095	0.1724443	0.2519342	0.1756402	22710	1612.814
	<i>Devij. Stand.</i>	1.535916	0.1791419	0.1079462	0.1703367	0.2215033	14510	565.7483
	<i>Min</i>	0.2378995	0.0006244	0.0022779	0.0022552	0.0016685	46909	1115.545
	<i>Max</i>	0.9953488	1.624761	0.923585	0.9829161	1	49310	10000

Duke u bazuar në analizën statistikore, erdhëm deri te rezultatet e paraqitura në tabelën me nr.15. Variablat e shtjelluar këtu janë të ngjajshëm siç i përshkruam më lartë mirëpo tani të krahasuar në bazë të pronësisë së kapitalit të bankave. Sipas mesatares së NIM-it, për bankat vendore rezulton me normë prej 0.22 ndërsa për bankat e huaja me normë prej 0.60. Devijimi standard për bankat vendore është 2.85 ndërsa për bankat e huaja 0.12. Në tabelë shihet vlera minimale e total mesatares e cila është prej 0.24 ndërsa vlera maksimale e mestarës së NIM-it është 0.99. Të njëjtat të dhëna janë gjeneruar edhe për variablat e tjera, si PP e cila rezuloi me normë të mesatares për bankat vendore prej 0.56 me 0.23 të devijimit standard kurse 0.63 të mesatarës së PP-së është norma për bankat e huaja dhe


⁸ * Vlera e PPB-se eshte ne milion. ** HHI e vleresuar në termin e aseteve.

0.15 të devijimit standard. Total mesatarja e PP-së për të dy nivelet e bankave është 0.62 me 0.18 të devijimit standard. Minimumi i mundshëm i PP-së është 0.00063 ndërsa maksimumi i mundshëm 1.62. Norma mesatare e variablit QR të bankat vendore është përafërsisht 0.17 ndërsa te bankat e huaja përafërsisht 0.18, që do të thotë se është pothuajse e ngjajshme me një diferencë prej 0.01. Variabli tjetër është LQ ku norma mesatare të bankat vendore sillet rreth 0.31 përderisa te bankat e huaja është 0.23. Mesatarja e riskut kreditor (CR) është më e madhe te bankat vendore se sa të huajat me norme prej 0.21 krahasuar me 0.16. Vlera mesatare e PBB-së përafërsisht në grafik duken sikur të njëjta. Vlera e saj të bankat vendore sillet 2,250 milion kurse te bankat e huaja 2,280 milion. Indeksi i përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI) i cili e pasqyron sturkturen e tregut sipas analizës rezulton me normë mesatare 1,657.147 për bankat vendore dhe me devijim standard në vlerë prej 705.3014 ndërsa me 1,590.935 norma mesatare e HHI-së për bankat e huaja dhe me vlerë prej 481.5018 devijim standard.

Më poshtë janë ilustruar grafikisht normat mesatare të variablit të varur NIM dhe variablave të pavarur PP, QR, LQ, dhe CR të bankave komerciale të vendeve të Ballkanit. Diferenca apo ndryshimi më i madh që vërehet në grafik në mes të bankave me pronësi vendore dhe bankave me pronësi të huaja qëndron te varibali i varur marzhi neto i interesit NIM. Kjo ndoshta për shkak të numrit të të punësuarëve që kanë, pastaj bankat me pronësi të huaj përbëjnë pjesën më të madhe të tregut në vendet e Ballkanit, eksperiencat dhe trajnimet nga zyrtarët e bankave meme rrisin kostot, kostot e marketingut poashtu rrisin kostot e këtyre bankave komerciale, të gjitha këto bëjnë që bankat me pronësi të huaj të

kenë kosto më të larta por në të njëjtën kohë gjenerojnë edhe të ardhura më të mëdha, kështu duke e rritur fitimin dhe marzhin neto të interesave në përgjithësi.


Grafiku nr.20. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter bankar, sipas pronësisë



Pra, sipas analizës statistikore e cila besoj se do të qëndroj e ngajshme edhe sipas analizës së regresionit, bankat e huaja kanë fitime më të mëdha apo marzhe më të larta të interesit se sa bankat vendore. Ndryshimi tjetër vërehet te LQ dhe CR, që do të thotë se risku i likuiditetit dhe ai kreditor është më i lartë te bankat vendore se sa te bankat e huaja, kjo për arsye se bankat vendore janë më të kufizuara dhe nuk kanë qasje të mëdha në tregjet dhe bursat ndërkombëtare sikurse bankat e huaja. Ndërsa sa i përket variablave të tjerë si PP - performanca e portfolios dhe QR – qëndrimi ndaj rrezikut kanë një vlerë konstante apo të njëjtë si për bankat vendore ashtu edhe për bankat e huaja. Pra, kreditë dhe nivelii mbajtjes së kapitalit është përafërisht i njëjtë.

Në grafikun me numër 21, poashtu janë ilustruar mesataret e variablit të PBB-së dhe HHI-së për bankat me pronësi vendore dhe bankat me pronësi të huaj.

Grafiku nr.21. Mesatarja aritmetike e variablave me karakter makroekonomik, sipas pronësisë



Rezultat i ngjajshëm ka dal edhe tek variablat e PBB-së dhe HHI-së, përkatësisht zhvillimit ekonomik dhe strukturës së tregut, ku shihet edhe në grafik se vlerat janë të përafërta dhe kanë një nivel gati të ngjajshëm si për bankat vendore ashtu edhe të huajat.

Se që bankat e huaja kanë marzhe neto më të larta të interesit se sa bankat vendore e vërteton edhe T-testi i nxjerrur nga programi stata. T-testi sipas analizes statistikore përshkruese është paraqitur në tabelën nr.16, duke u bazuar në mesataren aritmetike.

Tabela nr. 16. T-testi, sipas pronesisë

Grupi	Obs	Mesatarja	Std. Err.	Std. Dev.	[95%]	
-----+-----						
0	283	.2199061	.2105989	2.848929	-.1956232	.6354355
1	529	.6016718	.0056104	.1196739	.5906462	.6126974
-----+-----						
	812	.4921685	.0608075	1.535916	.3727611	.6115759
-----+-----						
Dif.		-.3817657	.133697		-.6443066	-.1192248
-----+-----						
dif = mean(0) - mean(1)				t = -2.8555		
Ha: dif < 0		Ha: dif != 0		Ha: dif > 0		
Pr(T < t) = 0.0022		Pr(T > t) = 0.0044		Pr(T > t) = 0.9978		

Nga gjithsej 812 observime, i kemi 283 banka vendore dhe 529 banka të huaja. Në këtë tabelë shihet se rezulton hipoteza zero, e cila fiton në krahasim me hipotezën alternative, me ç'rast vërtetohet se bankat e huaja kanë prirje në marzhe më të larta se sa bankat vendore në vendet e Ballkanit.

Rezultatet e statistikës përshkruese, lidhur me variablat e shtjelluar më lartë por tani të klasifikuara sipas periudhës shtatë vjeçare të studimit janë paraqitur në tabelen nr. 16. Trendi përfshin periudhen 2007-2013.


Tabela nr.17. Mesatararja aritmetike e variablave sipas viteve dhe trendi 2007-2013

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Total
NIM	0.6333447	0.5919088	0.5176008	0.5356968	0.5574081	0.4951146	0.4641639	0.4921685
PP	0.5673304	0.615448	0.6009155	0.6252789	0.6211961	0.6387234	0.6287521	0.6155095
QR	0.1966493	0.200773	0.1804312	0.1637362	0.1674174	0.1560212	0.1515308	0.1724443
LQ	0.3679572	0.28187	0.2589909	0.2270535	0.2279273	0.2122024	0.2147437	0.2519342
CR	0.0923727	0.1203648	0.132601	0.1452403	0.1876924	0.2337867	0.2554373	0.1756402
PBB	23.800	21.800	24.200	21.200	22.310	25.110	20.600	22.710
HHI	1980.011	1693.971	1680.491	1468.877	1556.709	1410.357	1499.278	1612.814

Në tabelë është paraqitur variabli i varur NIM dhe variablat e pavarura PP, QR, LQ, CR, PBB dhe HHI. Mesatarja e NIM-it është më e larta në vitin 2007 me vlerë të përafërt me 0.64 kurse vazhdon me rënie të lehte prej 0.59 në vitin 2008 e deri në 0.51 në vitin 2009. Pastaj vërehet një ngritje në 0.53 në vitin 2010 në 0.55 në vitin 2011. Prap kjo mesatare vazhdon të bie në 0.49 në vitin 2012 e deri në 0.46 në vitin 2013. Konstatja totale e mesatarës së NIM-it për të gjitha vitet është 0.49. Performanca e portfolios ka një mesatare të kundërt me NIM-in, në vitin 2007 paraqitet vlera prej 0.56 dhe vazhdon me një rritje jo shumë të madhe në vitin 2008 në vlerë prej 0.61, vlera e saj bie për 0.1 në vitin 2009, që do të thotë se vlera e mesatarës së PP-së në vitin 2009 është 0.60, rritet në 0.62 në vitin 2010 dhe këtë konstante e mban deri në vitin 2012. Në vitin 2012 vlera e mesatarës së PP-së arrin në 0.63 dhe prap bie në 0.62 në vitin 2013. Mesatarja totale e viteve për PP-në është 0.61. Qëndrueshmëria ndaj rrezikute ka një lëvizje gjatë trendit 2007-2013, fillon me vlerë të mesatare prej 0.19 në vitin 2007, rritet në 0.20 në vitin 2009, dhe vazhdon të bie prej 0.18 në vitin 2009, kurse 0.16 në vitin 2010, kjo mesatare qëndron e njëjtë në vitin 2011, kurse në vitin 2012 dhe 2013 mesatarja e QR-së është 0.15. Mesatarja totale për QR-në në gjithsej shtatë vitet është 0.17. Rreziku i likuiditetit, fillon me mesatare me të lartë në vitin


2007 prej 0.36 dhe vazhdon duke pas rënie në 0.28 në vitin 2008, 0.25 në vitin 2009, 0.22 në vitin 2010, të njëjtën vlerë të mesatares e mban edhe në vitin 2011 kurse në vitin 2012 dhe 2013 ka mesatare prej 0.21. Mesatarja totale e LQ-së për gjithsej vitet është 0.25. Rreziku i kredisë, mesataren më të vogël e ka në vitin 2007 prej 0.09, pastaj ka një rritje të vazhdueshme, në vitin 2008 vlera e mesatares së CR arrin në 0.12, 0.13 në vitin 2009, 0.14 në vitin 2010, 0.18 në vitin 2011, 0.23 në vitin 2012 dhe mesatarja më e lartë e CR –së arrin në 0.25 në vitin 2013. Mesatarja totale e CR-së për vitet është 0.17. Lëvizjet e mesatares vërehet edhe te variabli i ekonomisë - PBB-ja. E cila fillon me 23 në vitin 2007, bie në 21 në vitin 2008, rritet në 24 në vitin 2009, prap bie në 21 në vitin 2010, rritet në 22 në vitin 2011 dhe rritjen më të madhe e ka në vitin 2012 me vlerë prej 25, ku vlera e mesatares së PBB-së më e vogla paraqitet në vitin 2013. Mesatarja totale e mesatares së PBB-së për vitet paraqitet në vlerë prej 22. Variabli që e përshkruan strukturën e tregut përmes HHI-së fillon me vlerë të mesatarës prej 1,980 në vitin 2007, dhe çdo vit e më shumë vlera e mesatarës shkon duke zbritur deri sa arrin në 1,499 në vitin 2013. Vlera totale e mesatares së HHI-së për shtatë vitet është 1,612. Në grafikun me nr.22. është paraqitur trendi i variablave nëpër vite, sipas mesatares aritmetike. Në këtë grafik vërehen qartazi lëvizshmërit e variablave me karakter bankar të hulumtuara në këtë studim përgjatë periudhës kohore 2007-2013.

Grafiku nr.22. Mesatarja aritmetike e variablave bankar, sipas trendit 2007-2013



Kurse në grafikun me nr.23 është paraqitur mesatarja aritmetike e variablit të tregut e që është matur me indeksin e HHI-së dhe variablit makroekonomik, e që është matur me PBB-në.

Grafiku nr.23. Mesatarja aritmetike e variablave të tregut dhe makroekonomik, sipas trendit 2007-2013



Ndërsa në tabelën nr. 18, paraqitet mesatarja e variablave me karakter bankar, makroekonomik dhe të tregut për shtetet dhe vitet e hulumtuara.

Marzhi neto i interesit për Shqipërinë më i larti është paraqitur në vitin 2007 në vlerë mesatare prej 0.59, ndërsa vlera e këtij treguesi ka vazhduar të bie prej vitit në vit, e që arriti në 0.52 në vitin 2012. Performanca e portfoliosë në këtë shtet ka pasur luhatshmëri nëpër vite nga 0.48 në vitin 2007, është ngritu në 0.58 në vitin 2009, pastaj vlera e saj që paraqet kreditë në raport me asetet, vazhdon të bie deri në 0.48 në vitin 2012, njëjtë siç ishte në vitin 2007. Niveli i mbajtjes së kapitalit në Shqipëri, çdo vit e më shumë është rritur prej 0.09 në vitin 2007, ka arritur në 0.13 në vitin 2013. Rreziku i likuiditetit poashtu ka pasur rënie, prej 0.32 në vitin 2007, ka rënë në 0.21 në vitin 2013. Kreditë joperformuese kanë pasur lëvizje nëpër vite. Vlera mesatare më e ulët e tyre është paraqitur në vitin 2007 në vlerë prej 0.02, ndërsa më e larta në vlerë prej 0.23 në vitin 2013. PBB-ja me HHI-në për rastin e Shqipërisë e kanë mbajtur një konstante për gjatë këtyre viteve.

Shteti i dytë i paraqitur në hulumtim është Bosnja e Hercegovina. NIM-i më i lartë në këtë shtet paraqitet në vitin 2012 në vlerë prej 0.66, kurse më i ulëti paraqitet në vitet 2008, 2009, dhe 2010 me vlerë të mesatare prej 0.62. Vlera më e ulët e Performancës së portfoliosë për BH është paraqitur në vitin 2007 në vlerë prej 0.59, kurse vazhdimisht rritet deri në vitin 2013 në vlerë prej 0.72. Qëndrimi ndaj rrezikut në këtë shtet dominon në vitin 2011 me vlerë prej 0.17, kurse në vitin 2013 bie në 0.14. Rreziku i kredisë për BH është i lartë në vitin 2007, në vlerë prej 0.34, vazhdon duke rënë deri në vlerë prej 0.20 në vitin 2013. Kreditë joperformuese kanë vazhduar të rriten deri sa e arrin vlerën prej 0.23 në vitin

2013 karahasuar me 0.03 që e kishin në vitin 2007. Poashtu vlerat e PBB-së dhe HHI-së mbajnë një konstante të përafërt të vlerës nëpër vite.

Shteti i tretë i përfshirë në hulumtim është Kosova. NIM-in më të lartë e ka në vitin 2007, pastaj vlera mesatare e saj për këto bank aka vazhduar të bie deri në vlerë prej 0.65 në vitin 2013. Analizuar vetëm me rastin e Kosovës, mesatarja e NIM-it rritet sidomos gjatë viteve të fundit e deri me sot. PP-ja ka pasur disa lëvizje të konsiderueshme, vlera e saj filloi me 0.63 në vitin 2007, u rrit në 0.66 në vitin 2008 pastaj vazhdoi të bie në 0.62 në vitin 2009, prap u ngrit në 0.64 në vitin 2010 dhe vazhdoi të ngritet deri në vlerë prej 0.67 në vitin 2012, kurse në vitin 2013 vlera e saj u zvogëlua në 0.64 sikurse në vitin 2010. QR-ja në Kosove ka pasur një trend rënës. Vlersa e saj ishte 0.13 në vitin 2007, kurse ra në 0.09 në vitin 2013. Edhe variabli LQ kishte trend rënës, nga vlera mesatare 0.34 që ishte në vitin 2007, vazhdoi të bie deri në 0.20 në vitin 2013. Kreditë joperformuese kishin një mesatare prej 0.025 në vitin 2007, pastaj vlerat e tyre u rriten në 0.18 në vitin 2008, dhe vazdhuan të bien deri në 0.08 në vitin 2013. Vlerat e PBB-së dhe HHI-së mbajtën një konstante të mesatareve të vlerës së tyre nëpër këto vite.

Shteti i katërt , i hulumtuar është Maqedonia. Ku nga kjo tabelë shohim se NIM si variabël i varur ka një mesatare prej 0.65 në vitin 2007, dhe është më e larta për shtetin e MK-së, kurse vazhdon të bie deri në 0.55 vlera e saj për vitin 2013. Vlera më e lartë e PP-së paraqitet në vitin 2008 në vlerë prej 0.60 kurse më e ulëta paraqitet në vitin 2011 në vlerë prej 0.53. Qëndrueshmëria ndaj rrezikut ka pasur një trend rënës nga 0.25 në vitin 2007, vazhdoi të bie deri në 0.12 në vitin 2013. Rreziku i likuiditetit pati një trend lëvizës, prej 0.36 që kishte në vitin 2007, u rrit në 0.38 në vitin 2009, pastaj filloi të bie deri në vlerë

prej 0.24 në vitin 2013. Kreditë joperformuese u rritën në vitet e fundit. Vlera mesatare e tyre është 0.40 në vitin 2013 krahasuar me 0.20 në vitin 2007, dyfish më shumë. PBB-ja me HHI-në për rastin e Maqedonisë e kanë mbajtur një konstante për gjatë këtyre viteve.


Dhe shteti i pestë dhe i fundit në hulumtim është Serbia. Vlera më e lartë e NIM-it në këtë shtet paraqitet në vitin 2009 në vlerë prej 0.60 kurse më e ulëta në vitin 2011 në vlerë prej 0.55. Performanca e portfoliosë kishte lëvizje prej vitit në vit. Pati vlerë mesatareje prej 0.56 në vitin 2007 pastaj u rrit në 0.60 në vitin 2008, u zvogëlua në 0.58 në vitin 2009, prap u rrit në 0.65 në vitin 2010 dhe vazhdo të rritet kështu deri në vitin 2012 në vlerë prej 0.67, ndërsa në vitin 2013 u zvogëlua në 0.64. Qëndrimi ndaj rrezikut ka një trend të ngjajshëm me vendet e tjera. Vlera e tij ishte 0.24 në vitin 2007, pastaj vazhdoi të bie deri në 0.19 në vitin 2013. Rreziku I likuiditetit vlerën më të lartë të mesatares e kishte në vitin 2007 prej 0.41 kurse vazhdoi të bie deri në 0.20 në vitin 2013. Krejditë joperformuese kane një rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit në hulumtim, vlera e tyre arriti në 0.26 në vitin 2013 sa ishte 0.11 në vitin 2007. Vlerat e PBB-së dhe HHI-së mbajtën një konstante të mesatareve të vlerës së tyre nëpër këto vite. Që rezultatet e arritura të ilustrohen më mirë, janë paraqitur në mënyrë grafike në vijim. Grafikët përfshijnë variablat bankar, makroekonomik dhe të strukturës së tregut. Variablat me karakter bankar janë paraqitur veç e veç nëpër vite, kurse variabli makroekonomik dhe ai i tregut është paraqitur vetëm në periudhëne studimit 2007-2013.

Shteti	Variablat	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
SHQIPËRIA	NIM	0.59741	0.5645571	0.5277182	0.5319311	0.5389709	0.522675	0.5073932
	PP	0.4871232	0.5721828	0.5872843	0.5504023	0.5349665	0.520583	0.486641
	QR	0.091864	0.1124608	0.123535	0.1269962	0.1384002	0.1374643	0.1353786
	LQ	0.3206096	0.19179	0.2193647	0.2193735	0.2048581	0.1989716	0.218584
	CR	0.0281241	0.1682515	0.0846594	0.1496017	0.1741526	0.2194773	0.2374166
	PBB	1300	1200	1300	1200	1200	1300	1100
	HHI	1887.261	1931.73	1652.703	1461.792	1410.704	1372.613	1367.503
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	NIM	0.6575026	0.6201696	0.6271334	0.6287532	0.6521036	0.6630816	0.6493781
	PP	0.5967396	0.6504925	0.6516072	0.6542931	0.6683049	0.7187617	0.7260793
	QR	0.164256	0.1652529	0.1685715	0.1645471	0.1723579	0.1572071	0.1452244
	LQ	0.3465936	0.2390287	0.233853	0.2427539	0.2526424	0.2038819	0.2030906
	CR	0.0344447	0.067461	0.0873143	0.1177667	0.1828588	0.2159782	0.2308962
	PBB	1800	1700	1800	1700	1700	1900	1500
	HHI	1434.778	1294.765	1294.838	1144.572	1137.376	1115.545	1485.55
KOSOVA	NIM	0.7630628	0.7328993	0.6776599	0.6713399	0.6828756	0.6545087	0.6523733
	PP	0.6347602	0.6642929	0.6236193	0.6403398	0.6701676	0.6753605	0.6484026
	QR	0.1327019	0.1160865	0.1036952	0.1014902	0.0975691	0.0993555	0.0980563
	LQ	0.3484518	0.2947414	0.2943228	0.2689991	0.2239406	0.1898157	0.2007911
	CR	0.0257042	0.1852814	0.1711113	0.1752991	0.0622752	0.0765404	0.088127
	PBB	7109	6509	6709	5809	5709	5709	4709
	HHI	4543.118	3407.827	3501.654	2540.437	2394.219	2279.569	2206.877


MAQEDONIA	NIM	0.6557179	0.5124378	0.5926669	0.5906714	0.572638	0.54948	0.55689
	PP	0.5632497	0.6007928	0.555849	0.5585912	0.5396466	0.5410019	0.5643761
	QR	0.250636	0.2392603	0.2068295	0.1587951	0.14948	0.1318898	0.1233387
	LQ	0.366849	0.3819532	0.3045648	0.3098682	0.3228123	0.2994429	0.247264
	CR	0.2008881	0.1439583	0.2402556	0.2414349	0.2552641	0.3429634	0.4069386
	PBB	10100	9609	10100	9309	9309	9809	8209
	HHI	2201.008	1993.73	2041.536	2004.023	2212.055	1720.2	1541.157
SERBIA	NIM	0.5983732	0.6005541	0.5885016	0.575656	0.556715	0.5716497	0.5735911
	PP	0.5665804	0.6024053	0.5831953	0.6592066	0.6530088	0.6736619	0.6484488
	QR	0.2471153	0.2554404	0.2150295	0.1943361	0.1993261	0.1873446	0.1909669
	LQ	0.410599	0.2979505	0.2705072	0.1793588	0.1779343	0.1849543	0.207402
	CR	0.1159482	0.0736636	0.1012821	0.0813097	0.1921	0.2441552	0.2682886
	PBB	4610	4110	4610	3910	4310	4910	4000
	HHI	1985.229	1491.617	1544.475	1287.946	1503.877	1382.053	1435.77

Tabela nr.18. Mesatararja aritmetike e variablave sipas shteteve dhe viteve


Grafiku nr.24. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2007, sipas shteteve




Grafiku nr.25. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2008, sipas shteteve




Grafiku nr.26. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2009, sipas shteteve




Grafiku nr.27. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2010, sipas shteteve




Grafiku nr.28. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2011, sipas shteteve




Grafiku nr.29. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2012, sipas shteteve




Grafiku nr.30. Mesatarja e variablave me karakter bankar për vitin 2013, sipas shteteve



Grafiku nr.31. Mesatarja e PBB-së, sipas shteteve dhe viteve



Grafiku nr.32. Mesatarja e HHI-së, sipas shteteve dhe viteve



Duke arritur në përfundim të analizës statistikore mund të themi se paraqet një pjesë të veçantë të të hulumtimit, sepse përfshihen të gjitha variablat, kështu duke na mundësuar krahasimin e tyre me shtete nëpër vite. Por rolin dhe kontributin më të madh të këtij punimi do t'a jap analiza e regresionit e cila do të paraqitet në vijim.

6.2.2. Rezultatet nga analiza e regresionit

Analiza e regresionit paraqitet në dy modele: Modeli statik dhe dinamik. Modeli statik përfshin katër ekuacione (tabela nr.19). Në ekuacionin e parë llogariten variablat e pavarura me karakter bankar, siç janë: PP, QR, LQ, CR, OE, dhe S., kundrejt variablit të varur NIM. Pastaj tek ekuacioni i dytë shtohet variabli i pavarur me karakter makroekonomik, ai i

zhvillimit ekonomik që matet me PBB-në. Përderisa në ekuacionin e tretë paraqitet variabli tjetër i pavarur që tregon stukturën e tregut (HHI). Dhe në fund të modelit statik paraqitet ekuacioni i katërt që paraqet variablin e pavarur mbi pronësinë e kapitalit të bankave.

Tabela nr.19. Rezultatet ekonometrike, sipas modelit statik

Variablat e pavarura	Ekuacioni 1	Ekuacioni 2	Ekuacioni 3	Ekuacioni 4
PP	0.211*** (0.047)	0.218*** (0.049)	0.219*** (0.049)	0.220*** (0.049)
QR	0.597*** (0.075)	0.603*** (0.075)	0.603*** (0.076)	0.602*** (0.075)
LQ	0.093** (0.042)	0.098** (0.042)	0.100** (0.042)	0.100** (0.042)
CR	0.222*** (0.049)	0.213*** (0.046)	0.216*** (0.048)	0.211*** (0.045)
OE	0.116*** (0.011)	0.119*** (0.014)	0.111*** (0.015)	0.110*** (0.014)
S	0.354*** (0.055)	0.350*** (0.054)	0.352*** (0.055)	0.349*** (0.054)
PBB		-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)
HHI			-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)
O				0.315*** (0.032)
Konstantja	0.754*** (0.075)	0.763*** (0.075)	0.771*** (0.077)	0.782*** (0.063)
R ²	0.715	0.715	0.711	0.707
Wald chi ²	155***	154***	150***	150***

*Gabimet standarde janë dhënë në shprehje, me *** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 1%, ** në nivelin 5% dhe * në nivelin 10%.*

Modeli i dytë është modeli dinamik i cili përfshinë gjithë variablat sikurse modeli statik. Gjithashtu, edhe ky model përbëhet nga katër ekuacione. Dallon nga modeli statik sepse këtu paraqiten shtetet dhe bëhet krahasimi i tyre. (Tabela 20). Si shtet referues në modelin dinamik është marr Shqipëria kundrejt shteteve tjera.

Tabela nr.20. Rezultatet ekonometrike, modeli dinamik sipas shteteve

Variablat e pavarura	Ekuacion	Ekuacion	Ekuacion	Ekuacion
	1	2	3	4
PP	0.221*** (0.047)	0.185*** (0.049)	0.187*** (0.049)	0.188*** (0.050)
QR	0.597*** (0.075)	0.606*** (0.080)	0.605*** (0.080)	0.605*** (0.080)
LQ	0.093** (0.042)	0.091** (0.043)	0.084** (0.042)	0.084** (0.042)
CR	0.212*** (0.042)	0.217*** (0.048)	0.219*** (0.044)	0.221*** (0.041)
OE	0.114*** (0.020)	0.117*** (0.021)	0.116*** (0.021)	0.117*** (0.022)
S	0.350*** (0.054)	0.343*** (0.050)	0.341*** (0.050)	0.339*** (0.049)
PBB		-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)
BOSNIA dhe HERZEGOVINA		0.091*** (0.029)	0.089*** (0.029)	0.088*** (0.029)
KOSOVA		0.150*** (0.040)	0.157*** (0.041)	0.158*** (0.042)
MAQEDONIA		0.129*** (0.033)	0.132*** (0.033)	0.132*** (0.033)
SERBIA		0.164** (0.065)	0.162** (0.065)	0.161** (0.065)
HHI			-0.000 (0.000)	-0.000 (0.000)
O				0.414*** (0.061)
Konstantja	0.754*** (0.075)	0.736*** (0.077)	0.743*** (0.060)	0.753*** (0.062)
R ²	0.715	0.737	0.738	0.735
Wald chi ²	117***	116***	115***	115***

Gabimet standarde janë dhënë në shprehje, me *** tregon rëndësinë statistikore në nivelin 1%, ** në nivelin 5% dhe * në nivelin 10%.

6.3. Testimi i hipotezave dhe analiza e gjetjeve

Nga analiza e regresionit, në tabelat e lartëshënuara janë paraqitur këto rezultate ekonometrike: Faktori me i rëndësishëm në ndikim në NIM ka dal variabli qëndrimi ndaj rrezikut (QR) apo kapitali në raport me mjetet totale. Vlera e tij në model është .597 dhe arrin vlerën .605, paraqitet me vlerën më të madhe dhe identifikohet si faktor i rëndësishëm. Që do të thotë se bankat me mjaftueshmëri të konsiderueshme të kapitalit po përballen me rrezik më të ulët të falimentimit duke ulur kështu kostot e tyre të financimit dhe janë në gjendje të kenë marzhe më të larta duke u ngarkuar me më shumë kredi apo të paguajnë më pak për depozitat. Për më shume, mbajtja e kapitalit të tepërt është një mjet për bankat që të sinjalizojnë aftësinë paguese dhe aftësinë kreditore dhe të frymëzojnë besimin e depozituesve, veçanërisht në vendet e Ballkanit. Me një vlerë përafërsisht konstante rreth .350 - .400 dhe me ndikim në NIM rezultojnë faktorët, siç janë: madhësia (S) dhe pronësia e bankës (O). Vlerësohen si faktorë të rëndësishëm që do të thotë se bankat me pronësi të huaj dhe njëkohësisht bankat e mëdha kanë prirje në rritjen e marzhit neto të normave të interesit në krahasim me bankat e vogla dhe me pronësi vendore. Faktorë tjerë me ndikim në NIM dhe të rëndësishëm janë vlerësuar edhe performanca e portfolios (PP) apo raporti i kredive me mjetet totale dhe rreziku kreditiv (CR) apo kredite joperformuese në raport me kredite bruto. Sa më të lartë rreziku nga humbja e kredive, kemi rritje të normave të interesit. Poashtu shpenzimet operative (OE), kanë dal si faktor i rëndësishëm në NIM. Faktorë të rëndësishëm por me ndikim më të vogël ka dal rreziku i likuiditetit (LQ). Ndërsa faktorë pa ndikim, me vlera barazi me zero, është vlerësuar, PBB-ja dhe HHI-ja. Që do të thotë se ekonomia dhe konkurrenca nuk janë faktorë relativisht të lartë në ndikimin e

normave të interesit. Nëse ia hedhim një sy shteteve, tek modeli dinamik shihet se gati të gjitha shtetet kanë dalur signifikan.

Që mos të paraqiten 8 ekuacione veç e veç, si rezultat nga analiza ekonometrike mund të nxjerrim një ekuacion përmbljedhës dhe ky ekuacion do të duket kështu:

$$NIM_{it} = 0.782 + 0.220 \cdot PP + 0.602 \cdot QR + 0.100 \cdot LQ + 0.211 \cdot CR + 0.110 \cdot OE + 0.349 \cdot S + 0.315 \cdot O + 0 \cdot PBB_{it} + 0 \cdot HHI + 1 \cdot X_1 + 0.088 \cdot X_2 + 0.158 \cdot X_3 + 0.132 \cdot X_4 + 0.161 \cdot X_5$$

Nga ekuacioni shohim se konstantaja ka vlerë prej .782, variabli më i ndikueshëm në NIM është qëndrueshmëria e rrezikut me vlerë prej .602, pastaj e kemi madhësinë e bankave me vlerë prej .349, pronësia me .315, performance e portfolios me .220, rreziku kreditor me .211, shpenzimet operative me .110 dhe rreziku i likuiditetit me .100. Meqenëse të gjitha variablat kanë shenjë pozitive, kjo tregon se me rritjen e këtyre variablave, rritet marzhi neto i interesit. Me zero ndikim në NIM është ekonomia dhe struktura e tregut. Shqipëria si shtet referues është vlerësuar me 1, kundrejt NIM-it ndikimin më të madh e ka shteti i Serbisë me .161, pastaj Kosova .158, Maqedonia .158 dhe Bosnja e Hercegovina me .088.

Testimi i hipotezave është bërë përmes testit R^2 dhe Wald χ^2 . Nga rezultatet e paraqitura në tabelë shihet se R^2 gati në të gjitha ekuacionet ka dal mbi 70%, që do të thotë se modeli është përfaqësues dhe variablat në mes vete kanë korelacion. Sa i përket multikolinearitetit të testuar sipas VIF (Variance Inflation Factors), rezulton me vlerë prej 5.16 që nënkupton se variablat kanë ndërlidhje të mire dhe se modeli është përfaqësues.

Duke i barazuar gjitha parametrat e β me zero ($\beta=0$), testi Wald χ^2 e hudh poshtë hipotezën zero dhe i jep vlerë signifikante hipotezës alternative. Vlerat e Wald χ^2 testit tek modeli i parë sillen prej 150-155, kurse te modeli i dytë 115-117.

Me këtë mund të konkludojmë se hipotezat e lartëshënuara janë testuar duke vënë në pah këto gjetje:

Gjetja 1: Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit (raporti i kapitalit rregullator ndaj mjeteve të peshuara me rrezikun) është faktori kryesor rritës i marzhit neto të normave të interesit në vende si Kosova. Sipas rezultateve të regresionit, parametri i vlerësuar (0.6 në ekuacionin 4) është statistikisht i rëndësishëm dhe më i larti në vlerë krahasuar me parametrat e faktorëve të tjerë të rrezikut.

Nëse bëjmë një simulim të thjeshtë nisur nga të dhënat aktuale të nivelit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar në Kosovë. Në vitin 2015 niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit në Kosovë ishte 19%, ndërsa niveli minimal i kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës është 12%. Rezultatet tona tregojnë se, në kushtet aktuale dhe për faktorët e tjerë të pandryshuar, një rritje prej 1% e kapitalit rregullator ndaj mjeteve të peshuara me rrezikun, sjell përafërsisht një rritje të marzhit neto të normave të interesit (kundrejt totalit të mjeteve) prej: $0.6 * 0.01 = 0.006$ ose 0.6%

Ky ndikim është rreth tre herë më i lartë se sa ndikimi i faktorit të rrezikut të kredisë (0.21 në ekuacionin 4) që përbën një faktor tjetër të rëndësishëm ndikues në rritjen e marzhit neto të normave të interesit.

Ky rezultat mbështet hipotezën tone kryesore. Intuitivisht, ky rezultat mund të shpjegohet si më poshtë. Bankat me nivel relativisht më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit, perceptohen si më të sigurta dhe kjo gjë pëlqehet nga publiku. Kjo është arsyeja që bankat t'ia dalin që edhe të ulin kostot e financimit përmes uljes së interesave të depozitave por edhe që gjatë këtij procesi të mos kenë rrjedhje depozitash.

Gjetja 2: Bankat e mëdha e me pronësi të huaj kanë ndikim më të madh rritës në marzhin neto të normave të interesit në vendet e Ballkanit sesa bankat e vogla e me pronësi vendore. Parametrat përkatës, të vlerësuar përmes regresionit janë me shenjë pozitive, statistikisht të rëndësishëm dhe përkatësisht të barabartë me 0.349 dhe 0.315 (Shih rezultatet e regresionit 4). Pra ndikimi i madhësisë së bankës si edhe pronësisë së saj është afërsisht sa gjysma e ndikimit të kapitalit.

Gjetja 3: Performanca e portfolit, shpenzimet operative, rreziku i kredisë dhe ai i likuiditetit janë faktorë të tjerë ndikues në rritjen e marzhit neto të normave të interesit.

Gjetja 4: Shkalla përgjithësisht mesatare e konkurrencës nuk duket se e ka ndikuar marzhin neto të interesit. Rezultatet e regresionit (ekuacioni 4) tregojnë se vlera e parametratit është jo e ndryshme nga zero.

Përfundimisht mund të themi se, në bazë të vlerësimeve përmes regresionit, “përgjegjësit” kryesorë të marzhit neto të interesit në Kosovë janë sipas rendit zbritës: niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit (ose qendrueshmëria ndaj rrezikut), madhësia dhe pronësia e huaj e bankave, performanca e portofolit të kredive, rreziku i kreditit, shpenzimet operative dhe rreziku i likuiditetit.

6.4. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u paraqit analiza dhe rezultatet empirike të studimit. Rezultatet empirike u paraqiten përmes analizës statistikore deskriptive, korrelacione dhe analizës së regresionit. Poashtu në këtë kapitull, u testuan hipotezat përmes testit R^2 dhe Wald χ^2 . Testimi i hipotezave të ngritura në fillim të punimit tregon se modeli i këtij punimi është gjithëpërfshirës dhe se variablat paraqesin korelacion të fortë mes vete. Kurse në fund të këtij kapitulli u analizuan gjetjet e punimit. Në bazë të rezultateve ekonometrike dhe testimit të hipotezave, ky punim vë në pah këto gjetje: 1) Faktori më influencues që i jep përgjigje hipotezës bazë është kapitali bankar. Me këtë nënkuptojmë se mbajtja e nivelit të lartë të kapitalit ndikon në lartësinë e marzhit neto të normave të interesit. 2) Bankat e mëdha dhe me pronësi të huaj kanë ndikim më të madh në marzhin neto të normave të interesit sesa bankat e vogla me pronësi vendore. 3) Efektet e performancës së portfolios, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit janë pozitive kundrejt marzheve neto të normave të interesit. Dhe me rritjen e këtyre variablave rritet edhe marzhi neto i normës së interesit. 4) Shkalla e konkurrencës, rezulton me shkallë jo relativisht të lartë. Me këtë nënkuptojmë se shkalla jo e lartë e konkurrencës ndikon në rritjen e marzheve të normave të interesit. Duke testuar hipotezat dhe duke vënë në pah gjetjet e punimit në vijim do paraqiten përfundimet dhe rekomandimet e punimit.

VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Me anë të këtij studimi arritëm në përfundim se normat e interesit kanë rëndësi të veçantë dhe konsiderohen si burimi kryesor i kanalizimit të fondeve nga ana e individëve dhe bizneseve, sidomos në vendet me fazë tranzicioni. Rëndësia që ka industria bankare për zhvillimin dhe stabilitetin e çdo ekonomie u konfirmua edhe një herë nga kriza e fundit globale. Ishin pikërisht zhvillimet në sektorin bankar të cilat me shpejtësi u përhapën në pjesët tjera të sistemit financiar duke shkaktuar krizë financiare, e cila pastaj u shndërrua në krizë të përgjithshme ekonomike. Disa nga shtetet e Ballkanit të hulumtuara në këtë studim janë: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia.

Ekonomitë e tilla janë përballur më vështirësi të shumëta gjatë transformimit të sistemeve të tyre të dobëta, të pazhvilluara dhe të cekëta financiarisht. Në shumicën e vendeve të Ballkanit e sidomos në Kosovë dhe Shqipëri sistemi bankar ka përjetuar kalimin nga një sistem monobankar drejt atij me dy nivele, procesin e privatizimit të bankave shtetërore, liberalizimin e normave të interesit dhe kredidhënies, prezantimin e instrumenteve indirekte të politikës monetare, forcimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës, hapjen ndaj hyrjes së institucioneve financiare të huaja dhe së fundmi, edhe shkrirjet e bashkimet e bankave. Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar në cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrojnë, në eficiencën e funksionimit të bankave, në nivelin e konkurrencës me të cilën ato ndeshen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përditshme dhe në kostot e ndërmjetësimit ndër vite. Ndryshimet e shumëta gjatë kësaj periudhe e deri me sot, i bëjnë sektorët bankarë të këtyre vendeve një fushë e veçantë studimi. Poashtu, ndryshimet e shumëta po bëjnë që gjenda e normave të interesit të jetë akoma e lartë. Prandaj, në këtë studim u analizuan të dhënat e

bankave komerciale që operojnë në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit, për periudhën 2007-2013. Kuadri teorik ka qenë mjaft i gjerë, kryesisht nga literatura e huaj, pjesa kryesore e saj u ndërtua në tre faza. Faza e parë identifikimi i teorive, faktorëve dhe rezultateve empirike të studiuesëve tjerë. Faza e dytë analizimi dhe krahasimi i literaturës së identifikuar dhe faza e tretë paraqitja dhe harmonizimi i faktorëve me ekonomite e vendeve të Ballkanit. Aspekti teorik i këtij punimi jap vështrim analitik mbi normat e interesit. Analiza mbi normat e interesit fillon me shpjegimin e debateve, shkollat, teoritë dhe dallimet e tyre. Teoritë kryesore të normave të interesit, të shtjelluara në punim janë: Teoria e Shkollës Austriake; Teoria Neoklasike; Teoria e likuiditetit, dhe Teoria e Huasë. Dallimet e teorive kryesore të normës së interesit i kemi grupuar në këto elemente, si: Esenca e shpjegimit; Fjalët/Konceptet kyçe; Kuptimi dhe definimi i normës së interesit; Supozimet nistore; Variablat e pavarur (faktorët influencues të normës së interesit); Marrëdhëniet që trajtojnë dhe hipotezat që ngrenë; Mekanizmi veprues në themel të procesit dhe modeli shkak-pasojë që sugjerojnë dhe Zgjidhjet që ofrohen dhe politikat që sugjerohen të zbatohen. Trajtimi teorik vazhdon të zgjerohet në përcaktuesitë e marzhit neto të normave të interesit, kështu duke i hulumtuar dhe studiuar: konceptet, hipotezat, modelet, analizat, metodat, variablat dhe fazat e studimit, në mënyrë që t'i përshtatem ekonomive në studim. Për identifikimin dhe analizën e faktorëve që përcaktojnë marzhin neto të interesave në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit, u përdoren dy analiza. E para, është analiza sipas zbërthimit kontabël të marzhit neto të interesave dhe e dyta, ka të bëjë me një trajtim teorik të faktorëve ndikues që më pas aplikohen edhe në praktikë nëpërmjet analizave ekonometrike. Sipas kuadrit teorik marzhi neto i normave të interesit ndikohet nga karakteristikat bankar, të tregut dhe makroekonomik. Në kuadër të karakterisitkave

bankare hyjnë: *Performanca e portfoliosë*, e cila matet nga raporti i kredive ndaj mjeteve totale. (Clayes, 2007). *Qëndrimi ndaj rrezikut*, që paraqet raportin e kapitalit me totalin e mjeteve. (Maudos dhe Fernández deGuevara, 2004; Angbazo, 1997; Saunders dhe Schumacher, 2000; Drakos, 2002, Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sologoub, 2006). *Rreziku i likuiditetit* përcaktohet nga aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve. (Angbazo, 1997; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004). *Rreziku i kredise* që paraqet raportin e kredive me probleme ndaj totalit të bruto kredive. (Drakos, 2002, Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004). *Shpenzimet operative* te llogaritura në raport me totalin e mjeteve. (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999, Abreu dhe Mendes, 2003, Demirgüç-Kunt dhe të tjerët, 2004; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007). *Madhësia e bankave* e llogaritur sipas madhësisë së aseteve. (Naceur, 2003; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Gual, 1999) *Pronësia* e bankave paraqet variablin e fundit në kuadër të karakteristikave bankare; (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999; Martinez Peria dhe Mody, 2004; Demirgüç-Kunt et al., 2004; Sapienza, 2002). Përveç analizës të kuadrit teorik të karakteristikave bankare, kemi edhe karakteristikat e tregut dhe makroekonomik. Në kuadër të karakteristikave të tregut kemi variablin *struktura e tregut* e shprehur përmes HHI-së, e vlerësuar kështu nga shumë autore të ndryshëm. (Berger, 1995b; Carbo dhe Rodriguez, 2007; Demsetz, 1973; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Maudos dhe Fernández de Guevara, 2004; Martinez Peria dhe Mody ,2004). Kurse në kuadër të karaktersitikave makroekonomikë kemi PBB-në (Demirgüç-Kunt dhe Huizinga, 1999 dhe Demirgüç-Kunt et al., 2004 ; Brock dhe Suarez, 2000; Claeyss dhe Vander Vennet, 2007; Vein, Carbo dhe Rodriguez, 2007; Drakos, 2002). Pas këtij

trajtimi teorik mbi normën e interesit dhe përcaktuesëve të saj, analiza u përqendrua mbi paraqitjen e sektorit banakar në Kosovë dhe normat e interesit, e më pas në paraqitjen dhe vlerësimin ekonometrik të faktorëve që ndikojnë variablin e varur, përkatësisht marzhin neto të normave të interesit në vendet e Ballkanit.

Në bazë të rezultateve ekonometrike dhe testimit të hipotezave, ky punim vë në pah këto gjetje: 1) Faktori më influencues që i jep përgjigje hipotezës bazë është kapitali bankar. Me këtë nënkuptojmë se mbajtja e nivelit të lartë të kapitalit ndikon në lartësinë e marzhit neto të normave të interesit. 2) Bankat e mëdha dhe me pronësi të huaj kanë ndikim më të madh në marzhin neto të normave të interesit sesa bankat e vogla me pronësi vendore. 3) Efektet e performancës së portfolios, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit janë pozitive kundrejt marzheve neto të normave të interesit. Dhe me rritjen e këtyre variablave rritet edhe marzhi neto i normës së interesit. 4) Shkalla e konkurrencës, rezulton me shkallë jo relativisht të lartë. Me këtë nënkuptojmë se shkalla jo e lartë e konkurrencës ndikon në rritjen e marzheve të normave të interesit.

Ky studim jo vetëm që do t'i ofrojë një punim të ri literaturës së shkruar rreth faktorëve që përcaktojnë marzhin neto të normave të interesave, por edhe do të jap kontributin e një punimi të parë për rastin e vendeve të Ballkanit për këtë periudhë. Në punim para se të paraqiten të dhënat mbi përcaktuesitë e marzhit neto të interesit është diskutuar çështja mbi sektorin banakar në Kosovë dhe normat e interesit, si një analizë e veçantë e këtij studimi. Nga përfundimi i këtij kapitulli, erdha në përfundim se sektori banakar në Kosovë për dallim nga vendet tjera të rajonit, të cilat u deshën të ndjekin një proces të gjatë e të vështirë të tranzicionit të sektorit banakar nga sistemi i ekonomisë së centralizuar drejtë ekonomisë së tregut, Kosova u gjend në një situatë më ndryshe duke mos trashëguar asgjë nga sistemi

financiar i kaluar. Në njëërën anë, kjo paraqiste një disavantazh të theksuar me që gjithëçka rreth funksionalizimit të sektorit bankar dhe financiar në përgjithësi duhej të nisej nga e para, gjë që paraqiste një proces mjaft sfidues. Në anën tjetër, e gjithë kjo ka paraqitur një përparësi me që u mundësua krijimi i një sistemi financiar i cili që nga fillimi u bazua në parimet e ekonomisë së tregut dhe evitoi problemet me të cilat u ballafaquan shtetet tjera. Në këtë kontekst, Kosova që nga fillimi u përcaktua për një sektor bankar të bazuar në pronësinë private dhe i hapi dyert hyrjes së bankave të huaja, të cilat, përveç kapitalit, sollën edhe praktikat bashkëkohore të afarizmit bankar, duke mundësuar kështu një konvergjim më të shpejtë të industrisë bankare të Kosovës drejtë atyre të vendeve me përvojë më të gjatë në këtë fushë. Zhvillimi i sektorit bankar të Kosovës gjatë kë- tyre 15 viteve me të drejtë është konsideruar si “tregim i suksesshëm”. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar ka shërbyer si burim shumë i rëndësishëm i financimit për ekonominë e vendit. Përkundër se është sektori më i ri bankar në gjithë rajonin, sektori bankar i Kosovës ka një karakteristikë të veçantë dalluese, e që është niveli i lartë i stabilitetit që e ka karakterizuar prej fillimit të funksionimit të tij e që vazhdon edhe tani. Ky sektor në vazhdimësi ka gëzuar pozitë të kënaqëshme likuiditeti, cilësi të mirë të portofolit kreditor si dhe nivel të lartë të kapitalizimit. Me gjithë arritjet e deritanishme, sektorin bankar të Kosovës e presin sfida të mëtutjeshme për të avancuar rolin e tij në përkrahjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të kreditimit, raporti ndërmjet kredive dhe produktit të brendshëm bruto në Kosovë vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me vendet tjera, duke sugjeruar kështu se ka hapësirë për zgjerim të mëtutjeshëm të ndërmjetësimit financiar. Kreditimi i deritanishëm ka qenë kryesisht i koncentruar në sektorin e tregtisë, mirëpo kërkohet një zgjerim më i shpejtë i kreditimit edhe për sektorët

tjerë, siç janë prodhimtaria e bujqësia, sektorë këta që kanë rëndësi të madhe për përsheptimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Rritja e kreditimit për këta sektorë pa dyshim se varet edhe nga vetë zhvillimi i këtyre sektorëve, por një parakusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tyre është pikërisht financimi. Në këtë kontekst, bankat duhet të ndjejnë përgjegjësinë për të rritur përkrahjen ndaj sektorëve më pak të zhvilluar të ekonomisë, gjë e cila do të ndikojë edhe në rritjen e tregut për vetë bankat si dhe do të përmirësojë ambientin e përgjithshëm ku ato operojnë. Në këtë aspekt, mes tjerash, bankat mund të japin kontribut të rëndësishëm përmes aktiviteteve të ndryshme të edukimit dhe trajnimit, duke ndihmuar përgatitjen e këtyre sektorëve në përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga bankat për kreditim. Në vitet e fundit, kreditimi nga sektori bankar është karakterizuar me ngadalësim të vazhdueshëm të normës së rritjes, përderisa depozitat kanë vazhduar të rriten me trend mjaft të qëndrueshëm. Kjo tregon se kemi të bëjmë me tërheqje të likuiditetit nga ekonomia, gjë e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Andaj, bankat duhet të reflektojnë me kujdes ndaj këtyre zhvillimeve, duke marrë masa që sigurojnë kreditim të qëndrueshëm për ekonominë e vendit dhe rritje të kërkesës. Sektori bankar në Kosovë mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës, si pasardhëse e Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (ABPK). Bankat komerciale janë sektori më i rëndësishëm i sektorit financiar në Kosovë. Janë gjishtej dhjetë banka komerciale. Veprimtari e tyre është e shtrirë në gjithë territorin e Kosovës. Produktet dhe shërbimet e bankave komerciale në Kosovë përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Në mënyrë të specifikuar, bankat në Kosovë ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve dhe shërbimeve bankare. Edhe pse shumica e këtyre

produkteve hyjnë në grupin e shërbimeve klasike bankare, kohëve të fundit bankat kanë filluar zgjerimin gamës së shërbimeve të tyre me disa risi për tregun, të tilla si Lizingu, Shërbimet bankare elektronike (Mobile Banking) dhe shërbime të tjera. Bankat me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara që operojnë në vend, tetë janë me pronësi të huaj. Bankat me pronësi të huaj, udhëheqin me 89.8 përqind të gjithsej aseteve dhe zotëruan me 91.9 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar ka vazhduar trendin rënës në asete dhe kredi, dhe po ashtu në depozita për dallim nga vitet paraprake kur shkalla e koncentrimit të tregut në depozita kishte shënuar rritje. Rënia e koncentrimit në asete ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të aseteve të tri bankave më të mëdha. Ndërkaq, rënia e shkallës së koncentrimit në depozita erdhi si pasojë e rënies së depozitave në dy nga bankat më të mëdha, krahasuar me rritjen më të lartë të nivelit të depozitave në bankat tjera. Kreditë zënë pjesën më të madhe të strukturës së aseteve, ndërsa struktura e detyrimeve dominohet kryesisht nga depozitat e sektorit bankar në Kosovë. Edhe pse rezultatet tregojnë se normat e interesit të të dy faktorëve kanë shënuar rënie, mund të themi se gjendja aktuale e të zhvilluarit biznes apo investim nuk është fare e kënaqshme. Normat e interesit të kredive akoma konsiderohen të larta ndërsa normat e interesit të depozitave konsiderohen tepër të ulëta, gati fare pa interes. Normat e ulëta të interesit të depozitave erdhën si rezultat i likuiditetit të tepruar nga ana e bankave në Kosovë. Ndërsa normat e larta të interesit të kredive po qëndrojnë si pasojë e shumë faktorëve si, ekonomia joformale, problemet me sistemin kadastral, mosfunksionimi i gjykatave, pamundësia e BQK-së për të injektuar likuiditet, jo raportimet financiare nga ana e bizneseve, e të tjera. Sa më të zhvilluar dhe e

qwndrueshme ekonomia, tentohet tw ipet mw shume kredi dhe normat do tw uleshin, dhe anasjelltas. Gjendja ekonomike perdoret si argument dhe kritikë ndaj bankave për uljen e normave të interesit. Sidoqoftë, këtu tejkalohet një fakt shumë i rëndësishëm, se midis gjendjes së rëndë ekonomike dhe bankave duhet të jetë dhe shteti funksional. Prandaj, normat e interesit përcaktohen nga faktorë të shumtë, e ndër themeloret janë stabiliteti ekonomik dhe politik i vendit, e që fatkeqësisht Kosova nuk qëndron në nivelin e kënaqshëm. Qeveria e Kosovës nuk po bën shumë në përmirësimin e gjendjes aktuale. Një pjesë të fajit e bartin edhe vetë bizneset me ikjen nga tatimet, me çka po kontribuojnë në rritjen e rrezikut kreditor e cila po i mban të larta normat e interesit. Përmirësimi i ambientit të biznesit është faktor themelor për zvogëlimin e rrezikut kreditor, si një ndër përcaktuesit kyç të normës së interesit në kredi. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor medoemos do ta lehtësonte ekzekutimin e kolateralit dhe hipotekës. Duhet theksuar gjithashtu se Kosova përballlet edhe me probleme në sistemin kadastral, sidomos me objektet e reja të ndërtuara, të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrat kadastrale dhe si rezultat nuk mund të përdoren si hipotekë. Edhe përmirësimi i raportimit financiar nga vetë bizneset, aplikimi i arkave fiskale, do të ndikonte pozitivisht në rritjen e besimit të bankave ndaj këtyre bizneseve duke ndikuar kështu në zvogëlimin e shpenzimeve për monitorimin e raporteve financiare të bizneseve nga bankat. Normat e kredive vazhdojnë të mbesin të larta. Bankat e kanë të vështirë të funksionojnë në një ambient afarist dhe politik i cili nuk respekton ligjet në fuqi dhe gjykatat nuk kryejnë punën e tyre. Por në anën tjetër, edhe bankat kanë shfrytëzuar këtë ambient, duke mos respektuar vendimet e gjykatave. Marrëdhëniet banka-gjykata duhet të përmirësohen. Bankat duhet të respektojnë vendimet e gjykatave; si dhe gjykatat të jenë më efektive në rastet kur kanë të bëjnë me kthimin e kredive apo kolateralin. Përmirësimi i

marrëdhënieve banka-gjykata do ulte rrezikun për kthimin e kredive, e cila më pas do të mund të ndikonte në uljen e normave të interesit të kredive, nga e cila do të përfitonin të gjithë qytetarët. Institucionet publike nevojiten që t'u krijojnë bankave ambient të përshtatshëm të të bërit biznes. Disa nga fushat ku nevojitet ndërhyrja e menjëhershme e shtetit janë: përmirësimi i sistemit kadastral, fuqizimi i Administratës Tatimore të Kosovës, reformimi i sistemit gjyqësor, etj. Në anën tjetër, edhe bankat duhet të respektojnë vendimet e institucioneve shtetërore. Bankat duhet të respektojnë vendimet e organeve gjyqësore dhe këtë duhet ta bëjnë sipas udhëzimeve të vendosura nga BQK. Një shpjegim tjetër, që është mjaft kredibil, është se bankat aktuale në Kosovë dhe vendet e rajonit kanë ndërtuar një oligopol. Bankat kryesore dhe më të mëdha nuk përballen me konkurrencë serioze. Kolektivisht, atyre u intereson mirëmbajtja e kësaj gjendjeje nga e cila ata nxjerrin përfitime të mëdha nga një ekonomi e varfër. Por një gjë është e qartë, se këto banka, dhe sistemi financiar në përgjithësi, nuk po vepron në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Pjesa empirike e punimit ka për qëllim të analizojë faktorët influencues në marzhet e normave të interesit dhe të tregojë marrëdhënien e tyre kundrejt këtij treguesi. Punimi jap përgjigje në disa pyetje kërkimore. Pyetja qendrore e punimit është: Cili është faktori më i rëndësishëm dhe influencues tek marzhet neto të normave të interesit në vendet e Ballkanit? Ndërsa pyetjet sekondare të punimit janë: a) Cilat janë efektet e shpenzimeve operative, raportit kredi/mjetet totale, raportit kredi jo performuese/kreditë bruto, dhe raportit mjete likuide/mjetet totale tek marzhet neto të normave të interesit?; b) Kush ndikon në rritjen e marzhit neto të normave të interesit me shumë: bankat e mëdha me pronësi të huaj apo bankat e vogla me pronësi vendore?; Dhe c) A është shkalla relativisht

jo e lartë e konkurrencës në sistemin bankar një nga faktorët e rritjes së marzhit të normave të interesit?

Punimi teston këto hipoteza: Hipoteza bazë e këtij punimi është: Mbajtja e nivelitë të lartë të kapitalit nga ana e bankave ndikon në rritjen e marzhit neto të normave të interesit. Hipoteza 2: Efektet e performancës së portfolios, shpenzimeve operative, rrezikut të kredisë dhe likuiditetit janë pozitive kundrejt marzheve neto të normave të interesit. Hipoteza 3: Bankat e mëdha me pronësi të huaj kanë marzhe më të larta në kahasim me bankat e vogla me pronësi vendore. Hipoteza 4: Rritja e konkurrencës bankare ndikon në uljen e marzhit neto të normës së interesit.

Trajtimi i parë teorik lidhur me marzhin neto të normave të interesave është aplikuar në modelin e ndërmjetësimit nga Ho & Saunders (1981) me qasje dyfazore, prej edhe nga është bazuar modeli i këtij punimi. Më pas, autorë të tjerë McShane dhe Sharpe 1985, Angbazo 1997 dhe Maudos e Fernández de Guevara 2004, kanë aplikuar modelin njëfazësh për përcaktimin e faktorëve që ndikojnë marzhin neto të interesave. Punimi ka karakter vlerësues. Të dhënat janë marrë nga Banscope dhe raportet vjetore të bankave qendrore të këtyre vendeve. Gjithashtu, ky studim përdor hulumtime të rëndësishme të Bankës botërore, FMN-së, Bankës Evropiane, dhe hulumtuesëve tjerë të kësaj lëmie e që janë paraqitur në punim. Ky studim jep analiza, udhëzime, njohuri bazë mbi përcaktuesitë e marzhit neto të interesit në vendet e Ballkanit. Supozohet se ky studim ka rëndësi të madhe për arsye se ju vjen në ndihmë bizenseve dhe individëve, njëkohësisht drejtuesëve dhe politikëbërësve për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sikurse çdo punim që i ka avantazhet dhe disavantazhet e veta, njëjtë vlen edhe për këtë punim. Peirudha 2003-2007

është një periudhë tranzicioni, me ç'rast është bërë hulumtimi. Kjo mund të konsiderohet njëfar mënyre si kufizim dhe mundësi e hulumtimit në të ardhmen për periudhen pas 2007 e në vijim. Pastaj, kufizim mund të konsiderohet numri i vende të Ballkanit të përfshira në punim me gjithsej 116 banka komerciale. Ku në të ardhmen është shumë mundësi e mirë të investigohet edhe një analize paneli për bankat dhe vendet e tjera. Gjetja, qasja dhe identifikimi i të dhënave në fillim ishte e veshtirë, përshkak të mungesës së një bazë të saktë të të dhënave dhe mungesës së disa karaktersitikave të bankave për vitet e hulumtuara mirëpo me ndihmën e pedagogut udhwheqws dhe kolegëve të punës u realizua kjo pjesë e hulumtimit. Të dhënat pasi që janë mbledhur, u përpunuan në programin excel duke i bartur si panel me metodën e efekteve të rastësishëme në programin STATA për vlerësim dhe nxjerrje rezultatesh. Testimi i hipotezave është bërë përmes testit R^2 dhe testit Fald χ^2 . Në studim janë përdorur 9 variabla shpjegues që mendohet se ndikojnë marzhin neto të interesave, nisur nga modeli teorik apo edhe studime empirike të të njëjtës natyrë. Siç u tha më lartë, variabli i varur është Marzhi nëto i normës së interesit, ndërsa variablat e pavarur janë Performanca e portfoliosë; Qëndrueshmëria ndaj rrezikut; Rreziku i likuiditetit; Rreziku i kredisë; Shpenzimet operative; Madhësia e bankës, Pronësia e kapitalit, Bruto Produkti i Brendshëm dhe Struktura e tregut.

Marzhi neto i interesit paraqet diferencën e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve nga interesi në raport me mjetet totale. Ndërsa sa i përketë variablave të pavarur me karakter bankar paraqesin këto raporte: Performanca e portfoliosë (PP) paraqet raportin e total kredive me mjetet totale; Qëndrimi ndaj rrezikut (QR) paraqet raportin e kapitalit me mjetet totale; Rreziku i likuiditetit (LQ) paraqet raportin e mjeteve likuide me mjetet totale;

Rreziku kreditor (CR) paraqet raportin e kredive joperformuese me total kreditë bruto; Shpenzimet operative (OE) paraqet raportin e total shpenzimeve nga jo interesat me mjetet totale dhe madhësia e bankave (S) është nxjerrur nga logaritmi i mjeteve totale të bankave. Pronesia (O) paraqet variabël “dummy”, që do të thotë se me numrin zero janë koduar bankat vendore ndërsa me numrin një janë koduar bankat e huaja. Variabli me karakter makroekonomik është ekonomia e matur me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) . Ndërsa variabli i fundit i përfshirë në model është stuktura e tregut, e matur me indeksinë e përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI) në terma të aseteve.

Metodat që janë përdorur në ëktë studim janë: ajo e analizës përshkruese, krahasuese dhe e regresionit. Analiza statistikore përshkruese më ka ndihmuar të gjej mesataren aritmetike dhe devijimin standard të variablit të varur dhe variablave të pavarura duke i karahasuar shtetet mes vete për periudhën shtatë vjeçare, 2007-2013. Përmes kësaj analize u testua përmes T-testit se banka me pronësi të huaj kanë prirje më të madhe në rritjen e marzheve neto të interesit se sa bankat me pronësi vendore. Analiza e regresionit më ndihmoi të paraqes rezultatet përfundimtare empirike, përmes dy tipe modelesh: modelit statik dhe atij dinamik. Që të dy modelet përmbajnë nga katër ekuacione. Ekuacioni i parë është i përgjithshëm dhe përfshin variablat me karakter bankar, përderisa ekuacionit të dytë i shtohet variabli me karakter makroekonomik – Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), kurse ekuacionit të tretë i shtohet variabli i strukturës së tregut i matur përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI). Ekuacioni i katërt dhe i fundit i përfshirë në model përfshin variablin e pronësisë së kapitalit. Nga ekuacionet që u vlerësuan u morën rezultate që në disa raste priteshin dhe disa të tjera ishin të ndryshme nga parashikimet.

Marzhi neto i interesave për bankat që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në vendet e Ballkanit, ka një varësi të lartë nga mbajtja e nivelit të lartë të kapitalit. Që do të thotë se bankat me mjaftueshmëri të konsiderueshme të kapitalit po përballen me rrezik më të ulët të falimentimit duke ulur kështu kostot e tyre të financimit dhe janë në gjendje të kenë marzhe më të larta duke u ngarkuar me më shumë kredi apo të paguajnë më pak për depozitat. Për më shume, mbajtja e kapitalit te tepruar është një mjet për bankat që të sinjalizojnë aftësinë paguese dhe aftësinë kreditore dhe të frymëzojnë besimin e depozitueseve, veçanërisht në vendet e Ballkanit.

Sistemi bankar në këto vende gjatë kësaj periudhe të studimit është karakterizuar me një rënie të kreditimit, kjo si pasojë se bankat siguruan një stabilitet dhe likuiditet. Një ndër arsyet e rënies së kreditimit konsiderohet edhe kriza globale e vitit 2007-2008, si pasojë e kredive hipotekare. Me ç'rast bankat në vendet e Ballkanit nuk u ndikuan edhe aq nga kjo krizë sa vendet e zhvilluara, mirëpo frika nga humbjet bëri që të shtrëngohen kushtet e kredidhënies dhe të bie kreditimi. Bankat komerciale të vendeve të Ballkanit kryesisht kanë pronësi të huaj se sa vendore. Një ndër faktorët që e ndikon lartësinë e marzhin neto të interesit është pronësia. Sipas rezultatet ekonometrike, bankat me pronësi të huaj priren të rritin marzhet e ndërmjetësimit më shumë se sa bankat me pronësi vendore, kjo për arsye ato përballen me kosto më të larta. Numri i të punësuarëve është më i lartë në këto banka, përbëjnë pjesën më të madhe të tregut, eksperiencat dhe trajnimet nga zyrtarët e bankave mëmë, kostot e marketingut, të gjitha këto bëjnë që bankat me pronësi të huaj të kenë kosto më të larta por në të njëjtën kohë gjenerojnë edhe të ardhura më të mëdha, kështu duke e rritur fitimin dhe marzhin neto të interesave në përgjithësi. Nëse do e ndërlihim komentimin lidhur me pronësinë e bankës, variabli tjetër që rrit marzhin neto të interesit

është edhe madhësia e bankës, e cila ka rezultuar pozitive në marzhet neto të interesit, që do të thotë se bankat e mëdha priren të kena marzhe më të larta të interesit në krahasim me bankat e vogëla. Në këto vende kryesisht bankat e mëdha janë bankat me pronësi të huaj, kurse bankat e vogëla janë bankat me pronësi vendore. Rritjen e marzhit neto të interesave në bankat komerciale të vendeve të Ballkanit e shkaktojnë edhe faktorë tjerë siç është performance e portfoliosë apo raporti i kredive me mjetet totale. Megjithatë, bankat shqiptare tregohen konservatore kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kapitalit të investuar nga aksionerët. Pavarësisht se kanë shfaqur agresivitet në zgjerimin e pjesës së tregut, ato përsëri kanë treguar kujdes për cilësinë e kredive të dhëna. Sa më shumë e kanë shtuar kapitalin (pasojë e kërkesave rregullative apo e zgjerimit të aktiviteteve që ofrojnë sipas niveleve të licencës), aq më të kujdesshme kanë qenë në përzgjedhjen e klientëve të tyre të kredisë, çka provohet edhe nga cilësia e mirë e portofolit të kredive për periudhën në fjalë. Në këto kushte, kur konkurrenca bëhet gjithnjë e më e fortë dhe kur niveli i kredive me probleme ka qenë i ulët (pavarësisht se ky tregues ka ardhur në rritje), bankat janë ndier më të sigurt në caktimin e marzheve duke shkaktuar rritjen e tyre si pasojë e rrezikut të kredisë. Pra, kreditë joperformuese janë poashtu një ndër shkaktarët e rritjes së marzheve të normave të interesit të bankave komerciale të vendeve të Ballkanit. Sa më e lartë rreziku nga humbja e kredive, kemi rritje të normave të interesit. Faktorë tjetër signifikant janë shpenzimet operative. Bankat kanë qenë shumë agresive në drejtim të zgjerimit me degë të reja në të gjitha vendet dhe kjo, ka rritur nivelin e shpenzimeve të veprimtarisë duke rezultuar në rritjen e marzhit të interesave. Rreziku i likuiditetit ka dalë si faktorë që ndikon në marzhin neto të interesit mirëpo me masë ndikimi më të vogël në krahasim me faktorët e sipërmendur. Kjo për shkak se bankat për momentin janë duke zotëruar likuiditet të

mjaftueshëm, sa që normat e interesit të depozitave janë në vlerë 0. Për momentin deponimi i mjeteve në banka nuk është në interesin e tyre. Faktorë pa ndikim, me vlera barazi me zero, sipas analizës së regresionit është vlerësuar, PBB-ja dhe HHI-ja. Që do të thotë se ekonomia dhe konkurrenca nuk janë faktorë relativisht të lartë në ndikimin e normave të interesit. Sipas rezultateve del se konkurrenca e bankave duhet të rritet në mënyrë që të kemi norma më të ulëta të interesit.

Sipas modelit dinamik të analiza e regresionit ku përshihen shtetet me më ndikim në marzhin neto të interesit, del se gati të gjitha shtetet kanë ndikim në NIM. Pra, të gjitha janë signifikant, pa marrë parasysh nëse ndonjërit shtet i ka dalur vlera në model më e ulët apo më e lartë.

Kuadri teorik dhe sidomos ai empirik përbëjnë kontributin kryesor të këtij punimi. Duke u bazuar nga ajo se çka u tha më lartë mund të arrijm në konkludim se kemi baza që normat e interesit të kredive me qenë të larta, duke u nisur nga shumë probleme që u cekën më lartë si: zhvillimi ekonomik, papunësia, jo funksionin i gjykatave, raportimi jo cilësor financiar nga ana e bizneseve, etj. Por përkundër kësaj egziston mundësia që bankat të ofrojnë mirëqenie me kosto më të ulëta, kështu duke e investuar nivelin e lartë të kapitalit qoftë në formë të transferimit në hua apo krijimit kushteve më të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Dëshira për maksimalizim të fitimit egziston çdo herë e sidomos në institucionet fitimprurëse por asnjëherë duke e tejkaluar objektivin dhe qëllimin e institucionit, sepse kjo shkakton humbje të besimit. Norma e interesit është një nga instrumentet e politikës monetare të një shteti. Prandaj, shteti përmes Bankës Qendore si mbikëqyrësi kryesor i sistemit financiar të një vendi, duhet të krijoj ekip të fortë punues i cili di të zbatojë politikën monetare dhe të ofroj zgjidhje të duhura për ekonominë e vendit

përmes instrumentëve të saj. Guvernatori dhe menaxhmenti i bankave qendrore nuk duhet të zgjidhet në baza partiake dhe të përfaqësojë interesat e individëve por duhet të zgjidhet me interes që të përfaqësojë interesat e vendit, shoqërisë dhe bankat qendrore të vendeve në hulumtim të kenë atë pavarësinë e vet në kontekst të lirisë për marrjen e vendimeve të duhura për një zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Shteti me institucionet e saj si qeveria, ministritë, banka qendrore, duhet të i kushtojnë rëndësi hyrjes së bankave të huaja në këto tregje, poashtu bankave të huaja egzistese të cilat e ngopën tregun me kredi me norma të majme, kështu duke e ngulfatur biznesin, familjen e ekonominë në përgjithësi. Bankat duhet të vazhdojnë t'i ulin kreditë jo performuese, shpenzimet në mënyrë që të ofrojnë cilësi e të funksionojnë si burim i mirëfillt i financimit. Duhet vetëdijësim e edukim nga ana e qytetarëve mbi procedurat, kushtet e proceset e bankës.

Pra, krejtësisht në fund, mund të themi se rezultatet e marra nga ky studim, mund t'i shërbejnë politikëbërësve për orientimin drejt çështjeve që kanë më shumë lidhje me faktorët përcaktues të marzhit neto të interesave. Një vëmendje më e madhe mund t'i kushtohet mbajtjes së nivelit të kapitalit, strukturës për nga pronësia dhe madhësia, nivelit të kredive joperformuese, nivelit të shpenzimeve operative, shkallës së konkurrencës, etj. Një qasje e tillë mund të jetë e dobishme për masat specifike të politikës ekonomike, duke marrë parasysh perspektiven e integritetit në BE dhe studiuesëve të tjerë që dëshirojnë të zgjerojnë këtë studim. Ky studim synoi të identifikojë faktorët që ndikojnë më shumë marzhin neto të interesave për rastin e sistemit bankar të vendeve të Ballkanit. Sikurse çdo studim, edhe ky i ka mundësitë dhe limitet e veta. Megjithatë, kjo punë e nisur mund të vazhdojë në të ardhmen me zgjerimin në drejtime të ndryshme për shembull, duke përfshirë në studim periudha më të gjata kohore. Me zgjatjen e serisë së të dhënave, mund

të mundësohet edhe përfshirja e variablave të tjerë sidomos të natyrës së çështjeve makroekonomike, rregullative e ligjore. Çdo punë e nisur mund të përfundohet kur ke besim e vullnet, besojm fuqishëm se një ditë edhe ne si qytetar të këtyre vendeve do t'i gëzojm të drejtat sikurse gjithë qytetarët e vendeve të zhvilluara. Besojm se bankat do të ofrojnë kushte më të favorshme që të ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm ndaj brezave të rinjë, në këtë mënyrë duke i zvogëluar normat e interesit të kredive dhe rritjes së normës së interesit. Besojm se shteti dhe institucionet tjera do të jenë shtylla kryesore për hartimin dhe zbatimin e strategjive për një ambient të krijuar dhe të kënaqur për nevojat e qytetarëve të saj.

BIBLIOGRAFIA

- A.N, B. (1995). The profit - structure relationship in banking: Tests of market-power and efficientstructure hypotheses. *Journal of Money, Credit, and Banking* 27, 404-431.
- Abreu, M. M. (2003). Do Macro-Financial variables matter for European bank interest margins and profitability? *Financial Management Association International*.
- Afanasieff, T. S. (2002). . "The Determinants of Bank Interest Rate Spreads in Brazil". *Central Bank of Brazil Working Papers*, 46 .
- Agoraki, M. E. (2010). The determinants of net interes margin during transition, Grecee, Athens University of Economics and Business. *Grecee, Athens University of Economics and Business*.
- Albulescu. (2009). Forecasting credit growth rate in Romania: from credit boom to credit crunch? *MPRA Paper* 16740.
- Altunbas, Y., Gardener, E.P.M., Molyneux, P., Moore, B., (2001). *Efficiency in European banking*. European Economic Review 45, 1931-1955.
- Angbazo, L. (1997). Commercial bank net interest margins, default risk, interest rate risk and off-balance sheet banking. . *Journal of Banking and Finance* 21, 55-87.
- Ansgar Belke, T. P. (2009). *Monetary Economics in Globalised Financial Markets*. Berlin Heidelberg: Springer-Verlag.
- Arellano, M., Bond, S., 1991. *Some Tests of Specification for Panel Data: Monte Carlo Evidence and an Application to Employment Equations*. Review of Economic Studies 58, 277-297.
- Arellano, M., Bover, O., 1995. *Another look at the instrumental variables estimation of error-components models*. Journal of Econometrics 68, 29–51.
- ASK (2013-2014): Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://ask.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- Athanasoglou, P., Delis, M., Staikouras, C., 2006. Determinants of Bank Profitability in the South Eastern European Region. *Journal of Financial Decision Making* 2(2), 1-17.
- Balijs, P. (2014). Bankat dhe ligjet. *The Kosovo banker* no.5, 2.
- Bawerk, E. B. (1890). *Capital and Interests*.

Bawumia, Mahamudu, Franklin Belnye and Martin E. Ofori.(2005). *"The Determination of Bank Interest Spreads in Ghana: An Empirical Analysis of Panel Data"*, Bank of Ghana Working Paper 05/09

Binder, M., Hsiao, C., Pesaran, M.H., (2003). *Estimation and Inference in short panel vector autoregressions with unit roots and cointegration*. Cambridge Working Paper in Economics, No 0003.

Berger, A. B. (2000). Why are bank profits so persistent? The roles of product market competition, informational opacity, and regional/macroeconomic shocks. . *Journal of Banking and Finance* 24, 1203-1235.

Berger, A.N., Buch, C.M., DeLong, G., DeYoung, R., (2004). *Exporting Financial Institutions Management via Foreign Direct Investment Mergers and Acquisitions*. *Journal of International Money and Finance* 23, 333-366.

Berger, A. M. (1997). Inside the black box: What explains differences in the efficiencies of financial institutions? . *Journal of Banking and Finance* 21, 895-947.

Berger, A. (1995). The relationship between capital and earnings in banking. *Journal of Money, Credit and Banking*. Vol.27.

Bernanke, B. (1983). "Nonmonetary effects of the financial crisis in the propagation of the Great Depression". *American Economic Review*, 73,25 7-76.

Blundell, R. W., Bond, S.R., 1998. Initial conditions and moment restrictions in dynamic panel datamodels. *Journal of Econometrics* 87, 115-143.

Bolt, W., Tieman, A.F., 2004. Banking competition, risk and regulation. *Scandinavian Journal of Economics* 106, 783-804.

Bonin, J., Hassan, I., and P. Wachtel, 2005. Bank performance, efficiency and ownership in transition countries. *Journal of Banking and Finance* 29, 31-53.

Bomfin, A. N. (2001). *Measuring equilibrium real interest rates: what can we learn from yields on indexed bonds?* *Federal Reserve Board, Finance and Economics Discussion Series*.

Brock, P., Suarez, L.R., 2000. Understanding the Behavior of Bank Spreads in Latin America. *Journal of Development Economics* 63, 113-134.

BQK. (2015). *Plani strategjik 2015-2019*. Kosovë: BQK.

BQK. (2015). *Raporti vjetor*. Kosovë.

BQK. (Qershor 2016). *Raporti i stabilitetit financiar*. Kosovë: BQK.

- Brock, P. a. (2000). Interest rate spreads in Latin America: Facts, Theories and Policy Recommendations. *Inter-American Development Bank*, 7,25-28.
- Brock, P. a. (2002). Bank Interest margins Meet Interest Rate Spreads: How Good is Balance Sheet Mimeo Central Bank of Chile. Data for Analyzing the Cost of Financial Intermediation? *Mimeo Central Bank of Chile*.
- Brock, Philip and Helmut Franken. (2003). Measuring the Determinants of Average and Marginal Bank Interest Rate Spreads in Chile, 1994-2001.
- Brock, Philip and Helmut Franken. 2003. "Measuring the Determinants of Average and Marginal Bank Interest Rate Spreads in Chile, 1994-2001". Mimeo Central Bank of Chile.
- Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129> Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- Carbo V.S., R. F. (2007). The determinants of bank margins in European banking. . *Journal of Banking and Finance*, 31, 2043-2063.
- Cetorelli, N., Gamberra M., (2001). *Banking market structure, financial dependence and growth: International evidence from industry data*. *Journal of Finance* 56, 617–648.
- Civici, Adrian (2010). *Kriza financiare apo globale*, Universiteti Evropian i Tiranës, Tiranë.
- Claessens. Stijn, A. D.-K. (1997, 2001). "How Does Foreign Entry Affect the Domestic Banking Market?". *World Bank, Policy Research Department*, 40-42.
- Claeys, S. V. (2007). Determinants of Bank Interest Margins in Central and Eastern Europe: A Comparison with the West. *Economic Systems* 32, 197-216.
- Claeys, Sophie and Rudi Vander Vennet, (2004). Determinants of Bank Interest Margins in Central and Eastern Europe: A Comparison with the West". *Ghent University Working Papers*, 316
- Corvoisier, S. and R. Gropp. (2002). "Bank concentration and retail interest rates". *Journal of Banking and Finance* 26 .
- Cottarelli, C., Dell, G., and Vladkova-Hollar, I., (2005). *Early birds,late risers,and sleeping beauties: Bank credit growth to the private sector in Central and Eastern Europe and in the Balkans* . *Journal of Banking and Finance* 29, 83-104.
- Cuaresman, J. C.-G. (2003). The natural rate of interest concepts and appraisal fort the euro area. *Monetary Policy & The Economy*. Q5, 29-47.
- CNB (2014): Global Economic Outlook

- D., L. R. (2011). D., Louvti Rodney Sidabalok and Viverita The determinants of net interes margin in indonezion banking sector. *SSRN*.
- Demirgüç-Kunt, A. a. (1998). "Determinants of Commercial Bank Interest Margins and Profitability: Some International Evidence". *The World Bank Policy Research Working Paper, 1900.*, 379-408.
- Demirgüç-Kunt, H. (1999). The determinants of Commercial Bank Interest Margins and Profitability: Some International Evidence. *The World Bank Economic Review, Vol.13*, 379-408.
- Demsetz, H. (1973). Industrial structure, market rivalry, and public policy. *Journal of Law and Economics*, 16, 1-10.
- Drakos. (2002). The Dealership model for interest margins: The case of the Greek banking industry. *Journal of Emerging Finance 1*, 75-98.
- Drakos, K. (2003). Assessing the success of reform in transition banking 10 years later: an interest margins analysis. *Journal of Policy Modeling 25*, 309-317.
- Dupont, D. &. (1999). The treasury securities market: overview and recent developments. *Federal Reserve Buletin*, 785-806.
- E strada, D. E. (2006). Determinants of Interest Margins in Colombia. *Borradores de Economia. No. 393*.
- E.M., L. (1981). Discussion the determinants of bank interest margins: theory and empirical evidence . *Journal of Financial and Quantitative Analysis, Vol.XVI , Nr.4.*, 25-29.
- European Commission (2011 - 2014): Eurostat Database;
- European Central Bank (2011-2014): Monthly Bulletin, European Central Bank, Frankfurt
- Fisher, I. (1907). *The rate of interest*. New York:Macmillan: reprinted in Fisher 1997.
- FMN. (2004). *Raporti vjetor*.
- Friedman, M. (1994). Money mischief, episodes in monetary history. . *San Diego: Hartcourt Brace*, 50-52.
- GAP. Instituti për hulumtime dhe zhvillime, Raport vjetor, Kosovë(2011).
- Garrison, R. W. (2002). Ditch the Keynesians, Why policy-infected interest rates mustgo. . *Barron's*, 82 (35),2.
- Gelos, R. G. (2006). Banking spreads in Latin America. *IMF Working Paper, 06/44* .

- Gerdesmeier, D. &. (2003). Empirical estimates of reaction functions for the euro area. *ECB working paper*, 206.
- Giammarioli, N. &. (2003). The natural real rate of interest in the euro area. . *ECB*, 105-117.
- Gossen, H. H. (1854.). *Entwicklung der Gesetze des menschlichen Verkehrs und der daraus fließenden Regeln für menschliches Handeln*. Braunschweig, Vieweg.
- Gual, J.,(1999). *Deregulation, Integration, and Market Structure in European Banking*. Journal of the Japanese and International Economies 13, 372-396.
- H o, T. S. (1981). "The determinants of bank interest margins: Theory and empirical evidence". . *Journal of Financial and Quantitative Analysis, Vol.XVI , Nr.4*.
- Hadri, Sulo Prof. Dr, (2006) "Paraja, bankat dhe tregjet financiare", *Agafer*, Tiranë.
- Hamza, B. (2014). Bankat dhe ligjet. *The Kosovo banker*, 5.
- Hanson, J. A. (1986). "High Interest Rates, Spreads and the Cost of Intermediation: Two Studies". Industry and Finance. Series 18. *Industry and Finance. Series 18*.
- Henderson, David (2007)" Klasikë të mendimit ekonomik nga fillimet deri në ditët tona" *Plejad*, Tiranë.
- Humphrey, T. M. (1997). Fisher and Wicksell on the quantity theory. Federal Reserve Bank of Richmond. *Economics Frankfurt*, 71-90.
- IMF (2014): World Economic Outlook April 2014, International Monetary Fund (IMF): <http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>
- IMF (2014): World Economic Outlook July 2014, International Monetary Fund (IMF): <http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>
- Kadareja, Arjan. Dr. (2012). Leksione nga lënda Financat ndërkombëtare.
- Kalluci, I. (2010). Percaktuesite e marzhit neto te sistemit bankar shqiptar. *BSH*.
- Kansoy, F. (2012). The determinant of net interes margin in the Turkish banking sector. Does bank ownership matter? . *Journal of BRSA Banking and Financial Markets*, 13-49.
- Keynes, J. M. (1973). *The general theory of employment, interest, and money*. . USA: Cambridge. 1

Khawaja, Idrees and Musleh (2007) "*Determinants of Interest Spreads in Pakistan*", Pakistan Institute of Development Economic Working Papers, 22, 2007.

Knut, W. (1969). *The influence of the rate of interest on commodity prices*. UK: Reprinted Knut.

- Laubach, T. &. (2001). Measuring the natural rate of interest. . *Federal Reserve Board Finance and Economic Discussion Series, No. 56*.
- Laubach, T. W. (2003). Measuring the natural rate of interest. *Review of Economics and Statistics*, 85(4), 1063–1070.
- Lepetit, L., Nys, E., Rous, P., Tarazi, A. (2008a). *The expansion of services in European banking: Implications for loan pricing and interest margins*. *Journal of Banking and Finance* 32, 2325-2335.
- Leskaj, A. K. (2011). *Paraja dhe banka*. Tiranë: GEER.
- Levine, R. (2004). Financial Development and Economic Growth”. *Journal of Economic Literature*, 35 (2).
- Liebeg, D. a. (2006). “Determinants of the Interest Rate Margins of Austrian Banks”. *Oesterreichische Nationalbank Financial Stability Report, 12*, 104-116.
- Leskaj, Bujar & Kotorri, Adriatik (2011) “Paraja dhe banka”, *GEER*, Tiranë.
- Luboteni, G. (2006). “Menaxhmenti bankar”. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Luboteni, G. (2008). “Bankat dhe afarizmi bankar”. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Luboteni, Gazmend. Dr. (2008). *Financat e korporatave*. Prishtinë, 64.
- Llogaritë kombëtare: <http://ask.rks-gov.net/llogarite-kombetare/ll-kombetare>
- M’esonnier, J. S. (2004). A time-varying natural rate of interest for the euro area. . *Working Paper 115, Banque de France Paris*.
- Majnoni, G., Shankar, R., Vårhegyi, E., (2003). *The Dynamics of Foreign Bank Ownership: Evidence from Hungary*. World Bank Policy Research Working Paper 3114, Washington, D.C.
- Manrique, M. &. (2004). An empirical approximation of the natural rate of interest and potential growth. . *Working Paper 0416, Banco de España Madrid*.
- Martinez Peria, M. M. (2004). How Foreign Participation and Market Concentration Impact Bank Spreads: Evidence from Latin America. . *Journal of Money, Credit, and Banking* 36 , 511-537.
- Martinez Peria, M. S. (1998). Do Depositors Punish Banks for Bad Behavior? Discipline in Argentina, Chile, and Mexico. *World Bank Policy Research Working Paper No. 2058*.
- Maudos, J. a. (2004). “Factors explaining the interest margin in the banking sectors of the European Union”. *Journal of Banking and Finance* 28 , 225, 9-22,81.

- McShane, R. a. (1985). "A time series/cross section analysis of the determinants of Australian trading bank loan/deposit interest margins: 1962 -1981". . *Journal of Banking and Finance* 9, 115-136.
- Mises, L. (1996). Human action . *San Francisco: Fox & Wilkes.*, 527.
- Mises, L. v. (1912). *The theory of the money and credit*.
- Mishkin, Frederic S & Eakins, Stenly G., (2009) *Tregjet dhe institucionet financiare I+II*, Prishtinë.
- N., B. A. (2007). Obstacles to a global banking system: Old Europe versus New Europe. . *Journal of Banking and Finance* 31, 1955-1973.
- Naceur, B. S. (2003). The determinants of the Tunisian Banking Industry profitability: Panel evidence. *Universite Libre de Tunis, Department of Finance Working Paper*.
- Nelson, N. &. (2003). The real interest rate gap as an inflation indicator. *Macroeconomic Dynamics*, 7(2), 239–262.
- Neumann, J. v. (1944). Theory of games and economic behavior. *Princeton University press*.
- Nys. (2003). A European study of bank interest margins: is net fees revenue a determinant? . *20th Symposium, Birmingham Research into International Economics and Finance*.
- Pano, Aristotel & Gjoni, Elisabeta (2007) "*Tregjet financiare – instrumentat dhe veprimet e tyre*", albin, Tiranë.
- Reifschneider, D. &. (2000). Three lessons for monetary policy in a low-inflation area. *Journal of Money, Credit and Banking*, 936-966.
- Robinson, W. John. (2002). *Commercial bank interest rate spreads in Jamaica-Measurement, trends and prospects*. Discussion Paper 2002.
- Rothbard. (2001). *Man, economy, and state, power and market, a treatise on economic*. Auburn: AL: Ludwig von Mises Institute.
- Sack, B. (2002). A monetary policy rule based on nominal and inflation-indexed treasury yield,. *Board of Governors of the Federal Reserve System. Washington, DC: Division of Monetary*.
- Sack, B. E. (2004). Treasury inflation-indexed debt: A review of the U.S. experience. *Federal Reserve Bank of New York, Economic Policy Review*, 10(1), 47–63.
- Samuelson, P., (1945). *The effect of interest rate increases on the banking system*. The American Economic Review XXXV (1), 16-27.

Sapienza, P., (2002). *What Do State-Owned Firms Maximize? Evidence from the Italian Banks*. CEPR Discussion Paper No. 3168.

Schumacher, S. a. (2000). "The determinants of bank interest rate margins: an international study". *Journal of International Money and Finance*, 19.

Sologoub, D. (2006). The Determinants of Bank Interest Margins and Profitability, Case of Ukraine. *Workshop on transition economics, Helsinki, April*.

Stubos, G., Tsikripis, I., (2007). Regional Integration Challenges in South East Europe: Banking Sector Trends. *Southeast European and Black Sea Studies* 7 (1), 57 – 81.

Toçi, V. (2005). INTEREST RATES IN KOSOVO, SOME COMPARISONS AND POSSIBLE DETERMINANTS. *BQK*, 11-12.

Uchida, H., Tsutsui, Y., (2005). Has competition in the Japanese banking sector improved? *Journal of Banking and Finance* 29, 419-439.

Wicksell, K. (1898,1965). *Interest and Prices*. translated by R. F. Kahn, London, Macmillan;.

Wicksell, K. (1969). The influence of the rate of interest on commodity prices. Reprinted in Knut. *Selected papers on Economic Theory*, New York, 67-89.

Winton, G. &. (1998). Banking in transition economies: does efficiency require stability? *Journal of Money, Credit and Banking* 30, 621-650.

Wong, K. Z. (2008). Wong, Kaiguo Zhou and Michael C. S, The determinant of net interest margin in Mainland China Emerging Markets *Finance & Trade*, Vol.44, no.5. 41-53.

Woodford, M. (2000). *A Neo-Wicksellian framework for analyzing monetary policy*. Working.

Woodford, M. (2003). *Interest and prices*. Princeton, New York, Princeton University Press.

Zaho, Lavdosh & Duraj, Brunilda,(2010), "Tregjet dhe institucionet financiare", Dita 2000, Tiranë.

